

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T I

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 24.03.2006

T R A N S K R I P T

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 24.03.2006 GODINE

Mars – Mart 2006

**Seanca u mbajt në sallën solemne të Kuvendit të Kosovës dhe filloi në orën 10,00.
Seancën e kryesoi Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit të Kosovës
Bashkëkryesues: Sabri Hamiti**

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Të nderuar kolegë deputetë , të nderuar ministra dhe zëvendësministra.

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare.

Meqë në sallë janë 89 deputetë, konsideroj se janë plotësuar kushtet që t'ia fillojmë punës.

Rendin e ditës për sot e keni marrë më parë, që u miratua në seancën e mëparshme , prandaj të procedojmë më tutje. Mirëpo para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, e ka kërkuar fjalën deputeti Fetah Berisha. Fjala e tij nuk ka të bëjë me rendin e ditës.

DEPUTETI FETAH BERISHA

I nderuari z. kryetar, të respektuar kolegë deputetë, respekt për ju që merrni pjesë në këtë seancë, të nderuar ministra dhe zëvendësministra. Më lejoni që me pak fjalë t' jua përkujtoj plagën e rëndë, për plagën e të pa gjeturve që ende pikon gjak dhe dhembje në Kosovën e lirë, dhembje që rëndon fort në regjimin aktual serb të Beogradit. Të dielën më 26 mars mbushen 6 vjet që 206 qytetarë të Krushës së Madhe janë vrarë dhe kufomat e tyre janë djegur. Këtu u bë dy herë krim, u vranë dhe u dogjën. Në regjistrin e 207-tshit e të Krushës së Madhe është edhe magjistër Ukshin Hoti .Ai është zhdukur diku tjetër, por edhe ai ishte krushjan. E liruan të dielën për ta zhdukur. Të nderuar deputetë nga 32 fshatra të komunës së Rahovecit u granatuan , u plaçkitën dhe u dogjën të gjitha, por më së keqi pësuan fshati Pastasel me 106 të vrarë dhe Krusha e Madhe me 207 të vrarë. Në Vjenë po vazhdojnë bisedimet e Grupit Negociator, por ne si përfaqësues të zgjedhur nga populli ia përkujtojmë Grupit Negociator se Serbia i ka borxh Kosovës edhe mijëra t shqiptarë të tjerë të pagjetur, prandaj ju përfaqësues të Grupit Negociator të Kosovës në takimin e ardhshëm në Vjenë keni obligim moral, familjar dhe kombëtar që të kërkonit zbardhjen e fatit të pa gjeturve dhe kthimin e kufomave të këtyre të zhdukurve. Po ashtu nëse dëshironi ta ndieni dhembjen e varrosjes së martirëve të vrarë gjatë luftës në Kosovë, ju ftoj juve ose ndonjërin nga ju që të merrni pjesë në ceremoninë mortore të varrimit të 45 martirëve të dielën e ardhshme në Krushë të Madhe. Njëkohësisht i ftoj edhe kolegët deputetë, ata që kanë mundësi të vijnë e të marrin pjesë në ceremoninë e rivarrimit. Rivarrim bëhet më 26 mars në orën 13,00 në varrezat e Krushës së Madhe,

ndërsa homazhi do të fillojë të në orën 10,00. Në komunën e Rahovecit është shpallur 2 ditë zie në shenjë respekti dhe dhembjeje. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Berisha,
Fjalën e ka kërkuar deputeti Hydajet Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Faleminderit z. kryetar. Me sa pashë e ka kërkuar fjalën edhe shefi i grupit parlamentar, ose anëtari i Kryesisë, kështu që do të preferoja pas tyre. Mirë atëherë.

Z. kryetar, zonja dhe zotërinj deputetë, dita e sotme dhe kjo mbledhje koincidojnë edhe me ngjarjen madhore në të kaluarën tonë, me ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe të Aleancës Veriatlantike, kështu që është rast që edhe ky Kuvend të shprehë mirënjohjen dhe falënderimin për mbështetjen shpëtimtare dhe vendimtare të botës demokratike për Kosovën e re. Por unë e mora fjalën për diçka tjetër, prandaj kërkoj falje dhe do të kthehem në çështjen që është më shumë procedurale. Sipas radhës ne duhej të miratonim procesverbalin, por edhe më parë dhe më ekskluzivisht e lidhur me angazhimin tim. Unë jam i detyruar ta përsëris për të satën herë kërkesën për të procedurën me pyetjet parlamentare. Ka muaj të tërë që pyetje të shumta presin përgjigjet nga ministrat dhe nga Qeveria. Unë dua ta theksoj veçanërisht kësaj radhe pyetjen time të bërë muaj më parë për pozitën e të zhvendosurve nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Ju e dini gjendjen në të cilën ndodhen ata, i dini edhe implikimet e shumta edhe aktuale, por edhe perspektivën. Z. kryetar insistoj që kjo çështje të rregullohet, nuk po dua t'ju marrë kohë, por me Rregulloren e punës të Kuvendit dhe me praktikat parlamentare ministrat janë të detyruar t'u përgjigjen pyetjeve parlamentare në afatin e përcaktuar. Presim qëndrim adekuat të përfaqësuesve të Qeverisë ndaj shqetësimeve të deputetëve. Ne përfaqësojmë qytetarët e Kosovës. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Hyseni. Kjo është një mbledhje e veçantë, është thirrur për këtë pikë të rendit të ditës, që e kemi sot, përndryshe në raste të tjera do të procedonim sipas rregullave. Fjalën e ka kërkuar Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI

Z. kryetar, të nderuar kolegë ministra.

Unë desha të flas edhe për pjesën që e ngriti Hydajeti lidhur me fillimin e bombardimeve të Aleancës Veriatlantike. Si shenjë falënderimi, ndoshta, do të duhej të bënim diçka më shumë, por meqë është seancë e veçantë unë kam një shqetësim timin dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe jam i ngarkuar t'ju them se kjo seancë në mungesë të raportit paraprak me shkrim për fillimin e bisedimeve në Vjenë, është e mangët dhe e dyta, meqë Parlamenti i Kosovës e ka ngarkuar një delegacion zyrtar që ka marrë votat e

këtij Parlamenti, mendoj se vetëm ai delegacion mund të raportojë në Kuvend dhe jo komisionet apo grupet që i ngarkon pastaj Grupi Negociator. Në këtë rast duke pasur parasysh edhe pengesat kushtetuese që janë për kryetarin e Kosovës, do të thosha që kryetari i Kosovës, si udhëheqës i Grupit Negociator do të duhej të raportonte dhe në mungesë të tij Grupi Negociator ta autorizonte personin që në emër të grupit për negociata, do të raportonte në Kuvend. Mendoj që i gjithë respektin që e kam për ministrin Haziri, në qoftë se kjo do t'i mbetet pastaj Qeverisë ose kryeministrit dhe do ta zëvendësonte kryeministrin në raportim, është diçka tjetër, por këto grupe që kanë shkuar në Vjenë mendoj se nuk i ka autorizuar Kuvend, porse obligim në raport me Kuvendin kanë vetëm të autorizuarit e Kuvendit ose të zgjedhurit e tij. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEREISHA

Ju faleminderit. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI

Për qytetarët e Kosovës dhe për Lidhjen Demokratike të Kosovës kjo është një datë e shënuar në historinë tonë, por edhe në jetën e të gjallëve dhe familjeve të atyre që kanë pësuar. Lidhja Demokratike e Kosovës nëpërmjet forumit të LDK-së, sot në orën 17,00 e shënon këtë datë në Hotel Grand Prishtina dhe ftojmë të gjithë deputetët, Qeverinë dhe mysafirët e pranishëm që t'i bashkohen shënimit të kësaj date të posaçme për Kosovën. Z. kryetar lidhur me pikën e rendit të ditës Grupi Parlamentar i LDK-së e ka mbështetur kërkesën e Aleancës për Ardhmëri e Kosovës si dhe kërkesën e Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike që kjo çështje sot të shtrohet në rend të ditës. Ne, si grup kemi pritur dhe do ta mirëpresim dërgimin e një materiali për këtë seancë. Pasi ende nuk ka ndodhur, jemi të gatshëm që këtë material ta marrim në kohën kur grupi deputetët t'ua dorëzojmë material ta pranojmë në kohën kur Grupi i Unitetit ose kur Delegacioni të jetë i gatshëm t'ua dorëzojë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, por pasi ky material në mënyra të ndryshme ka dalë në medime elektronike dhe në ato të shkruar. Z. kryetar është fillim i mirë që çështjet kaq të rëndësishme të trajtohen në seancë plenare, sepse këto çështje trajtohen në shoqërinë civile dhe në jetën tonë të përditshme. Grupi ynë parlamentar kur e mori vendimin që për një pjesë të prezantimit të dokumentit të Kosovës në Vjenë këta ta bënte një prezantues, por kërkojmë që prezantimin e dytë ta bëjë anëtar i Delegacionit të Unitetit që e ka bërë atë prezantim në emër të Delegacionit të Unitetit në Vjenë. Ne do ta mirëpresim raportimin e deputetit Hashim Thaçi, sepse z. Thaçi ky Kuvend e ka zgjedhur në Grupin e Unitetit. Nëse z. Thaçi për arsye të ndryshme sot nuk mund jemi të gatshëm që z. Thaçi ta dëgjojmë në kohën kur ai mund të vijë në Kuvend. Z. kryetar pas raportimit të sotëm nga përfaqësuesi i Qeverisë, Grupi Parlamentar i LDK-së do të marrë pjesë në debat dhe do ta jap kontributin e vet për këtë çështje me rëndësi të jashtëzakonshme për vendin tonë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Faleminderit. Propozojmë më tutje. Në propozim të deputetit Emrush Xhemajli, të Grupit Parlamentar të AAK-së dhe të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike, Kryesia e Kuvendit ka kërkuar që Grupi Negociator të raportojë në Kuvend lidhur me dy takimet e zhvilluara në Vjenë. Ftoj përfaqësuesin e Delegacionit në takimet e Vjenës që ta marrë fjalën, zëvendësministri dhe ministri i pushtetit lokal z. Lutfi Haziri.

ZËVENDËSMINISTRI LUTFI HAZIRI

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra.

Kam nderin që sot para jush të raportoj për zhvillimet që fatmirësisht janë pozitive për të ardhmen e vendit tonë.

Para se të filloj jam i obliguar ta konfirmoj nderimin tim të veçantë që njëjtin raport e kam paraqitur edhe në Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të Kuvendit të Kosovës, që në seancën e fundit kishte kërkuar nga unë ta njoftoja për zhvillimet në kuadër të procesit të Vjenës, që ka të bëjë me reformat e pushtetit lokal. Unë, po ashtu, sot vij me mandat të Delegacionit të Kosovës për status, apo të ekipit të unitetit që ka kërkuar që t'i njoftoja dhe këtë po e bëj para jush. Para se të hyjë në detaje dhe ta jap vlerësimin, që nuk është vetëm imi, por është shprehur nga të gjithë anëtarët e Delegacionit dhe nga vëzhguesit e tjerë. Bisedimet deri më tash kanë qenë të suksesshme dhe janë në rrugë të mirë të krijojnë hapësirë, ambient politik që Kosova të ecën drejt pavarësisë dhe rregullimit të statusit final. Por, po ashtu, kemi arsye të plotë, se jemi të kënaqur me periudhën e deritashme dhe me padurim pres angazhimin tuaj që padyshim do të kontribuonte që puna e Delegacionit që unë, më vonë edhe z. Hashim Thaçi i kemi udhëhequr, të intensivkohet në të mirë të qytetarëve të vendit tonë.

Siç e dini puna e këtij delegacioni mbështetet në shumë dokumente dhe vendime që janë marrë nga Kuvendi i Kosovës dhe me miratimin e po këtij Kuvendi sot dhe në bazë të dokumentit që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës për parimet themelore të pushtetit lokal në Kosovë, do të vazhdojmë të ecim drejt realizimit të këtyre objektivave. Po ashtu ju garantoj se Delegacioni, me përkushtimin më të madh është në funksion të prezantimit të këtyre vendimeve dhe duke u mbështetur thellë në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës të 17 nëntorit 2005. Më lejoni që t'i prezantoj edhe një herë disa nga parimet themelore të miratuara nga delegacioni i Kosovës të datës 14 shkurt 2006. Parimet e elaboruara për reformën e pushtetit lokal janë të vlefshme dhe mund të zbatohen në tërësi vetëm në Kosovën e pavarur dhe sovranë. Cilat do diskutime për reformën e pushtetit lokal të mbështeten në premisën e zgjidhjes së statusit në përputhje të plotë me vullnetin e popullit të Kosovës. Kosova angazhohet për një reformë të plotë të pushtetit lokal të udhëhequr sipas parimeve të efektivitetit, të funksionalitetit dhe të stabilitetit të saj, sipas të cilave do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht cilit grup etnik i takojnë. Parimet për reformën e pushtetit lokal janë hartuar në përputhje me standardet e qeverisjes së mirë, të demokracisë, të transparencës e të sundimit të ligjit ashtu, siç janë të zbatueshme në mbarë Evropën sot. Parimet, po ashtu, pasurojnë vlerat mbizotëruese të dokumenteve më relevante ndërkombëtare në këto fusha, veçanërisht parimi i **substidialitetit** të Bashkimit Evropian. Karta evropian për Vetëqeverisje Lokale dhe Korniza për Marrëveshjen e Ohrit si një nga plan modelet, është përmendur dhe, mbi të gjitha, dokumenti kornizë për reformën e pushtetit lokal që është diskutuar

edhe në këtë Parlament. Reforma e pushtetit lokal në Kosovë duhet të sjellë vendimmarrje më të afërt për qytetarët, t'u ofroj shërbime më të mira në nivel lokal, si dhe të siguroj qeverisje të qëndrueshme dhe kushte të mira jete për të gjithë ata. Gjithashtu kjo reformë duhet të kontribuojë në integrimin e të gjitha komuniteteve në strukturat demokratike të Kosovës. Të gjitha institucionet paralele ekzistuese duhet të shuhen dhe asnjë formë e re e institucioneve paralele jashtë kontrollit ekzekutiv të Kosovës, nuk do të tolerohet. Integriteti territorial i Kosovës dhe karakteri unitar i saj janë të pacenueshëm, prandaj në mënyrë eksplicite përjashtohet çdo kërkesë me karakter territorial ,siç janë: krijimi i korridoreve etnike, i enklavave, kërkesa territoriale që synojnë ndarje përgjatë linjave etnike qoftë de jure apo defakto.

Të nderuar deputetë para se t'ju njoftoj shkurtimisht për mbarëvajtjen e dy takimeve të para në Vjenë, më lejoni t'ju them edhe një fakt të rëndësishëm. Për ta prezantuar ofertën dhe pozicionet sipas parimeve e institucioneve të Kosovës për integrimin e pakicave në Kosovë si dhe reformën e domosdoshme të pushtetit lokal për një të ardhme më të sigurt për të gjithë banorët, kemi marr mandat të diskutojmë për temat që janë aagjendë e vendosur nga përfaqësuesi i veçantë për status z. Ahtisari dhe në asnjë mandat tjetër ky delegacion nuk ka autorizim të marr pjesë në bisedime të drejtpërdrejta me ndërkombëtarë,të paraqet. Më 16 shkurt Delegacioni i Kosovës për status me mandatarin që ta udhëheq delegacionin për bisedimet e para në Vjen, mandat i cili u konfirmua pas mandatimit të parë që në reformën e pushtetit lokal të punoj dhe të angazhohem në emër të këtij organi, nga presidenti i ndjerë Rugova dhe Delegacioni i Kosovës në dhjetor të vitit të kaluar. Takimi në Vjenë i mbajtur më 20 dhe 21 shkurt kishte për temë kompetencat që do t'i kenë komunat në të ardhmen. Në përputhshmëri me parimet e dokumentit kornizë të Qeverisë së Kosovës dhe me parimet që u përmendën si **substidialiteti** dhe devolimi i pushtetit, ne propozuam një serë kompetencash të ndryshme, duke u fokusuar këtu edhe në kompetencat e fushës së arsimit, të shëndetësisë, kulturës, planifikimi urban, zhvillimi ekonomik lokal, rinia, sporti dhe aktivitete të tjera. Po ashtu dëshiroj të theksoj se një pjesë e këtyre kompetencave në bazë të Rregullores 45 dhe legjislacionit në fuqi në Kosovë janë e drejtë e komunave Do të theksoj se propozimet e Kosovës nuk janë drejtuar në mënyrë selektive për komuna të veçanta, por vlejnë për të gjitha komunat e tërë territorit të Kosovës. Angazhimet tona , me ndërmjetësimin e z. Rohan ,që ka mandat të paraqes ose të udhëheq këto bisedime nga z. Ahtisari ,kanë qenë të fokusuara në shëndetësinë primare dhe në atë sekondare, në mundësitë financiare , në nivelin qendror që ka kompetenca për udhëheqjen e koordinimit të përgjithshëm të politikave të shëndetësisë. Komunat të ofrojnë arsim parashkollor fillestar dhe sekondar, të drejtat gjuhësore, pra të drejtat për arsimim në gjuhën amtare, aty ku një grup etnik është pakicë, komunat kanë përgjegjësi ta menaxhojnë arsimin dhe punësimin e arsimtarëve,duke përfshirë edhe pronën në arsim, serbët duhet ta kenë Universitetin në gjuhën e tyre, po ashtu edhe pakicat tjera duhet të vazhdojnë të kenë arsimim të lartë. Po ashtu u diskutua edhe për disa kompetenca të komunave të sferës së aktivitetit kulturor që të përfshihen teatrot komunale, aktivitete të ndryshme në kuadër të fushave që përfshijnë këto komuna. Të transferohet një pjesë e shërbimeve sociale në nivel komunash dhe, po ashtu, një nga diskutimet që është ndarë, të ketë të bëjë me çështjen e pensionistëve që është larguar nga agjenda e pushtetit lokal. Sa u përket policisë dhe

drejtësisë është arritur pajtimi që nuk mund të ketë kompetenca komunale dhe që zinxhiri komandues të jetë i unifikuar, mirëpo policia në komuna dhe të punësuarit në sistemin juridik në Kosovë, reflektojnë përbërjen etnike të komuniteteve.

Po ashtu propozim i Delegacionit të Kosovës është të forcohet roli i komunës me emërimin e shefave lokalë të policisë që i referohet parimit të Marrëveshjes së Ohrit, por që koordinohet apo është nën kushtin e vendimmarrjes të Ministrisë së Punëve të Brendshme, do të thosha se kjo është pjesa e parë e angazhimeve tona për takimin e parë. Ndërsa me vendim unanim të Delegacionit të Kosovës për status z. Hashim Thaçi është emëruar udhëheqës i Delegacionit për bisedime në Vjenë që u zhvilluan më 17 mars.

Takimi ishte i fokusuar në financat lokale, në bashkëpunimin ndër komunal dhe ndërkufitar. Delegacioni potencoi se lidhur me ndihmat financiare për komunat, në sferën e kompetencave përkatëse, Kosova është e hapur për donacione ndërkombëtare, duke inkuadruar këtu edhe ndihma nga shtetet fqinje përfshirë edhe Serbinë. Të gjitha donacionet duhet të kalojnë nëpërmjet thesarit qendror dhe të jenë të hapura, transparente dhe t'u nënshtrohen rregullave të përgjithshme të auditivit. Por nuk mund të ketë ndërhyrje në institucionet financiare të Kosovës. Ne sqaruar se pajtohemi për krijimin e mekanizmeve të bashkëpunimit ndër komunal në të gjitha fushat e pushtetit lokal, mirëpo fuqimisht kemi potencuar se këta mekanizma në asnjë mënyrë nuk duhet të shndërrohen dhe nuk bën të shndërrohen në nivel të tretë të pushtetit dhe në asnjë etnitet të veçantë politik as juridik. Konstatuam që bashkëpunimi ndër komunal të rregullohet dhe të garantohet me kushtetutë dhe me Ligjin për qeverisjen lokale, që do të merrnin parasysh të gjitha standardet dhe përvojat më të mira evropiane dhe më gjerë. Angazhimi ynë që interesimi i Serbisë për komunitetin serb në Kosovë është i drejtë, por institucionet e Kosovës këtë interesim do ta rregullojnë dhe sanksionojnë me marrëveshje bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe në asnjë formë tjetër.

Takimi i ardhshëm do të mbahet më 3 prill, kurse Zyra e z. Ahtisari, në ndërkohë, do ta hartojë dokumentin rreth parimeve të përbashkëta për pushtetin lokal në Kosovë.

Të nderuar deputetë jemi të bindur se në secilin takim të bisedimeve jemi më afër Kosovës së lirë, demokratike, të pavarur dhe sovrane. Angazhimi ynë konkret, pa ngurrim që do të shtirren të gjitha temat e caktuar nga z. Ahtisari që kanë të bëjnë me reformën e pushtetit lokal, me trashëgiminë kulturore, më çështjet ekonomike dhe me ndarjen faktike, është angazhim për ta ofruar zgjidhjen e statusit në periudhë sa më të afërt. Të dy takimet e para ishin konstruktive dhe kanë ndihmuar të sqarohen pozicionet dhe të ngritët niveli i mirëkuptimit për disa çështje specifike. Më lejoni të konstatoj se dallimet diametralisht janë të kundërta në dokumentet që janë paraqitur para ndërmjetësuesit ndërkombëtar. Ndërsa angazhimi ynë – në njërin anë është të vendosen parimi i funksionalitetit dhe i integritetit të komunitetit në institucionet e Kosovës, në anën tjetër, pala tjetër, paraqet dezintegrimin e komuniteteve dhe kërkon ndarjen e etniteteve, duke përfshirë edhe kërkesën për asimetri në qarqet e pushtetit lokal dhe kamufilon tendencat centraliste në emër të decentralizimit, duke vendosur komunitetin e saj etnik në një kontroll të qartë administrativ dhe politik për interesa që te ne janë të njohura. Më në fund më lejoni që ta bëj edhe më të qartë dhe nuk ka kurrfarë marrëveshje .

.....

Parimet e negociatave nuk kërkojnë që në këtë fazë të arrijmë marrëveshje për tema të veçanta. Marrëveshje e vetme është ajo që nuk ka marrëveshje për asnjë element të pakos pa zgjidhjen e statusit përfundimtar, deri sa nuk është arritur marrëveshja për pakon në tërësi. Kjo është formula që zoti Ahtisari e ka paraqitur dhe e ka konfirmuar edhe para delegacioneve tona. Detajet e diskutuara mund të zbatohen vetëm pasi të jetë arritur marrëveshja rreth Kosovës së pavarur dhe sovrane. Asgjë nuk mund ta ndalë Kosovën drejt lirisë së plotë për të gjithë qytetarët e saj dhe, po ashtu ,reforma e pushtetit lokal në Kosovë, si pjesë e procesit të institucioneve të Kosovës, vazhdon të punohet në të gjitha ato segmente që nuk janë pjesë e statusit as e negociatave. Praktikisht ne nuk kemi bërë stopim, nuk kemi bërë ndalje të procesit që ka qenë përkushtim yni i përbashkët që të ecet drejt reformimit të pushtetit lokal, por kemi konstatuar se temat që janë përcaktuar dhe janë pjesë e statusit dhe të negociatave, nuk mund të zhvillohen tani dhe pritet të arrihet deri te pika kritike që ka të bëjë me zgjidhjen e statusit final. Në fund më lejoni të shpreh mirënjohjen time të thellë për besimin tuaj për mua dhe për anëtarët e tjerë të Delegacionit. Po ashtu dua ta shpreh mirënjohjen time për kontributin e madh në bashkëpunimin e plotë të z. Hashim Thaçi si kryesues i Delegacionit në takimin e dytë dhe anëtarëve të tjerë të Delegacionit .që kanë përfaqësuar partitë politike dhe institucionet de tjera. Jam i lumtur që Kosova në këto negociata është duke folur me një zë. Zëri i Kosovës kurrë nuk është dëgjuar më qartë dhe më zëshëm se tani kur po flasim për statusin e saj final.
Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Faleminderit z. zëvendësministër. Po ju njoftoj se në pajtim me rregullën 6.2 të Rregullores së punës ,Kryesia e Kuvendit ka marrë pëlqimin e grupeve parlamentare për formën dhe kohëzgjatjen e debatit. Ju e dini se koha e zgjatjes së debatit është 10 minuta. A mund të merret pëlqimi që mund ta shkurtojmë këtë kohë.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI

Mendoj se nuk ka nevojë të shkurtohet diskutimi.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Atëherë vazhdojmë sipas Rregullores 10 minuta zgjat secili diskutim dhe e hapidebatin. Fjalën e ka Emrush Xhemajli.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI

I respektuari kryetar i Kuvendit, të nderuara zonja dhe zotërinj. anëtarë të Grupit të Kosovës për statusin e vendit, me gjithë se nuk qenkan krejt dhe i bashkangjitem asaj që e tha Xhaviti. Të respektuar të pranishëm.

Si deputet dhe përfaqësues i LPK-së mbështes përpjekjet për një Kosovë të shkëputur nga Serbia, të aftë ta qeverisë vetveten në nivel qendror dhe lokal dhe në bashkëpunim

me bashkësinë ndërkombëtare të arrijmë atje ku jemi nisur. Në Kosovë askush nuk mendon të shkojë në Evropë me disa robër që nuk guxojnë të lëvizin në Kosovë dhe as me qytetarë të rendeve të ndryshme dhe të diskriminuar herë negativisht në dëm të pakicës e herë pozitivisht në dëm të shumicës, por të jenë të gjithë të barabartë para ligjit. I përshëndes përpjekjet e Grupit të Kosovës për statusin dhe për tha zoti Haziri. Sa është i suksesshëm ky do të shihet në fund. Është përgjegjësi e madhe dhe e di që nuk është e lehtë pozita e grupit tonë. Pozita e vështirë e grupit buron nga statusi i paqartë i vendit, i mbajtur me premtime se do të bëhet mirë, përballë palës serbe të mbështetur nga struktura shtetërore e saj, si e njohur ndërkombëtarisht. Përsëri diskutohet nga agresori vetëm fati i viktimës i Kosovës, ndërkaq fati i agresorit mbetet i garantuar, i pacenuar dhe i padiskutueshëm. Të gjithë po e shohim se Serbia, aq sa ka fuqi pa mëshirë po punon për ta dëmtuar vendin tonë. Të gjithë po e shohim se ndërmjetësuesi ndërkombëtar po i bën presion kryesisht viktimës, ndërsa agresorit po i bëhen favore të njëpasnjëshme dhe si rrjedhim Delegacioni ynë e ka pasur dhe do ta ketë edhe më vështirë në të ardhmen. Duke i mirëkuptuar të gjitha vështirësitë që dihen e që nuk dihen të Grupit për statusin e vendit dhe duke pasur parasysh se janë adresuar shumë lëvdata të Grupit, ju lutem më lejoni t'i adresoj edhe disa vërejtje dhe rekomandime që mendoj se do të ishin të dobishme për të pasur sukses në bisedimet për shkëputjen definitive nga Serbia. Delegacioni i Kosovës, për mendimin tim, nuk i është përmbajtur mandatit që i ka dhënë ky Kuvend në disa drejtime. Në këtë mandat nuk përfshihen bisedimet për çështjen e organizimit të brendshëm të Kosovës, siç është riorganizimi i pushtetit lokal për territorin e Kosovës, ende pa asnjë garanci zyrtare për statusin e pushtetit qendror të vendit. Delegacioni i Kosovës nuk ka sqaruar organizatorin se ndjehet dhe është i pabarabartë dhe nën presion të paarsyeshëm në këto bisedime. Ndërsa Serbia është e favorizua, e shpërblyer në vend të dënimit për obstrukcion. Kur bisedon me Kosovën për çështje të organizimit territorial të Kosovës në raport me vendet fqinje dhe me shtetet, Serbia është e favorizuar, vendet fqinje kanë shumicë dhe pakicë, por edhe vendet në rajon si Bosnja dhe Turqia. Ky është presion në mirëbesim dhe lojë jo fer, që nuk ndihmon stabilitetin politik dhe sigurinë në Kosovë. Serbia ende nuk e ka bërë asnjë deklaratë paqe për Kosovën dhe t'i lejohet nga Delegacioni i Kosovës që t'u rikthehet këtyre çështjeve, nuk ka domethënie tjetër pos një lloj pranimit të nënshtrimit. Serbia në heshtje po siguron prezencën e vet në Kosovë dhe vendi ynë përsëri rrezikon të mos i kalojë caqet e autonomisë, andaj Serbia është deklaruar se nuk është për ndarje të Kosovës. Tek e fundit pse të ndahet diçka që po gjen formë për t'u mbajtur e tëra, plus për ta ndarë në formë tjetër të autonomisë për komunitetin serb në kuadër të autonomisë së Kosovës, megjithëkëtë Grupi i Kosovës për statusin është duke u prezantuar gjoja se Grupi ynë ndihet i barabartë me Delegacionin shtetëror të Serbisë, siç u dëgjua edhe këtu. Delegacioni i Kosovës, gjithashtu, nuk ka reaguar as nuk ka sqaruar në bisedime dhe as publikisht skandalin diplomatik në këto bisedime. Është marrë vesh se në Delegacionin serb marrin pjesë edhe dy anëtarë që janë zyrtarisht funksionarë të lartë të Kosovës dhe që paguhën nga buxheti i Kosovës, ndërsa qëndrojnë kundër dhe në anën tjetër të Delegacionit të Kosovës. Kjo është fyerje dhe poshtërim në adresë të Kosovës, ndoshta edhe e paqëllimtë e organizatorit dhe e UNMIK-ut që e mundëson këtë. Cili vend do ta lejonte këtë? Po e shohim se për disa veprime financiare, në kuadër të Kuvendit, po punohet të ketë transparencë, ndërsa për këto skandale diplomatike në Vjenë, krejt të hapura, po heshtet. Si ka mundësi kjo, ju lutem.?

Siç është duke rrëshqitur situata me udhëheqjen e Delegacionit, vendit po i vazhdohet statusi i paqartë dhe po i afrohet edhe një periudhë e turbullt, shumë e vështirë ,që nuk mund të garantojë zhvillim dhe përparim të vendit. Është tepër gabim që paraprakisht të thuhet se ne nuk do të dalim nga bisedimet, në rast se Kosovës nuk i garantohet shkëputja e qartë nga Serbia. Do të ishte tragjedi nëse nuk dilet prej tyre nuk do të kishin kuptim as marrëveshjet nuk do të gjenin zbatim. Le të thotë kush çka të dojë edhe këtu edhe ku të dojë, se e ka thënë rastësisht edhe pa dashje z. Besnik Mustafaj ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, e ka thënë një të vërtetë shumë të madhe. Po u prek kufiri i Kosovës në favor të Serbisë askush më nuk mund t'i garantojë kufijtë në pjesë e tjera të Kosovës, por edhe të vendeve të tjera afër saj. Heqja dorë e Kryesisë së Kuvendit këtu nga një debat pak më i gjerë dhe jo i kufizuar në 10 minuta, si dhe heqja dorë e Kryesisë së Kuvendit nga debati tjetër për peticionin e rregullt të 46.000 qytetarëve të Kosovës, që për kërkesë ka krijimin e unionit shtetëror Shqipëri – Kosovë e ka lënë vendin tonë dhe ka lënë vend edhe për atë që po dëgjojmë se gjoja në Kosovë nuk ka pasur dhe nuk ka tjetër projekt, pos pavarësisë së Kosovës. Dobësi shumë e madhe e pjesëtarëve të Grupit të Kosovës për statusin janë propaganda dhe analizat, paraqitjet e pakursyera të tyre për suksese në bisedime, ndërsa Kryesia e Kuvendit ,siç e patë matet se si do të diskutohet këtu dhe sa do të diskutohet. Do t'i kisha thirrur anëtarët e Grupit të Kosovës për status e sidomos koordinatorin që nuk qenka dhe nuk e ka parë të arsyeshme të vijë këtu për çështje teknike, që në bazë të prezantimit publik nuk po del se është vetëm për çështje teknike, që t'i lërë detyrat për çka nuk janë ngarkuar, fushatat me publikun, fushatat për t'i mbushur mendjen këtij të fundit se ka arritur suksese, që s'po i kuptohen- sepse të jeni të bindu- se atje jashtë zyrave të institucioneve do ta kemi vështirë dhe do të dëmtohet vendi, atje siç e keni parë, pret populli i uritur dhe i pakënaqur me stërzgjatjen e situatave. Ju presin lëvizjet nga më të ndryshmet politike dhe nëse nuk ndaleni do të jemi edhe ne në këto medime dhe prej andej e gjithë çështja mund të bartet në rrugë. Ju jeni zgjedhur që të keni sukses në bisedime me bashkësinë ndërkombëtare e jo në bisedime me shoqërinë civile dhe me popull. Për këtë jemi të zgjedhur ne, më duket.Pasi është zgjedhur nga Kuvendi, pra nga një institucion, Grupi i Kosovës për statusin ka rrëshqitur me një pronar tjetër, është bërë pronë e partive politike, pra jo e institucioneve. Ja fakti. Në grupin e nivelit të dytë, ndihmës janë dërguar përfaqësues të grupeve politike që janë pjesëmarrës në këtë grup, ndërsa nuk është caktuar askush nga Kuvendi i Kosovës edhe nga Qeveria, kjo është fakt. Me qenë se partitë politike dominojnë në jetën e Grupit të Kosovës për status, atyre nuk u intereson fare që ky grup të raportojë në Kuvend, po shihet, andaj edhe u shty edhe kjo seancë e sotme dhe pretendohej të shtyhet në një tjetër, pse , sepse partia është e informuar për deputetët e Kosovës, të Kuvendit, kush po i ndien raportimet dhe rekomandimet që bëhen nëpër parti?

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë, propozoj që Kuvendi i Kosovës t'i miratojë këto rekomandime për Grupin e Kosovës për statusin e vendit: bisedimet të jenë jo sekrete,sepse po qarkullojnë edhe materiale që i kanë edhe këto emblema: sekret, tepër sekret zyrtar etj. Nuk është kjo në rregull, se duhet të jenë transparente për Kuvendin e Kosovës, të kërkohet nga organizatori të hiqet nga agjenda e bisedimeve me Beogradin çështja e decentralizimit. Kjo çështje bisedohet vetëm me bashkësinë ndërkombëtare dhe me minoritetet në Kosovë, pa përjashtim, ose të përfshihen në bisedime për decentralizim të gjitha shtetet fqinje edhe të rajonit,të gjithë ata që janë të interesuar, të

gjithë ata që shumicë dhe pakicë. Delegacioni i Kosovës duhet t'u sqarojë në takimin e ardhshëm se pjesëmarrja e funksionarëve të Kosovës me delegacionin e Serbisë është e pakuptueshme dhe organizatori i bisedimeve sqaroi se kjo situatë nuk mund të prejjudikojë pozicionin e Kosovës sot dhe nesër.

Në bazë të rregulloreve në fuqi të IPVQ-ve, zyrtarëve të Kosovës që dëshirojnë të vazhdojnë të shërbejnë në Delegacionin e Serbisë ,t'u plotësohet kjo dëshirë, por t'u merret mandati dhe t'u ndërpritet financimi nga buxheti i Kosovës. Presioni ndërkombëtar i paarsyeshëm dhe i njëanshëm dhe mbi të gjitha mirëbesimi i organizatorëve të bisedimeve për statusin, duhet të shpjegohen nga Grupi i Kosovës ,në mënyrë që Kosovës t'i jepen garancitë e nevojshme ndërkombëtare për të ardhmen e saj , ndërsa Beogradi të thirret të vendosë paqe dhe fqinjësi të mirë me vendin tonë. Me qëllim të funksionimit më të mirë të hartohet rregullorja e punës e Grupit të statusit për funksionimin normal, për arsye organizimi dhe efektiviteti për nevoja teknike e financiare dhe të silltet në Kuvend për njoftim ose për procedim të mëtutjeshëm. Të plotësohen vendet në rrethin e dytë që shpesh po quhen politikë të Grupit me përfaqësues që i caktojnë Kryesia e Kuvendit dhe kryeministria. Të jetë prezent në bisedimet ndërkombëtare në cilësinë e vëzhguesit edhe kryetari ose përfaqësuesi i Komisionit Parlamentar për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Euroatlantike. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Faleminderit. Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar të AAK-së Gjylnaze Sylja

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, mysafirë të nderuar, deputetë të nderuar. Grupi Parlamentar i AAK-së ka deklaruar më parë dhe mbetet në qëndrimin e vet që ta përkrahë Ekipin e Unitetit për dokumentin dhe strategjinë e tij lidhur me çështjen e reformës së pushtetit lokal. Qysh në seancën plenare të Kuvendit, të mbajtur në maj të vitit 2005,i kemi përkrahur parimet e atëhershme të prezantuara nga Qeveria e kryeministrit Kosumi dhe sot mirëpresim faktin se edhe opozita i ka përqaftuar ato parime. Konsiderojmë se reforma e pushtetit lokal është një proces i domosdoshëm dhe i dobishëm në Kosovë për afrimin e pushtetit te qytetari, për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe për ofrimin e shërbimeve më të efektshme për qytetarët e Kosovës. Grupi Parlamentar i AAK-së nuk mendon se nëpërmjet reformës së pushtetit lokal arrihet copëzimi ose kantonizimi i Kosovës , ngase koncepti i ofruar nga Qeveria dhe nga Ekipi i Unitetit nuk lejon këtë. Për fat të mirë për këtë ekziston pajtimi i pozitës dhe i opozitës, me gjithë atë për hir të sinqeritetit ndaj qytetarëve të Kosovës duhet ta bëjë të qartë edhe një të vërtetë se reforma e pushtetit lokal, përveç aspekteve të qeverisjes së mirë dhe efektive dhe të afrimit të pushtetit qytetarëve,në vete përfshinë edhe aspektin minoritar, duke u ofruar minoriteteve në Kosovë të drejta më të zgjeruara në fushën e arsimit, të shëndetësisë dhe të kulturës. Gjithashtu është e vërtetë se kemi konkluduar se reforma e pushtetit lokal do të ishte shumë më e suksesshme dhe më e lehtë për ne sikur të bëhej pas përcaktimit të statusit të Kosovës. Me gjithë atë bashkësia ndërkombëtare ka

kërkuar prej nesh, ta quaj ashtu ,paradhënie, pra dëshmi se ne do të jemi në gjendje të garantojmë t'i drejtat e minoriteteve pas statusit. Jam e bindur se Kosova do ta kalojë këtë test dhe do të dëshmojë se është e përgjegjshme për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, duke mos pranuar me asnjë kusht korridore që mund t'i lidhin enklavat serbe ndërmjet tyre në Kosovë. Me qëllim që situatën tonë ta bëjmë më të qartë duhet të potencoj se Kosova tani ka pjesë të territoreve që nuk kontrollohen nga ajo, prandaj e tërë energjia dhe potenciali duhet të përqendrohet në kthimin e këtyre pjesëve nën kontrollin e pushtetit të Kosovës. Në këtë aspekt reforma e pushtetit lokal do të ndihmonte që qytetarëve në këto pjesë të Kosovës t'u ofrohet më shumë përgjegjësi dhe vendimmarrje me kusht që t'i nënshtrohen pushtetit kosovar dhe jo të atij të shteteve të tjera. Apeloj edhe te Ekipi i Unitetit dhe te Qeveria që të tregohen të përgjegjshëm në procesin e reformës së pushtetit lokal, t'i qasen procesit pa paragjykime, por që njëkohësisht të jenë vigjilentë dhe të mos ndryshohen miratimet që i ka bërë ky Kuvend. Gjithashtu apeloj tek Ekipi i Unitetit dhe te Qeveria që në këtë proces nëpërmjet z. Ahtisarit t'ua bëjë të qartë bashkësisë ndërkombëtare dhe Qeverisë së Serbisë, se në Kosovë nuk ka decentralizim pa garanci paraprake se të gjitha territoret e Kosovës do të vihen nën kontrollin dhe autoritetin e Qeverisë së Kosovës dhe të UNMIK-ut që e ka këtë mandat. Bashkësia ndërkombëtare e ka bërë të qartë se reforma e pushtetit lokal nuk është kompromis, ajo, gjithashtu ,ka insistuar që popullata shumicë t'i ofrojë dorën e pajtimit minoriteteve të Kosovës, ka insistuar që procesi i reformës së pushtetit lokal në Kosovë të ketë përparim, pavarësisht nga përparimet në vendet përreth. Nga ana jonë kërkojmë nga bashkësia ndërkombëtare që administron Kosovë ta kthejë kontrollin dhe të ushtrojë pushtetin mbi tërë territorin e Kosovës ashtu që Kosova të funksionojë si një tërësi, kurse qytetarët e saj të integrohen në këtë tërësi. Kjo i plotëson nevojat dhe qëllimin e ndërtimit të shtetit funksional të Kosovës. Faleminderit për vëmendjen tuaj.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit. Ftoj kryetarin e Komisionit Parlamentar për Bashkëpunim Ndërkombëtar z. Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI

Kolegë të nderuar dhe të çmuar.

Ne si Komision Parlamentar për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike jemi njëri nga propozuesit institucionalë që kjo temë të vihet sot në rend dite, së bashku me AAK-në dhe me deputetin Emrush Xhemajli. Jemi të bindur që ky bisedim në Kuvend është i domosdoshëm, se ky është vetëm fillimi dhe ne sot as që do t'i shternin të gjitha interesimet tona, as që do të vendosim diçka të veçantë. Interesimi ynë ka qenë që njëherë e përgjithmonë njerëzit që mandatohen në këtë Kuvend ,t'i marrin përgjegjësitë e veta para mandatorit ose në Kuvend dhe -nën dy - të krijohet një përgjegjësi politike dhe përfaqësuese që unë nuk ngurroj ta quaj disiplinim shtetëror i përfaqësimit dhe i veprimtimit politik shtetëror. Këtu ne kishim një paraqitje në emër të Grupit Negociator, por dy tri -ditë më parë kemi pasur një raportim para komisionit tonë dhe në këtë kuptim e falënderoj z. Lutfi Hazirin zëvendëskryeministër i Kosovës,që ka raportuar edhe atje, mirëpo sot na është thënë si fjalë në Kryesi që Ekipi i Unitetit na ka

informuar në Kuvend që këtu do të miratojmë që dy udhëheqësit e dy takimeve të bisedimeve në Vjenë që përkthyer në emra që do të thotë Lutfi Haziri dhe Hashim Thaçi, pse nuk janë këtu, unë nuk dua tash këtu të spekuloj, por them se kjo është menjëherë një papërgjegjësi që nuk janë paraqitur komplet, nëse është papërgjegjësi e Ekipit të Unitetit, atëherë le ta marrë Ekipi i Unitetit, nëse është papërgjegjësi konkretisht në këtë rast e njërit prej udhëheqësive të Grupit e në këtë rast Hashim Thaçi, është papërgjegjësi e tij. Unë mendoj që këtu nuk ka çka të bisedohet tutje për këto probleme, veç se tash e tutje në bisedimet në Kuvend që do të ndodhin pastaj sigurisht se do t'i marrin përgjegjësitë e qarta të gjithë që janë. Tema jonë sa dëgjuam nga z. Haziri unë mund t'ju them shumë më hollësisht në Komision ka qenë shumë më substanciale atje, kurse këtu ka qenë më politike, por ajo na intereson sot në këtë fazë të bisedimeve, është pak a shumë, për çka bisedohet atje, për çka është biseduar deri më tash dhe çka do të bisedohet tutje? Për çka bisedohet, artikujt janë të ndryshme, ne e themi të gjithë se bisedohet për pranimin ndërkombëtar të Kosovës dhe ne mandat tjetër në Kuvend edhe nuk kemi dhe ata që ne i kemi mandatarë për bisedime, sa e di unë nuk kanë mandat tjetër, se i shtrihen një rezolute të Kuvendit të Kosovës, që i obligon dhe që vetë e kanë marrë parasysh që do ta kenë moto të punës së tyre problemin ose çështjen e pavarësisë së Kosovës. Kjo që themi ne rruga ndërkombëtare e pranimin të Kosovës që është fraza lapidare e presidentit Rugova, ka të bëjë me këtë rrjedhë që ne e quajmë politikë diplomatike të pavarësisë. Sa i përket deklaramitit ne e kemi bërë deklaramin edhe me referendum edhe në Kuvend dhe nuk ka mbetur shumë retorikë rreth kësaj.

Ekipi ynë thotë që për të arritur atje bashkë me miqtë tanë ndërkombëtarë ose me Ekipin Ndërkombëtar të bisedimeve duhet të krijohet pakoja paraprake, që ne e themi pakoja e pavarësisë së Kosovës, ku duhet të bisedohen një mori temash që në të vërtetë janë rregullim sistemor i brendshëm i Kosovës, që po e them paraprakisht. Po ju them se nuk është shumë i thjeshtë, nuk është kaq i thjeshtë dhe kaq i butë qysh e paraqiti z. Haziri, këtu nuk është i thjeshtë dhe i butë, siç e propagandojnë në takimet jointucionale publike ekipet negociatore, ne i kemi dëgjuar nëpër gazeta, nëpër grupe të shoqërisë civile, të partive të veta etj. Problemi është shumë më i thellë. Problemi që e kemi në diskutim është decentralizimi. Dikush i thotë më butë reforma e pushtetit lokal për t'iu ofruar pushteti lokal më afër qytetarit, që është më moderne të thuhet. Tjetrit i themi decentralizim. Me kohë kam thënë në këto banka të Kuvendit edhe në vitin e kaluar, decentralizimi do të thotë ta kesh njëfarë qendre diku të pushtetit, Kosova ende qendër të pushtetit nuk ka. Ky është problemi, sepse organet e përkohshme të Kosovës kanë gjysmë pushteti ose qerek pushteti real me Kornizën Kushtetuese të tashme. Çka po decentralizojmë? Ky është problemi? Çka kemi ne që do t'u jepet komunave? Pra ne kemi një shkallorë të ndërtimit të brendshëm në këto bisedime pa u deklaruar një shkallorë, një rrjet i krijimit të pushtetit të parë lokal. Ky është problem sistemor, përkthehet që është punë decentralizimi, në esencë ne kemi një bisedë për decentralizimin që e ka nën një, problemin e pakicave për ta bërë më të qartë problemin e pakicës serbe. Ajo që është biseduar deri më tash substancialisht është biseduar si do të duket gjendja e pakicës serbe në Kosovë nesër ose sot. Kjo është esenciale dhe këtë deputetët duhet ta dinë dhe duhet ta dinë edhe qytetarët, pra këto bisedime a do të **lejojnë** kur të përkthehet dhe të bëhet konkrete që enklavat serbe do të bëhen legale dhe kjo a do t'i kënaqë apetitet e Beogradit. Kjo është çështja, ky enklavizim është se u intereson serbëve të Kosovës dhe a kanë hesap ta pranojnë si gjendje të vet, kurse ne mendojmë që nuk është

zgjdhje, sepse integrimi është zgjidhje, enklavizimi edhe po të shpallet si gjenet, një parajsë e rrethuar me mure nga të tjerët nuk thotë asgjë, është një ferr dhe kjo duhet të kihet parasysh. Ajo çka ka ndodhur deri më tash aq sa jam i informuar unë dhe jam përpjekur që të informohem me krejt fuqinë që e kam pasur, më shumë jo institucionalisht se sa institucionalisht . U tha se këto dokumente kurrë nuk kanë ardhur në Kuvend para deputetëve ,sepse në rend dite janë problemet e mëdha, problemet se a të bëhen lidhje horizontale që po i quajnë komunë dhe që i bie me krijue status të veçantë territorial politik dhe e dyta mënyra mënyra e financimit që po i bie a lejohet që një shtet tjetër me i financue komunat në Kosovë, janë probleme të rënda që janë në tavolinë, që janë diskutuar në Vjen dhe që kanë me u diskutuar brenda 4-5 ditësh edhe njëherë. Ne mendojmë që financim të një vendi tjetër prej një vendi tjetër sistematik nuk mund të ketë sepse ajo pjesë është e sunduar, e sunduar politikisht dhe me pare dhe kjo është ABC e jetës, siç nuk mund të ketë lidhje që i quajnë horizontale ose territorializim politik etnik i Kosovës, i askujt , pra as i serbëve. Pra këto objeksionet tona tash për tash.Pres dhe jam i bindur që Delegacioni i Kosovës i ka fuqinë argumentuese dhe përgjegjësinë politike dhe kurajën qytetare t'i mbrojë interesat e këtij vendi, ta mbrojë një Kosovë demokratike, sepse ne krijojmë paraprakisht një mosbarazpeshim politik brenda. Ajo që pastaj quhet pavarësi del si diçka e relativizuar, ne duam Kosovë të pavarur dhe demokratike dhe kjo nuk është formulë. Nuk është përrallë.Ky është një program politik dhe institucional i të gjithë neve këtu por edhe i partive politike që e bëjnë këtë Parlament. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit profesor, radhën e kanë shefat e grupeve parlamentare nëse ka të interesuar. Fjalën e ka z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

I nderuar z. kryetar, të nderuar deputetë.

Grupi Parlamentar i PDK-së dhe Partia Demokratike janë pjesë aktive e procesit politik për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Ne jemi të bindur se edhe përfundimi i këtyre bisedimeve do të jetë mbi bazën e vullnetit të shumicës, për ndryshe ky proces nuk do të kishte kuptim. Fillimisht e shoh të nevojshme të them se këtu kemi një mangësi të madhe. Grupi i Unitetit që shpeshherë po e quajmë Grup Negociator, nuk ka rregullore të punës e cila do t'i ndërtonte disa raporte ndërmjet këtij grupi që është zgjedhur në Parlament dhe Parlamenti, por edhe nga institucionet e tjera që kanë dalë nga vota e lirë e qytetarëve, se përndryshe është e pakuptimtë që ne të bisedojmë për një raport të Grupit të Unitetit .kurse Grupi nuk është prezent në këtë sallë. Ne jemi të bindur se ky Parlament ka zgjedhur Grupin e Unitetit dhe vetëm ky grup për çështjen e bisedimeve në Vjenë e ka të drejtën legjitime për të raportuar para Kuvendit për çështjen e bisedimeve në Vjenë. Unë në parim pajtohem me fjalën e deputetit dhe kryetarit të Komisionit për Bashkëpunim me Jashtë z. Sabri Hamiti, por vërtet kur dëshirojmë të jemi parimorë është mirë që edhe ai të kërkojë që Grupi i Unitetit ta ketë një rregullore të punës dhe të funksionimit të tij dhe që grupi, ose më mirë të thuhet udhëheqësi i grupit ,që njëkohësisht është kryetar i Kosovës, t'i raportonte Kuvendit se çka është arritur në këto bisedime deri më tani. Me gjithë atë janë disa vërejtje që në të ardhmen Grupi i Unitetit

duhet t'i heq nga rendi i ditës, për ndryshe nuk është mirë që ekspertë ose pjesëtarë të tjerë të delegacioneve që nuk janë votuar në këtë Parlament, të raportojnë për një çështje ndër më substancialet që është për Parlamentin, për institucionet dhe për qytetarët e Kosovës. Mendoj që raportuesi dhe Grupi i Unitetit, së paku, në këtë Parlament, të tregojë diçka që është e vërtetë. E vërteta është se në Vjenë nuk po bisedohet për reformën e pushtetit vendor, as për decentralizimin. Në Vjenë po bisedohet vetëm për një pjesë të decentralizimit se çka institucionet e Kosovës u ofrojnë jo shumicës, por pakicës serbe dhe ndoshta vetëm në këtë raport ka kuptim që Delegacioni i Kosovës të bisedojë në Vjenë me palën serbe, me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar, përndryshe reformimi i pushtetit vendor dhe decentralizimi janë çështje të Kosovës, të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës në të ardhmen. Prandaj do të ishte mirë që edhe vetes t'i themi se këto bisedime po bëhen për palën serbe dhe për interesin e tyre. Duke qenë vetë një nga anëtarët e grupit politik, që kemi përgjegjësinë për përgatitjen e dokumenteve për Grupin e Unitetit, dua të them se ndoshta do të duhej që Grupi i Unitetit, së paku dokumentet që janë dorëzuar në Vjenë, t'i ishin dorëzuar edhe Parlamentit e dhe deputetëve të këtij Kuvendi. Kjo nuk ka ndodhur kështu dhe se ajo që ndiej për obligim dhe dua ta them është se dokumentet që janë hartuar dhe janë dorëzuar në Vjenë janë dokumente të mira dhe hallin nuk e kemi të këto dokumente, por nëse kemi parasysh dokumentin, ose më mirë të themi dokumentin e brendshëm që e ka hartuar dhe me të cilin ka shkuar Delegacioni në Vjenë. E dyta, nuk janë shqetësuese ajo që është përgatitur për t'u përgjigjur, por disa pyetje që janë bërë në atë dokument, për të cilin është biseduar në Vjenë. Pyetjet janë shqetësuese, jo materiali që është shkruar dhe është miratuar nga Grupi i Unitetit, pyetjet në një formë ose një tjetër tregojnë se në të ardhmen për çka do të bisedohet edhe nga mund të shkojë rrjedha në bisedimet e ardhshme. Mendoj se këtë çështje Grupi i Unitetit, që është dashur të raportonte këtu, është dashur ta cekte gjatë punës së hartimit të dokumentit, ku kanë qenë prezentë edhe deputetë të tjerë, por jo shumë të këtij Parlamenti, e kemi thënë. Ne si grup dhe si parti politike do ta mirëpresim dhe mirëkuptojmë të gjitha angazhimet dhe interesimet e bashkësisë ndërkombëtare për t'u interesuar për të ardhmen e qytetarëve të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, për pozitën e barabartë të qytetarëve të Kosovës sipas ligjeve e konventave të njohura ndërkombëtare dhe evropiane, që kanë të bëjnë edhe me të drejtat dhe me liritë e njeriut, por edhe të minoriteteve ose pakicave kombëtare. Do të dëshironim që këto angazhime edhe të Bashkimit Evropian edhe të Komitetit Ndërkombëtar në përgjithësi, por edhe të Serbisë, nëse është e interesuar për t'u vendosur rendi dhe paqja në Kosovë dhe për t'u vënë në shërbim të rendit dhe paqes në Kosovë, të jenë mbi bazat dhe normat e standardeve ndërkombëtare që përdoren për të drejtat e njeriut dhe për të drejtat e minoriteteve në Kosovë. Po e përfundoj fjalën time. Ne edhe si individë, mbi të gjitha do të angazhohemi për ta realizuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran, se jemi të bindur se vetëm një Kosovë e lirë e pavarur dhe sovranë, e njohur ndërkombëtarisht do të krijonte hapësirë për të gjithë qytetarët e saj, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, fetare apo edhe racore. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Ju faleminderit z. Krasniqi. Fjalën e ka deputeti Numan Baliq.

DEPUTETI NUMAN BALIQ

Dozvolite da selamim sve vas koji ste prisutni, i da istaknem da ću govoriti u ime grupe za integraciju, s obzirom da postoji jedan broj delegata kojima još uvek nije poznato ko je u sastavu grupe za integraciju, to su dakle osim predstavnika SDA, koje ja zastupam kao predstavnik naravno i moje zajednice bošnjaka, predstavnici takođe i partija Roma, Aškajlija, Goranaca i dvije partije Partija Liberale e Kosoves dhe Partija e Drejtesis. Mislim da je lepo da to izgovorim u originalu, ono što želim da kažem da mi želimo da damo puni doprinos razgovoru o budućem statusu Kosova, i da postoji jedinstveno raspoloženje u našoj grupi i ovih zajednica i partija da podržimo sve pregovaračke procese koji su u toku i da uzmemo učešće u tim pregovorima. Kao što je poznato pregovori se dosad vode na tri nivoa , najviši nivo je glavna grupa za pregovore ili takozvana grupa uniteta ili jedinstva , kao što znamo drugi nivo su radne grupe koje specifično razmatraju pojedina pitanja i naravno najniži nivo, odnosno nivo u kome se mi nalazimo direktno kome smo direktno uključeni kao zajednice, jeste odbor za konsultacije sa zajednicama koje vodi g. Suroi. Želio bi da konkretno dam predlog vezano za promene koje mislimo da se trebaju izvršiti, da bi proces pregovaranja bio što konstruktivniji i što funkcionalniji. Mi dosad nismo zadovoljni ni stepenom ni načinom uključivanja i ovih zajednica i ovih partija koje sam spomenuo u pregovore, iako smo mi uključeni u treću grupu, odnosno u najnižem nivou odbora za konsultacije sa zajednicama, ipak ne postoji dovoljno mogućnosti da mi odlučujemo na drugim nivoima, tamo gde se to pitanje razmatra u okviru radnih grupa, posebno nam je važno grupe gde se razmatraju odluke i donose odluke, kao što je političko strateška grupa, ali i grupa za ustavna pitanja, grupa za sigurnost, grupa za povratak, grupa za izbjegle, jednostavno, čitav niz grupa, naravno i grupe za zdravstvo, za socijalnu politiku, obrazovanje gde se razmatra čitav niz pitanja od značaja ne samo za ove zajednice koje sam spomenuo, nego i za sve druge delove društva. Takođe, želim da kažem da nismo zadovoljni time što od septembra meseca prošle godine nastojimo da iznudimo, da tako kažem da se u glavnoj grupi za pregovore, u takozvanoj grupi uniteteta uključi bar jedan od predstavnika manjinskih zajednica, mislim da sadašnja forma koja postoji pored svog uvažavanja rada koji imaju nije dobra zato što ona na neki način isključuje predstavnike manjinskih zajednica, posebno ovih takozvanih drugih zajednica koje mi predstavljamo ato su osim ovih koje sam spomenuo naravno i zajednice turaka, egipćana itd. Dakle, ovo su predlozi kako da pripreme za pregovore budući shodnije, konstruktivnije i da mi doprinesemo u njihovom celokupnom toku. U vezi sa ovim nivoom u kome smo uključeni vezano za odbor za konsultacije sa zajednicama, želim da istaknem da postoji jedno ne zadovoljstvo vezano za sam nivo razgovora, dakle, najpre sami nivo je zadnji odnosno treći nivo razgovora, zatim veće po svom imenu ili odbor za konsultacije sa zajednicama ima konsultativni karakter, sama činjenica da smo mi u mogućnosti samo da učestvujemo u konsultacijama, a nemamo mogućnosti da učestvujemo u donošenju odluka, je za nas na startu hendikepirajući i mi insistiramo da se to ispravi. Dakle, ne samo da učestvujemo, ne trebamo samo učestvovati u konsultacijama nego i u procesu donošenja odluka. Takođe želim da istaknem, da vrlo često za pojedine predstavnike zajednica izgleda kao da je ovaj odbor za konsultacije ustavri brana, da je prepreka da mi budemo uključeni u više nivoe, u radne grupe i u glavnu grupu za pregovore, grupu uniteta, jednostavno da ne

bi smo mogli dopreti tamo, dakle efekat je kontra produktivan i mi smatramo da u ovom momentu sada kako deluje odbor za konsultacije zajednica i učešće naših predstavnika u delegacijama koje su dosad odlazile u Beč, mi više nastupamo kao neko ko treba biti onaj ko će se pokazati pred svetom dakle, kao dekor da se kaže svetu, eto tu su i predstavnici manjinskih zajednica , a u stavri ono ne mogu ništa doprineti procesu razmatranja, odlučivanja i funkcionalnog dogovaranja. Navešću i dva primera koja su vrlo slikovita, na prvom sastanku koji smo imali odbora za konsultacije sa zajednicama održan je, dan je vrlo simpomatičan, 18. februara samo dan pre odlaska ekipe delegacije za razgovore u Beč, tada je razgovarano na taj način, što nam je jednostavno preneto, mi smo slušali jedno predavanje, to je bila jedna klasična slušaonica, jer smo odslušali predavanje aktera delegacije koja je odlazila u Beč, a gde nam nije pružena mogućnost niti smo upoznati sa dokumentom o decentralizaciji, niti smo znali o čemu će se pregovarati u Beču, niti je konsultovan bilo ko od predstavnika naših zajednica, a izabran je navodno pod znacima navoda naš predstavnik. Jednostavno smo bili u situaciji da slušamo ono što nam je rečeno i da damo bezrezervnu podršku, bila je jedna smešna, situacija ja sam to nazvao jednom loše pripremljenom predstavom ili farsom gde su pojedini učesnici izgleda dobili scenario da kažu ono što trebaju reći pa su se zaletavali u davanju podrške, neki su predstavnici zajednica, čak i govorili nama ne treba decentralizacija, nama uopšte ne trebaju standardi, mi imamo višak standarta, jednostavno to je bila jedna ružna farsa gde je dovedeno u pitanje, pitanje poštovanja zajednica. Mislim da ove druge zajednice trebaju biti poštovane da se prema njima treba odnositi sa uvažavanjem, a da ne trebaju biti predmet pripremanja ovakvih farsi i manipulacija koje smo videli . Na drugoj sednici odbora za konsultacije sa zajednicama mi smo očekivali da će stvar biti popravljena, 25. februara je održana sednica, klima je bila mnogo konstruktivnija, mi smo se dogovarali, doneli smo odluke, zajedničke, dakle predstavnici svih zajednica jednoglasno, zajedno sa g. Suroiem smo doneli sledeće odluke: da se nijedna naredna runda pregovora ne može održati bez zajedničkog dogovora, a kome će naravno predhoditi razmatranje, odlučivanje po svim pitanjima o kojima će se raspravljati, da se pre svake runde obavezno održi sastanak, dakle, pošto je druga runda bila predviđena za 17. mart mi smo se dogovorili da održimo sastanak 10. marta ili 11. marta i da se tom prilikom nakon savetovanja, dogovaranja jednoglasno izabere predstavnik koji će štititi najpre interese Kosova, potom interese svih zajednica i naravno interese svoje zajednice kao što je i pošteno, i naravno da u određivanju našeg predstavnika da se rukovodimo standardom koji primenjuju i albanske političke partije, dakle poznato je da na pregovore u Beč odlaze i predstavnici pozicije i predstavnici opozicije , ravnopravno odlaze dakle predstavnici iz LDK, PDK, AAK, ORE itd, međutim u slučaju drugih zajednica mi imamo nametnuti sistem gde nam se jednostavno kaže taj i taj predstavnik će ići ili u stvari uopšte nam se ne kaže, mi saznamo iz novina da će taj naš predstavnik biti onaj koji će zastupati zajednice. Taj princip mi nemožemo prihvatiti, mi predlažemo da predstavnik koji će odlaziti u Beč i koj će predstaviti manjinske zajednice da dobije zeleno svetlo od svih zajednica koje će konzenzualno kao što smo se i dogovorili na tom sastanku 17. marta, oprostite 25. mi smo se na tom sastanku dogovorili da na te druge pregovore ide drugi predstavnik i da se na svaku rundu pregovora iz ovih zajednica ide drugi predstavnik po sistemu rotacije, dakle dva ključna dogovora su bila postignuta, da održimo sastanak 10. i 11. na kome ćemo pripremiti našu platformu i da se na toj sednici odredi drugi predstavnik, a ne može ići nikako uvek isti predstavnik. Međutim desilo se

da su svi dogovori koje smo postigli sa g. Suroiem bili izigrani, ja ovde moram javno da protestiram protiv takvog načina odnošenja, jer on pokazuje otvoreno, neuvažavanje manjinskih zajednica njihovo ignoriranje i manipulaciju, tražimo dakle, promenu odnosa, tražimo pošten odnos koji će biti, punouvažavanja i koji će omogućiti da predstavnicima manjinskih zajednica ne zastupaju kao što sam rekao interese Kosova, interese svih manjinskih zajednica i pojedinačno na osnovu poštenog dogovora koji ćemo ispoštovati. U ovom smislu želim da kažem da ono što je vrlo bitno pitanje koje bih postavio i sebi i svima vama i poslanicima, zastupnicima u Parlamentu Kosova, prema tome mislim da ono što je gospodin Hamiti rekao na ovom sastanku da je ovo dobar početak razgovora Parlamentu o svim stvarima. Ono što mi tražimo jeste da nam se pruži mogućnost da kažemo svoju reč, ništa više, niko od nas nema nekih posebnih namera, niko od nas neće da pravi svoje države, niti možemo niti želimo. Naravno još jedno, imam primedbu vezanu za izjavu g. Hamitija dženet naravno niko nemože da ograniči, dženet je beskrajn on je veliki kao nebesa i zemlje, iako bog da biće mnogo nas u dženetu , nadam se. Dakle mi tražimo svoje mesto, želimo da budemo ravnopravni u procesu dogovaranja, reč je o integrisanim manjinama u pitanju su Bošnjaci, Romi, Turci, Egipćani, Aškajlije, pitanje koje se raspravlja jeste ekskluzivno manjinsko pitanje, naravno mi znamo da bi trebalo da se decentralizacija raspravlja kao pitanje sa aspekta i geografskog i kulturnog i funkcionalnog i svih ostalih, ali očigledno pritisak međunarodne zajednice, koji ne možemo ni izbeći ni sakriti, taj da se preko sistema decentralizacije to pitanje pre svega shvata kao ekskluzivno manjinsko pitanje, nije uopšte pametno da pitanja koja se tiču manjinskih zajednica da se ignorišu manjinske zajednice, ja se pitam kome je u interesu posebno ove zajednice koje su ignorisane, da li je u interesu Kosova ako se ignorišu Turci, Romi, Bošnjaci i oni koji su se već integrisali u kosovsko društvo. Mi se nudimo da damo puni doprinos, mi samo tražimo pošten odnos, mi samo tražimo da čovek koji će otići da predstavlja sve ove zajednice bude od nas i da zastupa sve naše interese, a ne da nam se nameće neki sistem manipulacija, koj nije dobar ni za Kosovo ni za nas. I na kraju i da predložim s obzirom da mi naravno svi imamo i konkretne predloge vezano za decentralizaciju za opštine koje će biti dodeljene, odnosno već su dodeljene Turcima, pa onda Bošnjacima vezano za Vitomiricu , Rečane itd, za Aškajlije opštinu Dubravi itd. Mi predlažemo da se poboljša kvalitet rada u odboru za konsultaciju zajednica to je predlog broj jedan, da odbor za konsultacije sa zajednicama ili promeni sistem rada ili da se, ja nagoveštavam, pokrenuti čitavu seriju razgovora i sa g. Suroiem sa institucijama Kosova, Vladom, Parlamentom i svima ostalima vlada zapadnih zemalja ili ćemo raditi pošteno i kako se treba dogovarati u interesu Kosova, ili će četiri zajednice u grupi za integraciju koje predstavljaju, Bošnjakke, Rome, Aškajlije i Gorance biti povučeni iz tog načina rada. Dakle, ozbiljno nagoveštavamo, i naravno da napomenem još to, nećemo otići u Drač na jedno putovanje koje bih ja najpre nazvao ekskurzijom, a mnogo manje dogovaranjem gde treba da bude 44 učesnika svi sa Kosova, umesto da se dogovaramo u Prištini treba da idemo u Drač, treba tamo da se plaća četvorodnevni smeštaj u hotelu, treba da se plate 44 avionske karte, naravno ja nisam neki dušeprižnik ali da vam kažem pravo moj lični motiv je što imam puno posla baš tih dana. Dakle, ne želimo da gubimo vreme, hoćemo da se dogovaramo ovde i da svi dogovori budu u interesu Kosova. Hvala vam!

KRYESUESI SABRI HAMITI

Fjalën e ka Xhezair Murati në emër të Grupit 6+.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI

Ja vas pozdravljam g. Predsedavajući, kao i naše kolege goste i g. Zamenika premiera. Parlamentarna grupa 6+ pozdravlja jedinstvo pregovaračke ekipe Kosova koja je početa veoma ozbiljnom temom, temom decentralizacije, mi smo deo te pregovaračke ekipe i gospodin koji je predstavljao manjinske zajednice ovoga puta je bio i predstavnik Vlade, jer se tematski govorilo o zdravstvu, o decentralizaciji zdravstva o čemu je i u uvodnom izlaganju gospodin Haziri rekao a potom dobio i legitimnu podršku od svih predstavnika zajednica o kojima je govorio prethodni govornik, prema tome ako neko predstavlja $\frac{3}{4}$ bošnjaka i predstavnik je tamo, ne znam ko može da mu uzurpira sa jednom četvrtinom ili sa 15% legitimitet, mislim da smo ozbiljno telo, Skupština je politička pozornica koja je glavna i koja se bavi zakonodavstvom i koja donosi odluke, ali je previše odgovorna da bi smo se bavili sa nekim stvarima i postavljamo u mesto na noge na glavačke. Ja bih danas nastavio da ova dva pregovora koje smo imali u Beču svakako danas analiziramo, sa jednom Skupštinskom sednicom, možda bi bilo mnogo efikasnije kada bismo pre početka pregovora vršili i dogovor oko nekih tema, uvažavajući neke oblasti koje se nemogu Skupštinski raspravljati, ali većina značajnih pitanja se mogu ovde razgovarati tako da bi odgovornost pregovaračke ekipe nakon toga podelili svi zajedno, ne možemo sada govoriti o odgovornosti a pre toga nismo i sami dali deo predloga, i ono što trebalo da bude deo predmet ovog razgovora. Za to kažem da u buduće predlažem da se pre početka sledeće runde pozabavimo temama koje će biti predmet sledeće runde itd. Za rad jedinstva pregovaračke ekipe koja je za sada evidentno, za rad odgovornosti koju tražimo nekada a da nemamo uvek pravo u toj meri, ja bih ovde rekao da je decentracija najambiciozni projekat koji utiče na budući status Kosova, a time i na prava manjinske zajednica koja su od teških značaja, bar smo do sada ovo videli da će to tako biti, a svakako i u buduće. Ja ovde imam jedan dokumenat koj je drugog marta u Strasburgu izdat i on je mišljenja o sprovođenju okvirne konferencije za zaštitu manjina na Kosovu, u njemu je veoma iscrpno data analiza kako se to prava manjina na Kosovu realizuje i stoji jedna konstatacija da se i Međunarodna zajednica i mi ovde često bavimo srpske manjine, a da često zapostavljamo ili zaobilazimo prava onih zajednica koje svi nazivamo integrisanim zajednicama, mislim da Kosovo prava integrisanih zajednica ulaganjem prava u manjinskim zajednicama, je veliki politički kredit i mi tome trebamo posvetiti veću pažnju, samim tim što integrisane zajednice traže ona prava koja ne izlaze iz okvira Kosovskog zakonodavstva, iz okvira ustavnog okvira, iz okvira važećih zakona koje smo usvojili ili planiramo da usvojimo. Time je jedan teret Kosovskoga društva sigurno smanjen, na taj način ja bih ovde takođe pomenuo da što se tiče ova tri nivoa pregovaranja, mi učešćem na prvoj pregovaračkoj ekipi mi smo samo delimično zastupljeni. Puna zastupljenost manjinskih zajednica će biti kada budu i u radnim grupama i u ekspertskim grupama i svim onim komisijama koje budemo birali, to nije lako reći, treba da nastavimo da se to na svaki način implementira. Međutim kada govorimo ovom procesu ja se dobro sećam zajedno sa vama da je Skupština Kosova na raspravi o reformi lokalne uprave prošle godine 19 i 20 maja tačno pre 10 meseci, posvetila čitavu jednu raspravu o tome, međutim mi u međuvremenu nemamo dovoljno

transparentnosti šta je sa pilot projektima opština, dokle se stiglo, šta je sa projektima opština, kojim kriterijumima ćemo se rukovoditi, dokle smo stigli sa zakonodavstvom o lokalnoj upravi. Svakako da su ovo veoma ozbiljna pitanja, mi smo zaokupljeni i drugim stvarima, ali vreme neumitno protiče i mi moramo sa ovim stvarima da se suočavamo, što god više transparentnosti bude to će biti manje nejedinstva, dakle više jedinstva, više slaganja u svemu onome što činimo a cilj svima nam je ovde svakako upravo to. Iz tih razloga kažem da mi moramo da se pozabavimo onim što dosada nismo a to je koji su kriterijumi za formiranje novih opština, mi to još neznamo pogotovo ne predstavnici manjinskih zajednica, šta je sa budućim opštinama koja su sela, ali veća sela, šta je sa budućim opštinama koje su naselja, šta je sa gradskim četvrtima, koji će biti prevladajući kriterijumi, da li demografski, ekonomski, prirodna bogadstva, ne znam koji još sve itd. Dakle ovo su veoma složena pitanja, ja se nadam, da će poseta koju je imao zamenik premijera i aktuelni ministar lokalne uprave Makedoniji, gde se dosta podmaklo u rešavanju ovog problema biti od koristi nama, ovde na Kosovu, u svakom slučaju na kraju zahvaljujemo na onome što je postignuto do sada na veoma dva značajna i zapažena pregovora. Ja na te pregovore gledam drugačije, realno, bez mnogo kritiziranja uz puno primedaba sigurno, itd. Hvala vam na pažnji!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatçija për grupin parlamentar Ora.

DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIJA: Faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë, Qeveri dhe të nderuar mysafirë.

Ne, si grup parlamentar, duke pasur parasysh që i kemi edhe përfaqësuesit në Grupin Negociator, në Grupin Politik dhe në grupe të tjera, e mbështesim fillimin e negociatave dhe të këtyre takimeve si diçka të domosdoshme dhe si rrugë nëpër të cilën do të arrijmë ta definojmë i statusit që do të ketë implikime pozitive në të cilat po presim për një kohë të gjatë. Ne si grup parlamentar kemi informata, në sajë të punës së përfaqësuesve tanë që na kanë informuar për rrjedhën e takimeve edhe pse mendojmë se do të ishte shumë më e vlefshme poqe se deputetët ta merrnin dokumentacionin e këtyre vizitave, nga delegacionet që ishin në Vjenë, në mënyrë që ky debat të jetë më i plotë dhe më konstruktiv. Mendojmë se temat që janë shtjelluar në takimin e parë dhe në takimin e dytë janë konkrete, me anë të cilave do të arrihet një qasje pozitive dhe nëpërmjet decentralizimit, që qytetari të ketë një qasje më të mirë dhe një jetë më të mirë. Mendojmë që delegacionet tona janë të përfaqësuar si duhet dhe kemi besim në kapacitetet e tyre, duke pasur parasysh që edhe Grupi Negociator që e kemi zgjedhur në Parlament, e ka fituar përkrahjen e Parlamentit që është në gjendje t'i zgjedhë përfaqësuesit që do të bisedojnë për statusin. Sa u përket komuniteteve unë nuk do të hyja në detaje dhe nuk do të përgjigjesha në këtë, por mendoj që pakicat jo serbe janë të përfaqësuar dhe si do të jetë përfaqësimi i tyre dhe kush do t'i përfaqësojë ata në Grupin Negociator dhe a do të dëgjohet zëri i tyre, mendoj së është një çështje e brendshme që duhet ta zgjidhin ata në këshillin konsultativ. Mendoj që nuk janë duke shkuar në ekskursionet, por nuk janë edhe vetëm duke biseduar, se mendimet dhe dëshirat e tyre do të përfaqësohen, por më tepër nuk do të kisha hyrë që në emër të tjetërkujt ta mbroj dike tjetër se askush nuk ka nevojë për mbrojtjen time. Unë e kam një propozim që përveç

temave që i kemi dhe grupeve tona të bisedimeve në Vjenë që i kanë shtjelluar ,do të duheshin edhe tema të tjera që më konkretisht një temë që ndërlidhet me ditën e sotme, me ditën e fillimit të bombardimeve dhe me pengjet e luftës, të jetë një temë me të cilën grupi ynë negociator dhe delegacionet tona do të merren në mënyrë shumë serioze, do të ishte e udhës që Grupi Negociator dhe Grupi i Unitetit ,të merret me këtë tem, duke pasur parasysh së kjo nuk është temë e ekspertëve, por është një temë thjeshtë politike dhe është duke u shfrytëzuar nga ana e Beogradit për negociata dhe për gjëra të tjera. Mendoj që kjo temë duke pasur parasysh se unë vij nga Gjakova,nga është numri më i madh i pengjeve dhe i dëmeve të luftës, do të duhej që edhe kjo temë të shtjellohet pa tjetër në Grupin Negociator,por edhe në tema të tjera. Për grupin tonë parlamentar nuk do të flisja më tepër. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI: Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari kryesues, të nderuar pjesëtarë të Qeverisë së Kosovës, te nderuar deputetë.

Ngurrova për ta marrë fjalën ,sepse ne në fakt lidhur me bisedimet që janë zhvilluar në Vjenë në dy raunde, nuk kemi raport të plotë, por raport të pjesshëm dhe nuk di se si mund të diskutohet në mënyrë konstruktive pa e pasur një raport të plotë dhe autentik prej njeriut që ka kryesuar Delegacionin në bisedime, qoftë në raundin e parë, qoftë në të dytin. Si do që të jetë, ndjehemi pak si të hendikepuar si deputetë, pjesën e raportit për bisedimet e Vjenës, që e dha z. zëvendëskryeministër Haziri e konsideroj n raport të plotë, të thukët , jo shumë detaje, por edhe me mjaft suksese. Për raportin e dytë mund të flas vetëm aq sa kam dëgjuar prej mediave. Në prononcimet pas kthimit nga Vjena, është thënë se kemi arritur sukses të jashtëzakonshëm në raundin e dytë të bisedimeve, sepse çështjen e ngritur nga pala serbe, që ata t'i financojnë komunat me shumicë serbe që janë të formuara dhe ato që do të formohen në të ardhmen, nuk do t'i financojë Beogradi. Pra ,qendra në Beograd, por kemi pranuar donacione. Donacioni dhe financimi kanë dallim, por nëse ai donacion është i përhershëm, bëhet si financim, që pala serbe ka synuar në donacion të përhershëm, kjo është një lidhje mjaft e fortë dhe ndërhyrje në sistemin e financave të Kosovës. Thonë pushka e trimit dhe dora e gjymertit kurrë nuk ndalet, ata le t'u japin donacione për projekte të caktuara, por me atë rast në Kosovë ndodh edhe segregacion ,sepse disa komuna do të zhvillohen shumë më shumë edhe ashtu janë mjaft të zhvilluara,madje është realitet se komunat dhe lokalitetet serbe i kanë rrugët të asfaltuara shumë më mirë se që i ka kryeqyteti Prishtina dhe janë të lidhura me rrugë dhe infrastrukturë. Janë të pajisura me mbrojtje shëndetësore, në arsim shumë më mirë se sa disa vendbanime me shumicë shqiptare, por kjo ne nuk na pengon, na pengon diçka tjetër. Çka synon pala serbe nëpërmjet këtyre bisedimeve dhe si t'u përgjigjemi çështjeve që ata i ngrisin në bisedimet e Vjenës e që ato çështje fare nuk kanë lidhje me dokumentacionin e përgatitur nga Grupi Negociator, përkatësisht grupi politik për Grupin Negociator. Ne e dimë se çka do të thotë reforma e pushtetit lokal dhe që reforma e pushtetit lokal bëhet për një shtet, nga ai shtet e jo ta bëjë reformën e pushtetit lokal shteti tjetër apo vendi tjetër për një vend fqinj. Por nëpërmjet reformës së pushtetit lokal thuhet se synohet që palës serbe t'i mbrohen të drejtat. Kemi edhe pakica tjera të cilave ua mbrojmë të drejtat dhe asnjëherë, as institucionalisht as faktikisht nuk u janë mohuar.

Asnjë qeveri e deritashme e Kosovës, por as bashkësia ndërkombëtare para themelimit të institucioneve qendrore nuk i ka mohuar të drejtat e tyre, por përkundrazi ka përdorur të ashtuquajturin diskriminim pozitiv. E kuptoj interesimin e palës serbe për minoritetin serb në Kosovë, mirëpo ky interesim, për t'u shprehur me gjuhën e popullit, është me hile dhe ka për synim kantonizimin e Kosovës ose fuqizimin e enklavave ekzistuese. Kur e them kantonizimin kam parasysh se qëllimi i regjimit të Beogradit që përndryshe fare në pikëpamje politike dhe ideologjike nuk ka ndryshuar nga regjimi i Millosheviqit, ka për qëllim dhe synon që Kosovën ta shndërrojë në Bosnaizim, të krijojë korridore, kantone, enklava të mëdha, të krijojë edhe pushtet lokal, kurse reforma bëhet për tërë Kosovën e jo vetëm për një pjesë të saj. Nuk e di grupi ynë negociator si mund t'u përgjigjet sfidave që ngriten në bisedime e që nuk i kanë të parapara në dokumentacionin e përgatitur paraprakisht për ato bisedime. Por më intereson dhe nuk dëgjova nga raportuesi për pjesën e parë të bisedimeve se cili është qëndrimi i ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, sepse në shtyp po lexoj se fjala vjen kur shtrohet çështja se komunat serbe të veriut të Mitrovicës duhet ta kenë një gjykatë të qarkut të veten dhe se gjyqtarët duhet t'i zgjidhin komunat serbe etj, etj, kemi një përgjigje se ia vlen të bisedohet për këtë çështje që për ne është krejtësisht e papranueshme. As Karta Evropiane për pushtetin lokal nuk e rregullon çështjen e këtij reformimi që të bëhet nga ana e shtetit tjetër, por shteteve anëtare të cilat e kanë nënshkruar atë kartë i obligon t'i përmbahen asaj dhe neve na thuhet se ne jemi pjesë e Evropës, se jemi në Evropë dhe nëse jemi ashtu, atëherë edhe reformimi i pushtetit lokal në Kosovë nuk duhet të na dalë jashtë kornizave të Kartës Evropiane për administratën lokale apo për pushtetin lokal.

Unë mendoj se është një lëshim shumë i madh që nuk e kemi edhe raportin tjetër për bisedimet e fundit, sepse këto kanë qenë shumë më të rëndësishme dhe në agjendë kanë qenë financat, bashkëpunimi ndërkomunal dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i komunave me strukturë të popullsisë shumicë serbe. Po afrohet edhe raundi i tretë i bisedimeve, më 3 prill dhe në raport nuk e kemi dhe nuk dimë se çfarë qëndrimi si deputet, si Parlament të marrim dhe çfarë vlerësimi t'u japim këtyre bisedimeve pa e pasur raportin e plotë, meqë refuzohet të vihet dhe të raportohet në këtë Kuvend edhe për raundin e dytë të bisedimeve. Kjo na shtyn të mendojmë për një mënyrë tjetër që të sigurohemi - ta kemi edhe një anëtar kur të shkohet në negociata në Vjenë ta kemi një anëtar të Komisionit për Integritet Evropian që t'i përcjellë të gjitha bisedimet dhe të raportojë, me qenë se anëtarët e Grupit Negociator, si kryesues nuk pranojnë të vijnë të raportojnë këtu dhe në fund jam krejt kundër që të formohet grup i veçantë për reformimin e Mitrovicës apo për çështjen e Mitrovicës. Edhe reformimi i pushtetit lokal në Mitrovicë duhet të bëhet sikur reformimi në krejt Kosovën, sepse edhe ajo është pjesë e Kosovës, por lypset të ushtrohet pushteti në atë pjesë të Kosovës dhe të vlejë të njëjtat rregulla për reformim edhe të Mitrovicës. Duhet të na kuptojë Bashkësia Ndërkombëtare se edhe me kaq përgjegjësi që kemi po përpiqemi t'u japim sa më shumë të drejta minoriteteve bile edhe më shumë se që garantohet në dokumentet ndërkombëtare, por gjithsesi nuk mund të heqim dorë nga pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës me çfarëdo çmimi që ai të realizohet. Ju faleminderit

KRYESUESI SABRI HAMITI: Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI: Ju faleminderit. I nderuari kryesues prof. Hamiti, i nderuar zëvendësministër, të nderuar anëtarë të Qeverisë, kolegë deputetë.

Decentralizimi, si proces politik tanimë i pranuar në Kosovë nga të gjitha qeveritë dhe subjektet politike. Ne sot po debatojmë pa dokumentin bazë dhe, si duket, kjo flet mjaft, por megjithëkëtë, këtë proces duhet ta konsiderojmë vetëqeverisje lokale, ku qytetarit i ofrohet shërbimi i shtetit duke krijuar funksionalitet, efekt dhe stabilitet e të shtrohet përsëri pyetja: A do të arrihet kjo në integrim të të gjitha komuniteteve në strukturat demokratike të Kosovës? Prapë shtrohet pyetja: A do të arrihet ky synim i qëlluar apo i paqëlluar dhe kurrsesi nuk duhet kuptuar si interpretim të disave për formimin e komunave të reja me ndarjen e kufijve kadastral ndërkomunal ndërmjet komunave ekzistuese. Në veçanti ne qytetarët e Mitrovicës me shqetësim më të madh po e përcjellim këtë proces mjaft të rëndësishëm në këtë fazë të shtetësisë së Kosovës. Për shkaqe të shumta dhe nga to do të veçoja: negociatat për decentralizim kanë filluar me Mitrovicën e ndarë, me shumë probleme të hapura për të cilat nuk shihet zgjidhje adekuate, reale dhe juridike. Nën dy, Grupi i Negociatave nuk e ka prezantuar strategjinë për procesin e integritit të Mitrovicës. Nën tre, nuk është sqaruar pozicioni juridik administrativ i Mitrovicës në procesin e decentralizimit në sferën e shëndetësisë, të arsimit, kulturës, drejtësisë, shërbimit policor, politikës sociale dhe në veçanti në atë financiare, duke mos e përcaktuar se financat a janë të përcaktuara, dedikuara apo në formë të donacioneve që në kuptimin financiar kanë kuptim të ndryshëm. Nën katër, në Mitrovicë nën masat e dhunës kanë ndryshuar struktura e popullsisë në veçanti- në pjesën Veriore- në dëm të shqiptarëve dhe procesi i decentralizimit fillon ngase atje nuk mund të kthehen mbi 23.000 qytetarë në shtëpitë dhe pronat e tyre. Për të qenë më e keqe pikërisht në këto rrethana politike Qeveria e Beogradit nëpërmjet Këshillit Nacional serb që në ato negociata pikërisht marrin pjesë anëtarë të këtij këshilli dhe asnjë anëtar i Mitrovicës, qoftë intelektual apo strukturë politike, bëjnë blerjen e pasurisë e pasurisë së shtëpive të shqiptarëve, situata ndërlikohet edhe më shumë dhe është më e keqe kur këto ditë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit pronarëve të banesave të shqiptarëve u ka paraqitur ofertë serioze për t'i blerë banesat, pa theksuar për ke dhe kjo do të thotë spastrimi etnik nga shqiptarët dhe krijimi i një komune serbe me të gjitha format e lidhjes me Serbinë. Ndosht pikërisht tani dhe jo rastësisht. Nën pesë, në Mitrovicë procesi i decentralizimit pa kthimin e të gjithëve në pronat e veta, pa krijimin e lëvizjes së lirë dhe pa kthimin e serbëve secili në komunën e vet, prej nga ka ardhur atje dhe krijon probleme, ky proces për këndvështrimin tim është pak sa i përcaktuar në kuptimin themelor juridik të tij. Nën gjashtë, unë si deputet dhe qytetarët e Mitrovicës kemi shumë pak informacione lidhur me procesin politik rreth Mitrovicës dhe decentralizimit nga se për qytetin e Mitrovicës ka pasur dhe po ka plane dhe takime të fshehta në qendrat e vendosjes me qëndrime diametralisht të kundërta, duke filluar prej premtimeve në fushatën zgjedhore shumë të mëdha, plani i ES-it, qëndrimi i Grupit të Kontaktit, takimet e fshehta në Londër, Norvegji dhe takimi i fundit për mua është një hap prapa në politikën e decentralizimit dhe roli i politikës lokale që nga viti 1999 – 2000 në pengimin e integritit të qytetit si segment i veçantë dhe i pa trajtuar në nivelin lokal dhe atë qendror, me njerëz që kanë ushtruar dhe ushtrjnë sot pushtetin. Në këto rrethana shtrohet pyetja e idesë se a kemi nevojë ta kemi një nëngrup që do të merrej me decentralizimin e Mitrovicës. Analizat e mia çojnë në konkludimin se jo, sepse kjo çon në ringjalljen e një projekti të ES-it për ndarjen e Mitrovicës dhe bashkimin e saj me Zveçanin për ta krijuar një koncept

monietnik që është në kundërshtim dhe që shtrihet diametralisht kundër së drejtës së shqiptarëve për një Mitrovicë të integruar dhe të serbëve për një Mitrovicë të bashkuar në kuptimin e enklavave. Ajo që është esenciale, decentralizimi kurrësesi nuk duhet kuptuar dhe as nuk duhet krijuar mundësi të komunave serbe apo shqiptare, por komuna në interes të qytetarit pa dallim, pa kritere dhe pa koordinime etnike, enklavizime apo lidhje vertikale dhe horizontale, nga se nënkomunat, siç parashihet me përfaqësimin e vet do të kuptojmë një organizim të dy niveleve të pushtetit në Mitrovicë konkretisht. Në Mitrovicë me kompetenca të mëdha mbi të gjitha format që deri sot i njeh forma e decentralizimit. Ky projekt duhet t'i preokupojë të gjitha nivelet në Kosovë dhe në veçanti pushtetin qendror dhe atë lokal si një segment i koncentrimin, të decentralizimit në një njësi që ka qëllime të caktuara. Duke pasur çdoherë parasysh faktin se standardet e Unionit Evropian në ndarjen territoriale të shtetit në hapësirat administrative të saj bëhen me ligj si dhe mbikëqyren legalitetet e komunave që bëhet nga Qeveria nëpërmjet njësisë së pushtetit lokal dhe pikërisht në këtë drejtim duhet shtruar qëndrimin për fuqizimin e saj. Shoqëria jonë demokratike qytetarëve duhet t'u garantojë të drejtën e vetëvendosjes lokale nëpërmjet trupave përfaqësues dhe jo mekanizmave të rezervuar paraprakisht nga anëtarët e zgjedhur me votën e fshehtë dhe të barabartë të drejtëpërdrejtë, për t'i mundësuar administratës dhe çështjeve lokale në pajtueshmëri të plotë me parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe jo mbi parimet e marrëveshjeve qëllimore politike dhe në këtë mënyrë me ligjet sistemore kjo çështje të përcaktohet me standardet e Unionit Evropian nga se shumë standarde të parashtruara as Unioni Evropian nuk i respekton në shtetet e tyre dhe për qytetarët tjerë. Për të arritur këtë qëllim të lartë demokratik komuna do të jetë formë themelore e vetëqeverisjes, pa vija kadastrave e jo sipas kritereve të popullatës. Këtë të keqe të vërtetuar parimisht kundër parimeve juridike sot e kemi në Mitrovicën e ndarë dhe nuk do të ishte mirë dhe nuk do të jetë e qëlluar të pranohet në tërë Kosovën. Në procesin e decentralizimit jemi të obliguar të ruajmë integritetin territorial të Kosovës, funksionalitetin e pushtetit lokal në të mirë të gjithë qytetarëve pa të privilegjuar askë si synimi parësor i parimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë, duke u dhënë pakicave dhe duke u premtuar dhe garantuar realizimin e të drejtave, por jo duke i enklavizuar dhe mbyllur në enklavat e tyre që është në kundërshtim me procesin e decentralizimit. Jemi të obliguar në të gjitha bisedat e mëtutjeshme Mitrovica të jetë në qendër, por jo me format dhe përfaqësuesit e grupeve të serbëve të pjesës veriore, që paraprakisht janë deklaruar se duan të krijojnë një Mitrovicë. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI: Ju lutem po e bëjmë një pauzë deri në orën 12,300.

Vazhdimi i seancës plenare pas pauzës.

KRYESUESI, SABRI HAMITI: Fjalën e ka deputeti Mazllum Kumnova.

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA: Ne e pranuan këtë informacion nga delegacioni i Kosovës, edhe pse si deputetë besoj se jam në të njëjtin mendim si edhe kolegët tjerë, se jemi vonuar në informim, meqë informacionet e para i kemi marrë nga mediat qofshin ato qendrore edhe pse jo ato lokale.

Këtu i shprehu rezervat e mia për korrektësinë për atë që jemi marrë vesh në këtë Kuvend. Bëjë pyetje se përse me kaq vonesë ky informim i tillë i drejtë për drejtë për zhvillimet në Vjenë. Bile as materiali është shënuar si tepër sekret, nuk di pse është klasifikuar si ti tillë, dhe e kemi marruar me vonesë, kjo është e para.

E dyta, shqetësimet e mia shkojnë drejtë parimeve themelore të reformës së pushtetit lokal të koncentruara kështu pa i diskutuar dhe miratuar, duke përcaktuar se deri në cilin nivel mund të jetë delegacioni i jonë fleksibil dhe ku mbarojnë kompetencat e tij, gjithnjë duke respektuar vullnetin e popullit dhe mandatin që ka marrë nga ky Kuvend.

Koncepti i ndërlidhjes horizontale aq i diskutuar vërtetë është se krijon një hallkë të re të qeverisjes, e cila dihet se ku fillon por mund të mbaron diku kah Beogradi. Nëse objektivi i reformës së plotë të pushtetit lokal, nga e cila reformë do të përfitojnë të gjithë banorët e Kosovës, ashtu siç është thënë në dokument për të cilin pajtohëm, por mua më shqetëson pse shtohen përfitimet e veçanta përsëri është si thuhet po në të njëjtin dokument përfiton një minoritet konkretisht serb duke e shkallëzuar me interesa të veçanta apo si thuhet në interesa vitale. Pse kjo privilegj ose nga reforma e pushtetit lokal përfitojnë të gjithë ose asnjë. Ne në një reformë të tillë nuk ka interes të kufizuar vetëm për një minoritet qoftë edhe për shumicën.

Tjetër, presionet ndaj institucioneve tona që të fillojmë menjëherë me decentralizimin ende pa krijuar në një infrastrukturë të qëndrueshme ligjore, ende pa status përfundimtar do të krijonte një veprim kontrabandë të ndryshimeve në qeverisje dhe jo nisje e mirëfilltë e një reforme. Çdo reformë kërkon mbështetjen financiare. Pa një konstrukt financiar nuk di se mund të fillohet një reformë. Edhe për këtë reformë që jemi të interesuar ta fillojmë ne na duhet çmimi i saj edhe pastaj ta vlerësojmë se a mund ta përballojmë buxhetin e Kosovës edhe ashtu i varfër. Do të ishte një aventurë në kushte të tilla. Janë këto çështje që na shqetësojnë. Desha të dal aty se delegacioni i jonë duhet të jetë i mbështetur në realitetin tonë dhe të mos shkëputet nga ky realitet. Unë e kuptoj se ky do të jetë proces shumë i vështirë, por nuk dua të fluturojë si në ëndërr, kur të lëshojnë ëndrrat të kapin dhembjet thotë një këngë e moçme shqiptare. Dhembja nuk është ndarë në rrugëtimin tonë historik si popull, por është sakrifikuar aq shumë për një liri përfundimtare sa që çdo shkas për dhembje të re do të ishte i pa përballueshëm. Kjo nuk ma mbush mendjen se nuk duhet të bisedohet edhe me serb. Prurjet e shekujve të hershme i kanë sjellë fqinjët, shpesh fatkeqësisht jo si fqinjë, e pranojë e gjithë kjo të kuptohet si shqetësim. Jemi kah bisedojmë për një çështje jetike. Shqetësimi nuk do të thotë pesimizëm, e kundërta. I mbështesë zhvillimet e deritanishme por kërkoj një mobilizim për një seriozitet më të madh. Ju faleminderit.

KRYESUESI, SABRI HAMITI: Fjalën e ka deputeti Ferid Agani

DEPUTETI FERID AGANI: Ju faleminderit z. kryesues, i nderuari zëvendës kryeministër, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, të nderuar ministra, të respektuar mysafirë.

Ndodhemi në vorbullin e zhvillimeve politike rreth përcaktimit të statusit final politik të Kosovës. Interesat e shumta politike ekonomike, gjeostrategjike dhe ushtarake të faktorëve të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtarë ndërthehen çdo ditë e më shumë duke e bërë këtë proces kompleks dhe të shumtën të pa kapshëm për ata që nuk disponojnë me informatën e nevojshme, e të tillë janë shumica e qytetarëve të Kosovës, e besa edhe disa prej deputetëve në këtë sallë.

Qytetari i Kosovës sot është në situatën që të përcaktohen prej njëren nga dy opsionet e shpjegimit të proceseve aktuale. Opsioni i parë më optimist dhe tërësisht pasiv, rezymohet në formulimin, Amerikanët dhe miqtë tanë në Evropë dua të na sigurojnë pavarësinë, kjo është e vendosur që moti, ne vetëm duhet të jemi bashkëpunues të dëgjueshëm dhe çdo gjë do të përfundojë mirë.

Opsioni i dytë më pesimist, dhe sërish pasiv thotë: në fund të bisedimeve me palën serbe, Kosova ka me qenë aq e copëzuar dhe e ndikuar nga Serbia sa që për sovranitet nuk do të mund të mendohet, e lëre ma të flitet. Ajo që mua personalisht dhe partinë e drejtësisë të cilën e përfaqësojë, veçanërisht e pengon dhe brengos është mungesa serioze e transparencës së këtij procesi për çka edhe shumë deputetë të këtij Kuvendi, lidhur me çështjen për të cilën po debatojmë provojnë të nxjerrin informata nga shkrimet në gazeta.

Argument për këtë është edhe vetë seanca e sotme. Para deputetëve të Kuvendit të Kosovës nuk gjendet asnjë material prej të cilët mund të kuptohet se si zhvillohen proceset në fjalë dhe puna e Grupit të Unitetit dhe grupit të tij politik strategjik deri as raporti i zëvendës kryeministrit për bisedime, fjalën e të cilit e dëgjuam sot. Shtrohen pyetjet: çka paraqet Kuvendi i Kosovës për Grupin e Unitetit, më lejoni ta quajë grupi edhe pse emërtimi zyrtarë është ekipi i unitetit, po mu më duket shumë sportiv. Për çka mund të fletë kjo. Si profesionist që merret me zhvillime psiko - dinamike në rrafshin individual dhe kolektiv, fillimisht konkludoj për shkallën e theksuar të pa sigurisë të grupit të unitetit. Anëtarët e tij kanë hyrë në proces për të cilin shumë mirë e dinë se si dëshirojmë që të përfundojë, por për të cilin definitivisht nuk e dinë se si do të përfundojë. Së paku jo me shkallë të domosdoshme të para shikueshmërisë së zhvillimeve.

Diskrepanca ndërmjet dëshirave, dhe realitetit, bëhet tmerrësisht e frikshme në dritën e sakrificave monumentale të popullit të Kosovës dhe veçanërisht të popullit shqiptarë të Kosovës, për arritjen e lirisë në Kornizat e shtetit të pa varur. Në situatat e këtilla ajo që ndodhë më së shpeshti është regresioni në të menduar dhe në mënyrën e përjetimit të ngjarjeve. Në situatën tonë kjo manifestohet në mungesën e guximit, që para Kuvendit të Kosovës të shpaloset e vërteta, të pranohet se qasja ndaj bisedimeve është në mënyrë të pa pranueshme e fragmentarizuar dhe se me këtë kanë hyrë në këtë proces të pa përgatitur sa duhet. A mund të ketë arsye për këtë, unë jam i mendimit se arsyeimi i pjesërisht se mund të gjendet të gjithë duhet të jemi koshientë se vendimi përfundimtarë për statusin politik të Kosovës, do të jetë rezultat i kompromisit historik të fuqive të mëdha të kohës.

Në këtë aspekt mund të kuptohet dëgjueshmëria ndonjëherë e skajshme e Grupit të Unitetit dhe në përgjithësi e institucioneve të Kosovës para faktorëve relevant e vendimmarrës. Por ajo që nuk mund të pranohet është paaftësia që kjo të artikulohe në mënyrë të sinqertë dhe të hapur para popullit të Kosovës, dhe tendenca që të krijohet atmosfera infantile, fëmijërore sipas rëndit të parë të bisedimeve kur kinse fituam, ose pas të dytit, **që duket këtu, se u ndamë baras**. Unë lus Grupin e Unitetit që të sigurojë shkallë shumë më të lartë transparencës, të seriozitetit dhe të pjekurisë gjatë këtij procesi. Konsiderojë se duhet dalë para popullit dhe në mënyrë të hapur, të sinqertë, dhe të arsyeshme, të shpjegohet se çka është ajo që duhet bërë kompromis në rast se dëshirojmë që bashkësia ndërkombëtare ta pranojë pavarësinë e Kosovës. Jam i bindur se populli do t'i pranojë argumentet e qëndrueshme. Por për ta bërë këtë grupi i unitetit duhet ta dijë këtë qysh tani se në çka mund të bëhet kompromis dhe në çka jo. A e din ky grup në këtë moment në të gjitha aspektet relevante, konsiderojë se jo, prandaj, është në situatën që para secilit raund të bisedimeve të merr detyrat e shtëpisë që duhet kryer, herë nga e majta herë nga e djathta, a është kjo rrugë e drejtë, me siguri jo. Është vërtetë se mozaiku përbëhet nga copëzat por paraprakisht ekziston korniza e figurës së mozaikut që duhet plotësuar.

Grupi i Unitetit duhet ta ketë këtë kornizë. Vizionin e shtetit të ardhshëm të Kosovës me të gjitha detajet e funksionimit të tillë. Vetëm në këtë mënyrë zgjidhjet për çështjet e veçanta do të jenë gjithmonë në funksion të çështjes së përgjithshme, në të kundërtën do të kemi një shtet **Frankeshtajn** të përbërë nga copëzat që kurrsesi nuk do të jenë në gjendje të funksionojnë si tërësi harmonike.

Të nderuar deputetë, vetëm shikoni shembullin e Bosnjës të dizajnuar në Dejton dhe shumë gjëra do të bëhen më të çarta. Një thënie popullore thotë se: Nëse hipë në një tren të gabueshëm, të gjitha stacionet do t'i kesh gabim. Dhashtë zoti i Madhërishtëm që të mos jemi në tren të gabuar, por edhe nëse jemi ende nuk është vonë për ta ndërruar për të hipur në të duhurin. Bashkëpunimi në Kuvendin e Kosovës në këtë proces i domosdoshëm dhe e vetmja mënyrë e sigurimit të interesave shtetërore të Kosovës. Duke mos dashur në asnjë moment që do të tingëllojë si kritikë i pasionuar, duhet pranuar se shenjat e para nuk janë pozitive. Më lejoni që në mënyrë më të vendosur të shprehë mospajtimin me neglizhencën e grupit të unitetit në procesin e përgatitjes së kësaj seance plenare. Kujtojë se tërë procesi është nënçmuar dhe se Grupi i Unitetit ende nuk ka arritur që të krijojë vizionin në shtetit të ardhshëm të Kosovës në të gjitha aspektet relevante të tij . Kjo mund të na kushtojë shumë në funksionalitetin e shtetit të ardhshëm. Për t'i parandaluar këto zhvillime është e domosdoshme që Kuvendi i Kosovës në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë dhe vendorë në mënyrë urgjente paralel në procesin negociatorë të përpilojë projektin e Kushtetutës së Kosovës. Në të cilin do të përcaktoheshin parime gjithë përfshirëse juridike të shtetit të pa varur të Kosovës. Në këtë mënyrë do të sigurohej që zgjidhjet parciale të cilat do të rezultojnë nga procesi i bisedimeve gjithnjë të jenë pjesë funksionale të tërësisë së projektuar kushtetuese dhe jo pengesë e saj.

Të nderuar deputetë apelojë te të gjithë ju, te të gjithë grupet parlamentare që kjo çështje në një mënyrë urgjente të përcaktohet si prioriteti më i lartë. Ju faleminderit.

KRYESUESI, SABRI HAMITI: Fjalën e ka Mahir Jagcilar

DEPUTETI MAHIR JAGGJILAR: Ju faleminderit. **Sayın Meclis Başkanı, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri**

En başta Viyana görüşmelerinin iki raunduna katılanları ve bugün rapor sunmaya hazır olduklarını selamlamak, bununla birlikte başarılı çalışmalarından dolayı onları kutlamak istiyorum.

Bizler hepimiz, Kosovanın oldukça hassas bir dönemden geçtiği ve halkın iradesi neticesinde siyasi çözümüne ulaşılmasında bulunduğu bilincindeyiz. Fakat, böyle bir çözümün sağlanması için, müzakere sürecinden geçilerek, yeni Anayasanın hazırlanması ile getirilmesi, yerel yönetim reformunun gerçekleştirilmesi ve uluslararası toplulukla işbirliğinin devam etmesi gereklidir.

Ön açıklamalarda bulunanların belirttiklerine göre, Kosova statüsüyle ilgili dolaysız müzakereler Viyanada düzenlenen toplantılarda başlamıştır ve bunların aynıları başarıyla sonuçlanmalıdır.

Katılım ile siyasi tutumu açısından Kosova Heyetinden memnunuz ve müzakereler ekibinin çalışmalarını aynı tempoyla devam ettirmeleri için ileride de destek sunmaya çalışacağız.

Birlik ve ortak tutumlar çok önemlidir ve bu gibi pratik ilerde de devam etmelidir. Müzakereler ekibinin hazırlıkları ve görüşmeler için belgelerin hazırlanması büyük bir ciddiyetle devam etmelidir, çünkü bu Heyet, hem Meclise, hem de Kosova halkına sorumludur, bu yönde bizler de destek sunacağız.

Türk topluluğu ve diğer topluluklar açısından, müzakereler heyetine tüm toplulukların katılması prensiplerinin ve müzakereler belgeleri ile Kosovanın nihayi statüsünün çözümlenmesine Türk ile diğer topluluklar istemlerinin yerine getirilmesi prensiplerinin zamanında saptanması oldukça büyük önem taşımaktadır.

Maalesef, bilindiği gibi ne Türk topluluğu, ne de diğer toplulukların Ana müzakere ekibi veya diğer müzakere gruplarında katılımları sağlanılmamıştır. Müzakereler sürecine sadece Sayın Veton Suroi'nin yönettiği topluluklar danışma kurulu sayesinde temasta bulunmaktayız. Bu güne kadar 3 toplantı gerçekleştirilmiş ve bu toplantılarda genel sorunlara değinirken, hala tüm sorun ve isteklerimizin yerine getirme yolları sağlanılmamıştır.

Öyle ki, bu güne kadar, Müzakere ekibi tarafından yapılan evraklara önerilerimiz ve topluluklardan müzakerelere katılacak kişilerin seçilme yöntemini gerçekleştirme şansımız olmadı. Prensipite Yerel yönetim reformu belgesinin iyi olmasına rağmen, bizim bu belge üzerine öneri verme şansımız maalesef olmadı. Müzakere süreci esnasında bizim için tek mantıklı olanı, öneri ve isteklerimizi asıl Kosova Müzakere ekibine verme imkanı olmasıdır. Ayrıca bu istekleri, evrakların kabul edilmesinden önce ve Viyana'ya gitmezden önce belli müzakere grupları tarafından görüşülmesi ve değerlendirmesi önemlidir. Viyana'da ki görüşmelere katılan temsilcilerimiz sadece Kosova çıkarlarının savunucusu olurken, burada yani Mecliste, Danışma kurulu veya müzakere gruplarında toplulukların savunucusu olmalıdırlar. Yerel yönetim reformu

örneğine gelince, uyarımız dillerin kullanımıyla ilgili %5 barajın öngörülmesindedir. Önceden kazanılmış haklara dayanarak ve Türk dilinin tarihi ve geleneksel bir dil olduğundan dolayı bu barajın kaldırılmasını istiyoruz. Bu konu hakkında Danışma kurulunda da soru ve uyarımızı vermiştik, fakat hiçbir uygun cevap alamadık. Yeni belediyelerin kurulması ve sınırları hakkında da ayrıca sorularımıza rağmen hiçbir cevap alamadık. Bundan dolayı toplulukların hayati çıkarları ve özel konularında, Müzakere ekibi tarafından duyarlılık sağlanılmalıdır ki tutumlar ve kabul edilen evraklar Kosova'nın tüm topluluklarla birlikte olduğunu yansıtmalıdır. Bir daha, tam bir birliğin yaratılması için tüm gruplara diğer toplulukların temsilcileri, hem evrakların hazırlanması hem de kabul edilmesinde katılımlarının sağlanması gereklidir. Özellikle Anayasanın hazırlanmasında uzman temsilcilerimizin katılmaları ve yer almaları muhakkak sağlanılmalıdır.

Saygıdeğer milletvekilleri, bu hafta içerisinde Toplulukların Danışma Kurulu çerçevesinde bu konular üzerinde üç günlük yuvarlak masa toplantısı düzenlenecektir. Herhalde bu toplantıda, ortak bir platform ve müzakerelere diğer toplulukların temsili yöntemi ortaya çıkacaktır, bu ortak karar istemlerimizin gerçekleştirilmesi ve herkesin işini kolaylaştırmak için neden olacaktır.

En sonunda bir daha Kosova temsilcilerinin ortak tutum ve birlikte çalışma kararlılığını selamlarken, ileride bizim isteklerimize de gereken önemin verileceğine ve isteklerimizin kabul edileceğine inanmaktayım. Aynı zamanda Kosova için hayati önemi taşıyan, Mecliste ki bu tartışmayı kutluyor ve bu gibi tartışmaların diğer forumlarda da gelenek haline dönmesini beklemekteyim.

İlginize teşekkürler!

KRYESUESI, SABRI HAMITI: Fjalën e ka deputeti Enver Hoxhaj

DEPUTETI, ENVER HOXHAI: Të nderuar zonja dhe zotërinjtë, i nderuar z. Kryesues, i nderuar zëvendës kryeministër, zëvendës ministër

Zakonisht nuk e praktikojë që të dal në foltore dhe të jap kontributin tim në seancat e tilla, po duket që sot motivi i daljes në foltore ka të bëjë me një situatë që ne pritojmë sot, në këtë seancë e cila ndoshta ka qenë e pa imagjinueshme.

Për ata të cilët janë edhe akademikë, po të njëjtën kohë, edhe janë edhe politikanë e kanë shumë një dilemë të madhe se e dinë që qëllimi i shkencës dhe i botës akademike është t'i ofrohet të vërtetës, qëllimi i politikës është ta modifikojë të vërtetën. Mirëpo edhe në modifikimin e vërtetës në përgënjeshtimin e vërtetës, në prezantimin e vërtetës ka kufi, dhe, unë e kam përshtypjen që debati i sotshëm i ka shkelur kufijtë edhe në këtë drejtim, pse i ka shkelur kufijtë, çështja e parë që Partia Demokratike e Kosovës e ka ngritë nga fillimi me formimin e ekipit negociator ka qenë çështja e rregullores së punës që ngriti edhe shefi i ynë i grupit parlamentar z. Krasniqi.

Pa një rregullore të punës ne nuk jemi në gjendje vërtetë një herë përgjithmonë ta rregullojmë relacionin në mes ekipit negociator grupit politik procesit për definimin e ardhmërisë së Kosovës, dhe Kuvendit të Kosovës sa i përket mënyrës se si do të duhej të

raportohej, dhe në atë drejtim, z. Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit nuk është këtu, po gjithë e dinë edhe ju kolegë të nderuar e dini që në takimin e fundit të grupit negociator ose të ekipit negociator është vendosur që kësaj seance t'i raportojë vetëm z. kryeministri Lutfi Haziri dhe në përputhje me një vendim të tillë z. Haziri për mendimin tim sot na e ka ndarë një raport jashtëzakonisht të mirë, jashtëzakonisht të detajshëm, edhe unë si pjesëmarrës në takimin në Vjenë e mbështesë dhe mendoj që e ka reflektuar në substancë dhe në precizitet atë se çfarë ka ndodhur në Vjenë. Nëse shtrohet pyetja se pse të tjerët nuk janë këtu, atëherë kërkesa ime është andaj ndaj z. Hamiti dhe zonjës Kelmendi edhe ndaj zonjës Sylja, e sidomos ndaj koalicionit qeverisës pse nuk janë atëherë edhe kryetari i Kosovës këtu, pse nuk është këtu edhe kryeministri i Kosovës, dhe se si në një formë të tillë ne në formë shumë selektive shumë të një anshme ia hedhim përgjegjësinë një njeri ose një grupi politik tu e falsifikua të vërtetën se si të tjerët nuk janë këtu sepse, kështu që ju lus që një debat i tillë mos të jetë a shans për fushatë zgjedhore, ndërsa mendimi im i sotshëm për këtë debat është që, kjo nuk është asgjë tjetër vetëm se një fushatë zgjedhore e cila fare nuk i shërben Kosovës dhe aq më pak qytetarëve në emër të cilëve disa deputetë deri më tash u shtruan. Do të thotë kështu në këtë pikë ju uroj për falsifikim të vërtetës, ju përgëzoj për përgënjeshtim të saj dhe shpresoj që nuk do të vazhdoni më tutje.

Çështja e dytë që dua ta shtrojë është sa i përket takimit të Vjenës. Zëvendës kryeministri Haziri dhe ministri i pushtetit lokal mendoj që ka reflektuar formën ma të mirë të mundshme atë se çfarë ka ndodhur në Vjenë. Këtu u dëgjuan debate dhe shqetësime për lidhje të mundshme horizontale për këtë ose atë temë. Kolegë të nderuar, në parim ju po e shkëlqoni një terren ku po përshkruani situata para qytetarëve të Kosovës të cilat nuk kanë ekzistuar në takimet e Vjenës, dhe me atë po e rrezikoni procesin dhe po përhapni frikë, për një frikë e cila s'ka ekzistuar në takimin e Vjenës.

Ata të cilët kanë qenë të pranishëm në Vjenë e dinë që ekipi negociator grupi politik ka përgatitur një platformë për reformimin e pushtetit lokal të cilën ne e kemi respektuar maksimalisht dhe të cilën në të ardhmen do ta respektojmë maksimalisht dhe nëse do të duhej të kishte debat unë e ftoj që në të ardhmen ta debatohet edhe për platformën e cila si e tillë është dorëzuar, por edhe për platformat të cilat neve na presin për çështje të caktuara anë të ardhmen. Ne nuk mund të kërkojmë debat post festum dhe nuk mundemi të përshkruajmë situata të cilat s'kanë ekzistuar duke e pasur një qëllim të fundit që t'i keq informojmë qytetarët e Kosovës.

Çështja e tretë, që dëshiroj ta ngris është që në këtë Kuvend është debatuar për decentralizimin edhe një herë të kaluar, dhe debati sotshëm mua ma kujton debatin që e kam pasur në atë kohë, në atë kohë grupi parlamentar i LDK, Grupi Parlamentar i AAK-së, edhe Grupi Parlamentar që përfaqësohet nga z. Jagcilar dhe zotëriu Gjezair Murati, vazhdimisht kanë shprehur shqetësimet e tyre të mundshme, vazhdimisht e kanë luajtur rolin e një pozite të dyfishtë për pilot komunat, për pilot projektet, vërejtjet e grupit tonë Parlamentarë kanë qenë shumë thelbësore të cilat do t'i ndihmon edhe procesit të sotshëm të Vjenës, që nën një të miratohet ligji për vetëqeverisje lokale, ne kemi pasur shans ta kemi ligjin për vetëqeverisje lokale, nuk e kemi ligjin, që të miratohet ligji për financat lokale dhe me atë ju jap përgjigje shumë deputetëve që e shtruan çështjen e financimit

dhe të donacioneve dhe të takimit të dytë të Vjenës, dhe që decentralizimi të ndodhë brenda për brenda kushtetutës së Kosovës dhe brenda për brenda sistemit politik të Kosovës. Të dy grupet parlamentar nuk kanë qenë të interesuar fare, sugjerimet tona shumë pragmatike t'i marrin parasysh, para dite kanë prezantuar shqetësimet e tyre individuale për këtë ose atë temë, në mbrëmje si e dimë kanë votuar për pilot komunat dhe ju lus që ta nxjerri një bilance, se çfarë ka ndodhur me pilot komunat dhe pilot projektet, dhe vërejtja ime e fundit me gjithë respektin ndaj profesorit dhe deputetit të nderuar Hamiti, unë jam shumë i sigurt që profesor Sabri Hamiti e ka lexuar romanin e Gjorgj Orvelit i botuar në vitin 1985 për **“dabëllthirting”**, dykuptimësi, këtu përshkruhen personazhe të cilat jetojnë në dy realitete dhe të cilat nuk kanë shans ta rikthejnë vetveten në një realitet të njëjtë. Me që profesor Hamiti supozoj që e ka lexuar, ju sugjeroj juve të koalicionit qeverisës ta lexoni këtë roman, mos të vazhoheni edhe më tutje dykuptimësinë e juaj, mos t'i shihni ata të cilët kanë shkuar në Vjenë më pak patriotë se sa ju që jeni këtu të ulur në sallë, mos t'i shihni ata që kanë shkuar në Vjenë si një pushtet të dyfishtë, se na edhe ju luftojmë për një interes të përbashkët dhe nuk ma merr mendja që është në interes të qytetarëve të Kosovës për shkak të grupeve të interesit që ekzistojnë në secilën parti, ekzistojnë edhe në partitë e juaja në emër të nacionales, në emër të kombëtares dhe në emër të ardhmërisë së qytetarëve të Kosovës të përgënjeshtrohet dhe të tejkalohet rendi i ditës si i tillë.

Kështu që, apelimi im i fundit është, ne jemi në një proces ku kemi përjetuar vetëm episodin e dytë, dhe ju lus që në emër të ardhmërisë të qytetarëve të Kosovës mos e falsifikoni realitetin nëse doni ta ndryshoni, nëse doni të vazhdoni edhe më tutje në realitetin e juaj të dytë unë ju dëshirojë asgjë tjetër vetëm sukses. Ju faleminderit.

KRYESUESI, SABRI HAMITI: Ju e dini pse po dal këtu për shkak se jam momentalisht tu kryesuar, dhe po dua me qenë i barabartë me ju.

Unë nuk kam si të përgjigjem këtu për shkak se edhe më herët z. Krasniqi më përmendi emrin, po u bëra i durueshëm dhe e kapërceva, nëse mund të përgjigjesha, edhe një tjetër deputetë edhe tjera, kësaj radhe nuk mund të përgjigjem se kishim përpara një diskutim të strukturum prej fjalisë së parë deri në të fundit, jo për të diskutuar problemin që e kemi por për vlerësuar diskutimet tjera. Mes tjerëve isha unë i nderuar i përmendur 7 herë më duket, faleminderit për kolegun e ri akademik dhe deputetin kolegun e ri.

Ai e përmendi edhe Orvellin mu bë i dijshtëm, unë e kam lexuar Orvellin edhe shumë të tjerë, i kam shkruar edhe vetë një grumbull librash, meqë është i dashamirë i literaturës unë i propozojë një literaturë shumë më të bukur se Orvelli. Në anën tjetër z. Hoxhaj po fletë me kategori të mëdha që është më së lehti të gabohet me të vërtetën, që e paska në xhep të maj të vetin. Edhe me falsifikimet. Z. Hoxhaj, as nuk është dhënë këtu ndonjë e vërtetë absolute as nuk ka pasur kurrfarë falsifikimi absolut, po flasë për veten por mund të flasë edhe për të gjitha diskutimet që i kam dëgjuar deri më tash.

Ti që dole dhe tu kritikuar tjerët u bëre vetëm si një militantë tepër i thjeshtë i PD, ajo është e drejta e jote, nuk është e drejta e jote nga ai kënd të jepesh vlerësime të tjerëve. Pra as nuk ka pas të bëjë me një të vërtetë absolute këtu as me një falsifikim.

Këto janë kategori të mëdha, nëse ti e mendon si lojë kush është në grup negociator atëherë t'i nuk je tu dëgjuar mirë, sepse unë nuk e diferencojë asnjërin, por është logjike që ai që ka qenë atje të raportojë, është logjike, kur shkon i dyti i treti le të raportojë ai. Për mua aq më bën a e ka emrin Hashim Thaçi, Agim Çeku, Fatmir Sejdiu se të gjithë nga një emër e kanë të vetin të përvetshëm, por është një grup, ju përmendët Kolë Berisha këtu nuk është, por ne në kryesi, unë shqip ju thashë është këtu, Kolë Berisha na është thënë në Kryesi që të raportojnë këta dy njerëz, dhe unë nuk njoh informata të tjera, pos kësaj që ka ndodhur këtu, prandaj nëse keni ide thoni ide, mos klasifikoni, se e vërtetë dhe falsifikim, z. Hoxhaj kolegu i ri je akademik, dhe deputeti i ri kolegu im, nuk flitet ashtu. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA: J faleminderit prof. Hamiti, Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit z. kryetar

Meqenëse gjithnjë përpiqen në punën time në Kuvend të jem sa më konstruktive dhe sa më kolegiale mendoj që meqenëse z. Hoxhaj më përmendi edhe mua emrin ndjen obligim që t'i përgjigjem.

Z. Hoxhaj unë ju ftojë edhe më tej të punojmë së bashku edhe që edhe më tej do të jem unë konstruktive shpresoj që do të jeni edhe ju. Ju faleminderit për këshilla. E kam borxh një sqarim se iniciativa e Grupit Parlamentar ka qenë jo që ne në mes veti, se disa që janë në grup e kanë informatën po është përgjegjësia ndaj qytetarëve të Kosovës, dhe meqenëse ekipi i unitetit është zgjedhur në këtë Kuvend e ka dhe është i ndërvarur nga ky Kuvend, e ka përgjegjësi që këtij t'i përgjigjet këtij Kuvendi, unë asnjë herë në fjalimin tim nuk e kam përmendur asnjërin, por ndoshta është mirë edhe një herë me e cek përbërjen e ekipit të unitetit duke filluar nga Kryetari i Kosovës, kryetari i Kuvendit, kryeministri, kryetari i PDK z. Thaçi dhe kryetari i partisë ORA Surroi që të gjithë janë anëtarët e ekipit dhe duhet t'i përgjigjen këtij Kuvendi.

Arsyeja tjetër është se meqenëse po na ngjajnë debatet nëpër media si u theksua nga shumica del vetë dokumenti sekret në media se para se ta marrim kuvendarët është me rëndësi që ne ta kemi dokumentin para se ajo të del në media. Është përgjegjësi e jona se para qytetarëve të Kosovës që t'ju shpjegojmë procesin por edhe që ta ndriçojmë këtë proces. Unë i falënderoj shumë zëvendës kryeministrit dhe ministrit të pushtetit lokal për raportimin, megjithatë konsideroj se edhe z. Thaçi është dashur të raportojë si udhëheqës i Grupit dhe si anëtarë i ekipit të unitetit dhe gjithë të tjerët që janë anëtarët të ekipit që ndoshta do të jenë udhëheqës për në bisedimet në Vjenë. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA: Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Unë dua të them se parafolësi ra në kundërshtim me vetveten, ani pse u përpoq të paraqitet si një folës orator me një përgatitje superiore akademike. Ky kundërshtim ka të bëjë sepse ai vetë tha se jemi marr vesh se zotëri Haziri të raportojë kurse sot fton që të na raportojnë këtu ose së paku të jenë të pranishëm presidenti i

Kosovës, dhe kryeministri i Kosovës, të cilët as nuk kanë qenë në Vjenë, dhe në Vjenë nuk shkon i tërë grupi përfaqësues, në Vjenë shkojnë ata njerëz që punojnë për çështje konkrete, kur të vijë çështja finale e pavarësimit të Kosovës atëherë me siguri do të shkojë presidenti i Kosovës, dhe ai do ta nënshkruajë atë pavarësi. Kur është fjala për faktin se kemi marr raport të përgjysmuar kjo është ma se e vërtetë dhe ky fakt nuk mund të mohohet, sepse z. Haziri raportoje për raundin e parë të bisedimeve në Vjenë dhe vetëm e preku çështjen e agjendës që ka qenë raundin e dytë të bisedimeve në Vjenë pa raportuar për bisedimet që janë zhvilluar në Vjenë. Andaj nuk kemi të bëjmë me falsifikime, por kemi të bëjmë me të vërtetat e pamohueshme, dhe nuk është gjuhë parlamentare këtu që deputetëve të u vishet edhe falsifikimi. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA: Për fjalë është lajmëruar deputeti Jakup Krasniqi Sigurisht për replikë, a po

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI: Po, z. kryetar, është mirë pasi ju jeni anëtarë i ri i Grupit të Unitetit, t'i tregoni parlamentit se, raportin që e dëgjuam a e ka pa Grupi Negociator i cili është përgjegjës, dhe në emër të tij vjen raporti, dhe Grupi Negociator ose Grupi i Unitetit, kë e ka autorizuar që të raportoje sot në këtë sallë, në mënyrë që vërtetë mos të thuan ato fjalë, që unë i mbështesë të deputetit Hoxhaj, ju faleminderit

KRYETARI, KOLË BERISHA: Kryesia e Kuvendit ka menduar se do të jetë për sot të raportoje Hashim Thaqi dhe Lutfi Haziri. Megjithatë, Hashim Thaqi është tërhequr nga raportimi këtu në Kuvend, kështu ka mbetur që të raportoje vetëm z. kryeministri Lutfi Haziri. Nuk e ka parë të arsyeshme që të raportojnë dy kandidatë, meqenëse ka qenë një delegacion, edhe herën e parë edhe të dytën, në dy takimet ka qenë një përbërje, dhe nuk e ka parë të arsyeshme që të raportoje ai por mund të raportoje z. Kryeministri. D.m.th. nuk ju ka mohuar e drejta askujt, ka qenë dëshirë e tij që të mos dal të raportoje dhe këtë punë ta kryejë zëvendës kryeministri, urdhëroni z. Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI: Unë pyeta,

Grupi i Unitetit i cili duhej të raportonte në këtë Kuvend se atë ne e kemi zgjedhur, a e ka pa raportin a e kemi miratuar raportin, apo ka vendosur Grupi i Unitetit se kush me raportuar sot para Kuvendit të Kosovës, pyetja ime nuk ka të bëjë me Kryesinë e Parlamentit por me Grupin e Unitetit, urdhëroni.

KRYETARI KOLË BERISHA: Zotëri Haziri urdhëroni

ZËVENDËSKRYEMINISTRI, LUTFI HAZIRI : I nderuar kryetarë, të nderuar deputet

Nuk më është drejtuar pyetja drejtpërdrejt mua, por meqë jam folësi kryesorë nga ana e delegacionit të Kosovës, jam i obliguar ti jap sqarimet e shkurtra, pa dashur me marrë kohën e juaj.

Po del e vërtetë ajo që tha prof. Sabri Hamiti që në fillim se duhet disiplinim ndërinstytucional. Shumica e fjalëve të deputetëve, të gjitha vërejtjet kanë të bëjnë për shkak të koordinimit ndërinstytucional. Mungesa e një koordinimit institucional po nxjerr që edhe po del debati i tillë, shumica e fjalëve është kulturë politike, mençuri e cila dëshiron me u bartë dhe për të cilën jam i detyruar me i dëgjuar dhe i marr në atë aspekt sa më duhet, dhe sa është pozitive, duke e kualifikuar dikën me ngazëllim fëmijëror, dikën me djaloshar, dikën me fitimtarë dikën me humbës.

Nuk kemi të bëjmë me këto, kemi të bëjmë me status të Kosovës, dhe duhet ta pranojmë që delegacioni i Kosovës për status i ka dëgjuar raportet veç e veç. Delegacioni i Kosovës për status i është raportuar veç e veç. Delegacioni i Kosovës për status ka vendosur që në këtë rast unë të raportojë për takimin apo për procesin e Vjenës, i cili ka të bëjë me këtë çështje, dhe unë për takimin tim që kam udhëhequr në emër dhe në mandat të institucioneve të Kosovës i kam raportuar edhe komisionit për marrëdhëniet me jashtë, edhe këshillit konsultativ të komuniteteve që z. Baliq i quajti muhabete, nuk ka qenë muhabete edhe janë njoftuar para shkuarjes edhe pas kthyerjes. Nuk kam qenë i obliguar me i njoftuar, por kam ndër obligim institucional që të shtunën me shkuar me fol me përfaqësuesit e grupeve etnike të komuniteteve që kanë qasje në status, dhe këtë e kam bërë edhe në formën e raportimit. Dhe këtë kontekst mendoj që është e tepërt të bisedohet për metoda dhe për forma tjera të mënyrës së punës. Nuk ka mëshfje të bisedave të Vjenës, nuk ka mëshfje të asnjë agjende, nuk është e lehtë, takimet kanë temat specifike që dëshirojnë zgjidhje, dhe cilat janë ato tema. Të gjitha ato tema që nuk është arritur me ju dhënë përgjigjeje pozitive për të siguruar Bashkësinë Ndërkombëtare që qytetarët pakicë në Kosovë janë të sigurt në Kosovën e pavarur. Në këtë kontekst nuk është turp me pranuar që nuk kam arritur me kontrolluar një pjesë të territorit të Kosovës si institucione, jo tash por qe 7 vjet, dhe ky problem i mos kontrollit të territorit në tri komuna Leposaviç, Zubin Potok, dhe Zveçan kontrollohet vetëm në aspekt buxhetor, pjesërisht, në aspektin administrativ dhe jo në aspektin territorial të instalimit të institucioneve shtetërore dhe po ashtu pjesë e mos kontrollit të territorit është edhe qyteti i Mitrovicës, i cili kërkon adresim të zgjedhjes së problemit dhe injorim, ikje nga problemi dhe vazhdimisht tendencë që me trajtua si është trajtuar deri më tash, dhe nuk mund trajtohet si deri tash, për këtë çështje duhet me gjetur zgjedhje në mënyrë që Kosova me ruajtur karakterin unitar dhe me pas kontrollin e tërë në territorin e vet.

Sikur që nuk është arritur me deblokua funksionimin e institucioneve paralele në Kosovë, nuk është arritur me i kënaqur interesat e grupeve etnike, në veçanti atij serb. Ne mund të flasim tash që kemi bërë krejt të mira, por nuk është funksionalizu. Oferta jonë sistemi jonë ligjor nuk është funksionalizu në disa segmente që kërkojnë zgjidhje, dhe këto zgjidhje po kërkohen tash, nuk po kërkohen zgjidhje në problemet që janë zgjedh janë adresuar para disa viteve, apo këtë vit, dhe cilat janë funksional. Andaj, ky organ është organi më i lartë i shtetit i cili e kërkon fjalën e secilit, duhet me adresua kërkesën, me kërkuar informatën raportimin dhe dokumentet nuk janë sekrete për parlament, por janë sekretë me palën të cilën ne negociojmë.

Nuk mund të flasim për negociata, dhe transparencë, këtu drejtë për drejtë kur ke të bësh me teknika, me strategji të bisedave për çështje të caktme. Dhe ne nuk jemi tu negociuar me Serbinë, por jemi tu negociuar me Bashkësinë Ndërkombëtare. Kjo është e çartë, negocimi ka kuptimin e statusit të minoriteteve në Kosovën e pa varur dhe sovraane, dhe këtë kontekst unë nuk frikohem, dhe nuk dua me zgjatur më shumë dhe me ofruar zgjidhje dhe opsione të cilat pa i vendosur Parlamenti i Kosovës. As ekipi i pesëshes i Unitetit as individët, as institucionet e veçanta por unë dua me besua që opsionet që ofrohen në të gjitha bisedat që do të zhvillohen në Vjenë, për të gjitha temat që do të zhvillohen në Vjenë, do të jenë obligim që në fund me u miratua apo me u refuzua nga Parlamenti, nga kjo shtëpi e madhe e përfaqësimit të qytetarëve të Kosovës, dhe këtë kontekst unë nuk dyshojë, dhe për këto motive unë jam këtu.

Reforma e pushtetit lokal nuk mund të thuhet që është vetëm problem vetëm i imi për deri sa unë i përmenda edhe arsyet. Trashëgimia kulturore nuk mund të thuhet me çdo kusht vetëm nga ne, se nuk është garantuar dhe pasojat e sajë i kemi pagua.

Trashëgimia kulturore në Kosovë nuk është arritur me u garantua, dhe pasojat e saja i kemi paguar, dhe për këtë deputetët duhet ta marrin seriozisht, se ne po harxhojmë miliona në riparimin e dëmeve që janë shkaktuar nga kujdesi i jonë që kemi pasur sikur që dëmet e luftës që ka Serbia, temat tjera që janë përcaktuar janë interes i joni me i shtjerë me palën tjetër, dhe kjo është pjesë që do të shtjerët, këtë fazë jemi në bisedë e sipër, do të hyjnë trashëgimia kulturore, do të vijnë çështjet ekonomike, suksesioni, dëmet e luftës dhe problemet tjera që i parasheh agjenda z. Ahtisari për ta ndarë Kosovën, formalisht dhe Kosova për të ecur drejtë rrugës së vetë. Unë nuk dua me i dallua në veçanti problemet tjera por dua me besua që roli i Parlamentit ka me u respektua deri në fund, dhe roli i Parlamentit ka me qenë vula përfundimtare e këtyre bisedave që kanë filluar dhe dhashtë zoti me përfundua sa më shpejtë që është e mundur. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA: Ju faleminderit z. ministër, fjalën e ka Xhevdet Neziraj

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ: I nderuari z. kryetarë, të nderuar deputet, nderuar zoti kryeministër dhe ministra

Ne lidhje me decentralizimin jemi të njoftuar edhe ne si grupe të komuniteteve nga ana e zëvendëskryeministrit z. Haziri në këshillin konsultativ të komuniteteve, ajo është një e vërtetë e madhe që edhe këtu u tha.

Mirëpo në lidhje me decentralizimin dhe në bisedat të cilat janë ba në Vjenë, kryekëput kanë dominuar temat në lidhje me siguri për minoritete e në veçanti për komunitetin Serb, atë nuk duhet të anashkalojmë dhe duam ta cekim këtu. E tërë problematika, edhe se nuk kam qenë në Vjenë, në suazat e mediave informimit medijatik e zhvilluar më tepër në aspektin e plotësimit të kërkesave të minoritetit serb, atë na thotë edhe në një bisedë një diplomatë i huaj i cili na thotë se ju kemi harruar juve tjerëve duke u marr me çështjen e serbëve.

Unë do të thosha këtu që qeveritarët tanë, parlamenti dhe institucionet e Kosovës duan t'i kushtojnë rëndësi më të madhe edhe komuniteteve tjera në Kosovë, por edhe komunitetin Egjiptase këtu e përfaqësojë. Unë do të them si mund ta komentojmë bie fjala financimin e dyfishit të komunave, ku banojnë serbët ose një ekstra privilegj për serbë, ndërsa për komunitetet tjera këtu mos të parashikohet ose mos të diskutohet. Unë do të ndalem vetëm në shërbimin policor të Kosovës, ku ndoshta pala serbe nëse ka 5, 6 mijë pjesëtarë të komuniteteve lypin edhe komandant të policisë të jetë serb, në Gjakovë ekzistojnë mbi 700 pjesëtarë të komunitetit Egjiptas dhe nuk është asnjë pjesëtarë i shërbimit policorë të Kosovës, dhe ky shërbim policor i Kosovës deri më tani ka qenë nën menaxhimin e ndërkombëtarëve, atëherë si të plotësohet ky standardë që shumë përfolët ose në dingasteret tjera si në doganë në trupat mbrojtëse të Kosovës dhe në shumë lami tjera. Unë shpresoj që institucionet e Kosovës duan t'i kushtojnë rëndësi edhe komuniteteve tjera të cilat janë lënë shumë mbas dore, jo nga këto institucione, por është trashëguar një prapambeturi dhe një diskriminim i pushteteve të mëhershme, prandaj na vyen një shtyrje pozitive e unë këtë e besoj që këto institucione janë duke bërë dhe janë në rrugë duke e bërë.

Sa i përket decentralizimit, sa i përket statutit të Kosovës, duhet të kemi hise të gjithë edhe pozita edhe opozita, prandaj, edhe ne shkuarjen e delegacionit në Vjenë ne e kemi përkrahur që në fillim dhe është shumë kënaqësi që merr pjesë edhe pozita edhe opozite e prandaj nëse dështohet të të ketë hise edhe pozita edhe opozita, nëse dalim të suksesshëm do të merr pjesë edhe pozita edhe opozita, ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA: Fjalën e ka deputetja Qibrije Hoxha, le të përgatitet deputeti Fadil Geci

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA: Ju faleminderit i nderuar kryetar, të nderuar deputetë, kolegë deputetë.

Në lidhje me këtë temë të decentralizimit unë kam dashur të diskutojë qysh në seancën e kaluar kur është bërë fjalë për decentralizimin, por për shkak të paraqitjeve të shumta të deputetëve, unë kam deponuar shkrimin, fjalën time dhe ajo duhet të jetë në transkript.

Megjithatë, qëllimi im është që në lidhje me decentralizimin të bëjë një sqarim ose një zbrërthim esencial, se çka do të thotë decentralizimi, ashtu si e kam kuptuar unë se si funksionon kjo në botën demokratike, edhe atë me qëllimin më të mirë që qytetarët e Kosovës ta kuptojnë drejtë procesin e decentralizimit.

1. Decentralizimi nuk është proces politik. Decentralizimi është proces demokratik, i cili zhvillohet në botën demokratike, dhe nuk merr fund asnjëherë, d.m.th. kjo është edhe arsyeja pse unë konsideroj se decentralizimi nuk mund të jetë i negocushëm, nuk mund të bisedohet për te, për decentralizimin, për një proces demokratik që zgjatë domethënë sa të jetë jeta, e të bisedojmë për një proces të tillë të marrim vendime dhe të themi se u krye kjo punë. Unë këtyre bisedimeve d.m.th. decentralizimin e kuptoj vetëm në bisedimet në Vjenë, e kuptoj për fat të keq vetëm si një ombrellë e cila në të vërtetë donë të thotë bisedime për krijimin e komunave të reja, d.m.th. komunat e reja nuk kanë

lidhje me procesin demokratik të decentralizimit. Decentralizimi donë të thotë të jepet pushtet më tepër komunave të cilat do ta bëjnë një jetë më të mirë, qytetarët të cilët do ti shfrytëzojnë të drejtat e veta edhe ta bëjnë një jetë më të mirë. Mirëpo kjo duhet të vjen nga baza nga komuna, qytetarët janë ata të cilët e kërkojnë procesin e decentralizimit, pra kjo nuk ka të bëjë absolutisht me krijimin e komunave të reja,. Komunitet e reja mund të krijohen kur e kemi një pushtet qendror një pushtet një zhvillim të mirë ekonomik i cili mandej mundëson krijimin e komunave të reja. Komunitet e reja nuk mundën, nuk mundemi ne tash të mendojmë për komunitet e reja kur jemi në një krizë ekonomike të kuptueshme për shkak kushteve të cilat jemi. Dhe desha të them edhe këtë se neve në të vërtetë si institucion si parlament si deputetë neve e bëjmë procesin e decentralizimit e bëjmë duke bërë aprovimin e ligjeve, e pikë së pari përpilimi i ligjeve te ne bëhet me qëllim që komunave tu epen kompetenca, sepse ligjet përpilohen me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare të komisioneve të unionit evropian të cilat parashohin që komunitet të kenë kompetenca. Ju lutem procesi i decentralizimit, neve e bëjmë në nivel institucional nuk them se neve po bëjmë ligje perfektë, mirëpo neve procesin e decentralizimit e kemi filluar si një proces demokratik të cilën po e zhvillojmë nëpër mes të institucioneve tona, prandaj, unë konsideroj se bisedimet në Vjenë, në emër të decentralizimit janë të pa papranueshme. Ma mirë desha me thënë, nuk di çka kanë menduar por ndoshta kanë menduar me bë decentralizimin, nga kjo rrjedhë në qoftë se bisedohet me palën serbe me investua nëpër mes të institucioneve ndash horizontalisht ndash vertikalisht d.m.th. me pas ndikimin e institucioneve tona. Ju lutem donacionet janë çështje humanitare edhe natyrisht janë të pranueshme nga cili shtet që vjenë, dhe donacionet dihet se si shkojnë, donacionet shkojnë nëpër mes organizatave joqeveritare, organizatave tjera të cilat janë të regjistruara pranë Qeverisë tonë, edhe të cilat kontrollohen natyrisht ose kontrollohen në kuptim të respektimit të statuteve të veta, edhe në këtë mënyrë bëhet shpërndarja e donacioneve, neve nuk mundemi të nxjerrim formula të reja, për decentralizim edhe formula të reja për donacione. Ndërsa sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut absolutisht ne si qytetarë të Kosovës e dimë se kemi pësua se çka do të thotë mos me i gëzuar të drejtat tona, dhe mendoj se kjo nuk ka qytetarë të Kosovës i cili mendon se do ta kemi një Kosovë demokratike për të cilën jemi munduar shumë e shumë vite shumë gjenerata e do t'ia shkelim dikujt të drejtat.

Mirëpo, kjo i takon një procesi tjetër, edhe respektimi i të drejtave të njeriut në botën demokratike është një proces i cili vazhdon me vite, nuk mund të themi se ne po hymë në bisedime dhe po e kryejmë këtë punë, por do të zotohemi që të punojmë gjithmonë në zhvillimin e këtyre proceseve, kjo ishte ajo që desha të them, ndërsa i përkrahi këto bisedime në Vjenë, absolutisht dhe konsiderojë se ka për çka të bisedohet në Vjenë, mendimi im është se duhet të bisedohet për çështjen e të zhdukurve, duhet të bisedohet për dëmet e luftës, në mënyrë që ta krijojmë një fqinjësi të mirë jo vetëm me Serbinë por si me të gjitha vendet tjera të rajonit, fqinjët tanë që më në fund të kemi të tentojmë të zhvillojmë një sistem demokratik. Edhe një fqinjësi të mirë me të gjithë. Ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA: Fjalën e ka deputeti Fadil Geci, le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori

DEPUTETI FADIL GEÇI: I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, do të mundohem që të mos i përsërisë disa që u thanë këtu.

Meqenëse sot po debatojmë për një çështje mjaft të rëndësishme për të sotmen dhe për të ardhmen e Kosovës, fillimi i bisedimeve për caktimin e statusit përfundimtarë të Kosovës, është një prej ngjarjeve më të rëndësishme të këtij viti.

Institucionet e Kosovës tashmë janë përcaktuar për fillimin e këtyre bisedimeve, dhe ne jemi të bindur që këto bisedime në fund do të përmbillen në bazë të vullnetit plebishitar të popullit të Kosovës e që është shteti i pa varur i Kosovës. Por këto bisedime duhet të zhvillohen në nivel të institucioneve të Kosovës dhe miratimin e Kuvendit të Kosovës, unë e përshëndes grupin e Unitetit grupin Negociatorë të Kosovës dhe paraqitje të përbashkëta të delegacionit të Kosovës në dy rundet e bisedimeve në Vjenë, por jo edhe unitetin në dëm të Kosovës.

Unë e shprehë brengosjen time, për disa paraqitje individuale të disa prej anëtarëve të grupit negociator, apo të delegacionit për bisedime qoftë për mes vizitave individuale, apo takimeve individuale, me personalitetet e Beogradit, pa pëlqimin e grupit. Më vjen keq që dua ta them atë që personi për te nuk është këtu meqenëse është tema, me siguri do të kontaktojmë me te edhe para këtij Kuvendit.

Të nderuar deputetë, ne kemi pasur rastin e njërit prej anëtarëve të grupit, e kryesisht e Hashim Thaqit që është takuar me presidentin Serb Tadiq në Greqi. Unë kërkojë nga Grupi Negociator, nga kryetari që të na sqarojë në çfarë cilësie ka takuar Hashim Thaqi, Tadiqin në Greqi.

Nëse ka përfaqësuar partinë e tij në takimin e partive socialiste të rajonit, atëherë është çështja e orientimeve të tij që drejton, por nëse këtë takim ka marrë pjesë në cilësinë e anëtarit të Grupit Negociator, atëherë ai duhet të jep përgjegjësi para institucioneve të Kosovës.

Shqetësimi im i dytë, tu pasur parasysh të gjitha lëvizjet që i kemi bërë edhe gjatë luftës edhe pas luftës por deklaratat e anëtarëve që i kemi sot në Grupin Negociator, a është për paraqitjen e këtij anëtarit e kryesisht Hashim Thaqit në Grupin Negociator i bazuar edhe nga disa paraqitje dhe propozimet e tija të mëhershme që kanë qenë në kundërshtim me synimet e popullit të Kosovës. Le t'ia kujtojnë propozimin për moratoriumin i cili u paraqiste ngrirje dhe ndërprerje të çdo përpjekje për caktimin e statusit final të Kosovës. Çka do të thotë kjo për Kosovën, këtë kërkesë po e dëgjojmë në vazhdimësi nga vetë Serbia nga vetë kryetari Tadiq, ku lidhet kjo, ku na qon kjo, është në interes tonin edhe në interes në përgjithësi na jepet sqarime detale. Por unë për këtë e fajësojë edhe mendojë që e ka një pjesë të përgjegjësisë edhe kryetari i Kosovës, se nëse janë lëvizjet dhe vërehen që janë në dëm të Kosovës duhet të ketë parasysh kush janë ata individë që jep mandat, që të kryesojnë delegacionet edhe mos të dalin këtu dhe të mos na sqarojnë për bisedimet që janë folur.

Kjo gjë duhet të vlen edhe për anëtarët e Grupit Negociator. Vizitat individuale të anëtarëve të Grupit Negociator, gjatë këtij procesi të bisedimeve duhet të bëhen gjithmonë në marrëveshje paraprake me të gjithë anëtarët e tjerë të Grupit.

Ata tash nuk janë vetëm lider të partive të tyre politike, por janë pjesë e Grupit të Unitetit, prandaj, posedohet të kenë kujdes në paraqitjet e tyre në propozimet e tyre dhe në takimet e tyre për personalitete të ndryshme, ata në radhë të parë duhet të ndërprejnë çdo lloj takimi tjetër me ndonjë lider apo përfaqësues të Beogradit pa pëlqimin e Kuvendit.

Aq më pak se anëtarët e Grupit Negociatorë edhe tjerët nuk duhet të keqpërdorin vizitat e tyre private apo lidhjet e tyre private me përfaqësuesit e Beogradit, në këto momente kur po bisedohet për Kosovën, ose këta individë si të dyshimtë do të përjashtohen nga grupi për këtë ka mandat, le të vendosë Kuvendi, t'ua kujtojmë se ky Kuvend është që i ka votuar individët, prandaj edhe ky Kuvend është edhe që i ç'voton, nëse vazhdojnë në këso vizitash e me këso takimesh të dyshimta që janë në dëm të Kosovës. Qëllimi i jonë i gjithëve ka qenë mos me i lënë barra në pesë individë, por me u shkarkuar në Kuvendin e Kosovës.

Unë mendoj se edhe Lutfi Haziri nuk ka përgjegjësi para Kuvendit, kjo është logjike, Lutfi Hazirin ne nuk e kemi votuar, Lutfi Haziri mundet me i dhënë Grupit Negociator, Grupit të Unitetit, e sqarojë shumë mirë e shpjegojë shumë mirë, shumë arsyeshëm por kjo duhet të jetë një mësim për grupin e Unitetit, të dimë çka po dom, për të gjithë është fjala.

Në të ardhmen unë mendoj se duhet të mblidhemi ma shpesh në seancat e tilla, dhe të kërkojmë raportet të rregulla nga anëtarët e delegacionit të Kosovës që mos të marrin pjesë në bisedime në Vjenë. Pjesëmarrja në takimet e Vjenës nuk duhet të shërbejnë si **promovime** politike individuale apo partiake. Anëtarët e delegacionit para se të japin konferenca për shtyp u tha edhe disa herë, apo **deklarata**, intervista nëpër medime duhet që t'i raportojmë këtij Kuvendi, deputetëve, ata duhet ta dinë se ky Kuvend i ka zgjedhur dhe vetëm në këtë Kuvend do të legjitimohet rezultati i bisedimeve në Vjenë, në të kundërtën ata mund të udhëtojnë kot çdo javë ose çdo muaj në Vjenë, por prej andaj duhet të sjellin rezultatin dhe vullnetin e popullit, e ajo është Pavarësia e Kosovës.

Legjitimimi i vullnetit të popullit do të bëhet vetëm në këtë Kuvend të Kosovës, ndërkaq nënshkrimi formal i pavarësisë së Kosovës, mund të bëhet edhe në Vjenë, apo ndonjë qendër tjetër ndërkombëtare të vendosjes, ju faleminderit.

KRYETARI, KOLË BERISHA: Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, le të përgatitet Hydajet Hyseni.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI: I nderuari z. kryetar i Kuvendit, z. zëvendëskryeministër, ministri Rexhepi, të nderuar kolegë deputetë.

Unë do të mundohem që t'i përmbahem pikës së rendit të ditës për të cilin jemi takuar sot edhe kjo ka të bëjë me raportimin e Grupit Negociator për zhvillimet e bisedimeve në Vjenë.

Rolin e Kuvendit në këtë drejtim unë e konsideroj tepër të rëndësishëm dhe mbështes edhe seancën e sotme dhe nismën e mbarë, do të thotë ,raportimin në Kuvendin e Kosovës ,si institucion më i lartë i vendit.

Do ta ndaja në dy aktivitete punën e Kuvendit në këtë fazë dhe në fazat e ardhshme të zhvillimit të bisedimeve për arritjen e qëllimit përfundimtar të pavarësisë së vendit tonë.

Unë do ta veja në rend të parë rolin e Kuvendit të Kosovës si Kuvend që u ndihmon Grupit Negociator me grupet e veta, të gjitha atyre që e përbëjnë institucionin e Kuvendit, me qëllim të lehtësimit të punës së Grupit Negociuar të dialogut, që mund ta zhvillojnë edhe në të ardhmen. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se Delegacioni i Kosovës duhet të ndërrojë sipas pikave që mund të paraqiten si pika të dialogut dhe të bisedimeve, andaj në këtë drejtim mendoj se Kuvendi i Kosovës ka një potencial të mjaftueshëm të ndihmojë në këtë drejtim për radhitjen e qëndrimeve të caktuara që mund të dialogohen ,të bisedohen në takimet të ardhshme. Pastaj grupi që do të dialogojë do të kthehet në Kuvendin e Kosovës për të raportuar pikë për pikë për atë që është arritur atje, për atë që ka mbetur që të arrihet në të ardhmen .Pra Kuvendi i Kosovës është institucioni që mund t'i marrë vendimet përfundimtare.

Diskutimi i sotëm pak a shumë mua më duket se ka rrëshqitur në diskutimin për decentralizimin në Kosovë, temë të cilën e kemi diskutuar edhe më herët. Mendoj se do ta rëndojë bisedën e sotme në Kuvend . Është absolutisht e arsyeshme dhe e qëndrueshme që Kuvendi i Kosovës të mblidhet sa herë që është e nevojshme, sepse jemi në njërin nga proceset më të rëndësishme, pa dyshim.

Prandaj para çdo takimi që mund të mbahet, qoftë i prillit tash që po hyjmë qoftë edhe tjetër,unë mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet të aktivizohet me ndihmën e vet për t'u dhënë Ekipit Negociator ose trupave të tjerë me qëllim të lehtësimit të punës të tyre të marrjes së ndihmës që pastaj këtu në Kuvend të Kosovës mos të vijmë në kundërthënie sikur sot . Në njëfarë forme mund të shihet kjo se ne nuk kemi materiale të përgatitura, nuk kemi raportin e Ekipit që ka diskutuar. Faktikisht forma e përgjysmuar e paraqitjes, na e rëndon edhe diskutimin tonë të sotëm në Kuvend.

Kjo formë, kjo procedurë nuk është e vështirë që vërtet të respektohet dhe faktikisht do të bënim një rrugëtim të përbashkët ngase dihet se qëllimi i të gjithëve , pa dyshim se është i njëjtë - pavarësia e Kosovës. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit, para se t'ia jap fjalën deputetit Hyseni t' ju tregoj se i kemi edhe 7 kandidatë. A jeni që të bëjmë pauzë apo të vazhdojmë? Të vazhdojmë. Urdhëroni urdhëroni z. Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI: Faleminderit, i nderuari kryetar. Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë.

Unë e kam vështirë ta kuptoj këtë formulën që u dëgjua 2 – 3 herë për disiplinimin institucional, sidomos kur vjen prej përfaqësuesve të ekzekutivit. Tamam puna nëse ekzekutivi do të na disiplinojë.

Më përpara do të preferoja një formulë tjetër, funksionimin demokratik, funksionimin e rregullt, transparent, siç vepron gjithë bota.

Dhe që në fillim do të dëshiroja ta tërheq vërejtjen se sot në rend dite ne kemi një pikë-Raportin e Ekipit Negociator. Prandaj, çdo çështje që shtrohet jashtë kësaj, mendoj që do të duhej të mos lejohej . Për më tepër sot ne nuk na u prezantua ndonjë raport. Ajo që dëgjua ishte një fjalë, një fjalë me shumë fjalë, kallaballëk fjalë, sidomos kjo pjesa e fundit. E respektoj shumë vendasin tim, por tek unë ka shkaktuar shumë pikëpyetje të tjera. Prandaj, unë e mbështes që në krye të fjalës sime insistimin që u dëgjua dhe besoj se jemi marr vesh që sot ne ta konsiderojmë këtë debat të hapur, por jo të përfunduar.

Mendoj që Kuvendit i duhet paraqitur një raport i shkruar, një raport në të cilin së pari do të sqarohet ajo që ishte e përshtjellur, për mua, në fjalën e fundit të zëvendësministrit dhe të ministrit të Pushtetit Lokal se çka po ndodhë me këtë proces? Në opinion gjithë votuesit tanë, kolegë të nderuar, na e bëjnë pyetjen- Çka po ndodhë atje? Një proces është, por emrin e ka gjithqysh. Unë së pari mendoj se kjo duhet të sqaruar. A është fjala për negociata, për bisedime, për dialog, a për çka është fjala?. A po bisedohet në baza bilaterale? A po bisedohet në relacionin Prishtinë – Beograd dhe nëse është kjo shtrohet pyetja - Çka lypin kolegët tanë në anën e Beogradit? A po bisedohet në baza ndëretnike ,shqiptarët në një anë, serbët në anën tjetër. Merrni me mend paradoksin .Nëse është kështu, pse nuk janë aty shqiptarët e Preshevës?

Bisedime për çka po bëhen? Herë thuhet për statusin e Kosovës, herë për të ardhmen e Kosovës, herë për decentralizimin, herë për ndërtimin e pushtetit lokal, herë për reformimin e pushtetit lokal, herë për çështjet e kulturës e gjithçka tjetër.Pra, qytetari ynë është në konfuzion. Raporti që duhet t'i paraqitet duhet të japë përgjigje në këto çështje, siç duhet të jap përgjigje dhe në pyetje të tjera. Cilat janë standardet për çështjet që po bisedohet? A janë standardizuar në rajon të gjitha këto çështje?

Cilat kanë qenë qëndrimet dhe rekomandimet e Kuvendit,sa po respektohen ato dhe sa po merren parasysh?

Ne tani po bisedojmë dhe po themi se është vonë të flasim për ato që kanë ndodhur. Ne pajtohemi, por kjo është një seri që po shkruhet vazhdimisht. A mund të kërkojmë që të

kemi përpara platformën e ardhshme për episodet që vinë të kësaj serie, për ne ende të mjegulluar. Kuvendi ka të drejtë të kërkojë që t'i ketë ato të gjitha në tavolinë. Nuk besoj që këtë vakum ne mund ta tejkalojmë me mburrje të tipit- ministrat tanë më të mirët në Evropë, boksierët tanë më të mirët në Evropë - thoshim dikur etj.

As me formula të tilla se këtu paska kërkuar një avans dhe ne dhamë avans dhe u shpërblyem me shumë lëvdata, komplimente e tjera. Negociatat janë pazar dhe nëse në avans jepet gjithçka që kemi në qese pa marrë asgjë në qese prapa, shtrohet pyetja çka po ndodhë me atë proces. Meqë këtu nuk kishim raport, kishim fjalë, më lejoni që t'ju përkujtoj një interpretim shumë tipik, mbase për kushtet tona kosovare.

Atë shembullin që unë e kam dëgjuar këto ditë të përdorur pikërisht në këtë kontest për tregtarin e ri e papërvojë që dëshironte të dëshmojë se është tregtar i mirë, duke blerë mallin shtrenjtë e duke e shitur lirë. Kur po i thoshin s'i ia ke qitë rrethinë kështu, cili është pazarllëku në fund, përgjigja e tij ishte:” Mos shikoni pazarllëkun, por shikoni kallaballëkun.” Zotëri nuk kemi nevojë ne për kallaballëk fjalësh as për kallaballëk komplimentesh. Sa më shumë të jepnim aq më shumë do të kishim komplimente. Mirëpo ne s'jemi atje për të marrë komplimente, ky është proces vendimtar për të ardhmen e një vendi të një populli, prandaj kërkohet përgjegjësi.

Mua më vjen mirë që edhe këtu u përmend disa herë, por nuk jam i sigurt se u respektua ajo që duhej të ishte moto për të gjithë ne se në çështje të tilla madhore s' duhet të lejojmë ndarje pozitive-opozitive. Por a mund të bëhet kjo në qasjen që e kishim sot, një përpjekje një farë mënyre për ta zhvendosur edhe temën e bisedës jo te sfida kryesore, por te individët, te udhëheqësit. Krijohet përshtypja sikurse dikush po druan mos ka ardhur puna te nënshkrimi dhe tash kush do të jetë ai që do të dalë i pari ta nënshkruan, jemi larg zotëri prej saj. Dhe nëse flasim për këtë le të shikojmë gjithë procesin. Ne kemi biseduar në këtë sallë, e dimë si ka filluar ky procesi .Një i ri që po shërbente në një odë me çaj po i thoshin :”Drejtoje pak tabllën se po derdhen çajat e na përvëlove”. Përgjigja e tij ishte: “Kështu ma kanë dhënë edhe ma shtrembët ma kanë dhënë, shumë drejtë është siç e kam marrë në fillim.” Unë uroj që të drejtohem siç duhet dhe të jemi atje ku duhet në procesin e ardhshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit z. Hyseni edhe për këto anekdota që na dhatë. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari, le të përgatitet Besa Gaxheri.

DEPUTETI NAZIM JASHARI: I nderuari kryetar i Kuvendit, z. kryeministër, të nderuar kolegë deputetë, ju që keni mbet në sallë.

Debati i sotëm është një debat që ka disa të mira. E mira e parë është që ky Kuvend ka filluar të sillet si Kuvendë. Kjo është puna e parë. Kemi filluar gradualisht t'i ngjajmë kuvendeve të botës dhe t'i trajtojmë temat në mënyrën qysh ne të gjithë e kemi kapacitetin dhe qysh i shohim këto procese nëpër të cilat po kalojmë.

Pra në këtë aspekt mendoj se çdo fjalë këtu është e mirëseardhur ,qoftë për ne deputetët, qoftë për qytetarët se mund ta vlerësojnë secilin prej nesh për shkallën e seriozitetit me të cilën e trajtojnë një problematikë dhe për nivelin e tij të përgatitjes.

Jemi mbledhur këtu sot në këtë seancë për të trajtuar një temë shumë të rëndësishme,pra çështjen e rrjedhës së negociatave, këtu u tha me bashkësinë ndërkombëtar. Unë mendoj se negociatat po zhvillohen në dy rrafshë: me bashkësinë ndërkombëtare dhe me Beogradin. Pa polemizuar me zëvendëskryeministrin ,sepse edhe ashtu po zhvillohen në të njëjtën sallë dhe po trajtohen temat që janë esenciale për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Sigurish që këto negociata e kanë një parahistori që po zgjatë që nga 99-ta, që 7 vjet po ato shkojnë edhe më tutje. Pozitat fillestare të negociimit janë vendosur me të bërat ose të pabërat tona në këtë shtatëvjeçar. Jeni të sigurt, zonja dhe zotërinj ,se ata që kanë pasur mendim politikë e që nuk kanë qenë aktivisht në politikë,po të ishin më të vëmendshëm dhe më të kujdesshëm, po t'i kishim trajtuar problemet reale të Kosovës në mënyrën e duhur, do të kishim pasur pozicion negociator shumë më të favorshëm se që kemi sot.Pra kjo nuk ka ndodhë dhe kemi ardhur në këtë situatë në të cilën edhe po ndodhemi.

Më duhet ta tërheq një vërejtje themelore, në bazë të rrjedhës së bisedimeve, rrjedhës së debatit.Është fatkeqësi për Kuvendin, pavarësisht që unë e përshëndes përpjekjen për ta ngritur nivelin e përgjegjësisë dhe nivelin e Kuvendit, nivelin e trajtimit të çështjeve,që sot po ndahemi në blloqe pozitivë- opozitivë.

Unë mendoj se as z. Lutfi Haziri që e ka kryesuar Delegacionin e Kosovës në bisedimet e para dhe as z. Hashim Thaçi nuk kanë qenë përfaqësues të partive të atyre atje, po kanë qenë përfaqësues të Delegacionit të Kosovës ,siç thoshte z. Rugova, pra as Delegacion i Uniteti e as Delegacion i Kosovës .Atë mandat e kanë marrë prej atij delegacioni. Çështja se kush do të raportojë këtu sigurisht që është çështje e Delegacionit të Kosovës dhe nuk do të ishte dashtë të bëhet çështje tashti pse nuk është njëri apo pse nuk është tjetri. Në rast se në Delegacion është marrë një vendim, nuk dua këtu ta kursej askënd. Personalisht mendoj se këtu është dashur të jenë të radhitur që të 10-it që kanë qenë në Vjenë dhe asnjë nga Qeveria, sepse tema që po e trajtojmë sot nuk ka të bëjë me Qeverinë, por që ka të bëjë drejtpërdrejtë me Delegacionin e Kosovës. Pra që të 10-it është dashur që të ulen aty, 8 të Delegacionit të parë dhe 2 ndryshime në Delegacionin e dytë Të jenë këtu dhe të miratojnë me kohë raportin e z. Lutfi Haziri ,në qoftë se janë dakord me atë raport dhe ta kundërshtojnë në këtë foltore, në qoftë se nuk janë dakord me atë raport. Ne nuk e kemi një raport të shkruar në bazë të cilit do të kishim pasur mundësi të përfundojmë se ky raport është raport i të gjithëve.

Thjeshtë nuk e kam idenë se kur është shkruar raporti, a është shkruar pas përfundimit të Vjenës apo është raport i cili është miratuar nga delegacionet, sepse z. Haziri ka qenë anëtarë në të dy delegacionet, a është miratuar nga të dyja delegacionet apo është një raport që ka lindur prej takimit të parë të Vjenës e deri në ditën e sotshme. Mos pasja e një raporti të shkruar flet për një qasje jo serioze ndaj këtij raportimi, kurse flet edhe për mosarritjen e Kuvendit për ta ngritur në nivelin e përgjegjësisë dhe punës së vetë. Po si do qoftë po besoj se do të mund të përmirësohet në të ardhmen dhe të kemi raporte të

shkruara të cilat edhe ne do të mund t'i trajtojmë me një seriozitet më të madh dhe t'i analizojmë më me përpikëri. Për ndryshe mendoj se këtu kishim momente të cilat gjatë folësve u shfaqën disa absurde, z. Hoxhaj me respekt e përshëndeti dhe e përgëzoi fjalën e z. Haziri, ndërkohë që la menjëherë në fjalën e ardhshme e përshëndeti për një përfaqësim ose për një paraqitje të plotë të asaj që ka ndodhur atje, kurse menjëherë në fjalën e radhës ju referua shqetësimeve të pa vend që po krijohen në opinion lidhur me bisedimet atje. Pra, nëse raporti ka qen i plotë dhe nëse ai raport këtu që është prezantuar nuk ka pasur të meta atëherë edhe arsyetimi për shqetësime ose përpjekja për t'i shmangur shqetësimet nuk do të kishte pasur nevojë të vinte nga z. Hoxhaj, do të mjaftonte raporti që ne t'i kishim tërhequr të gjitha shqetësimet dhe të gjithë deputetët të mos shqetësoheshin për rrjedhën e bisedimeve, sepse ai e tha tekstualisht se ne që ishim në Vjenë jemi dëshmitar se nuk ka vend për shqetësime. Por nuk mund të shkojmë gjithë ne në Vjenë që mund t'i heqim shqetësimet. Shqetësimet do të duhej t'i heqë po të kishim mundësi t'i heqin përmes raportimit të plotë dhe gjithëpërfshirës i cili fatkeqësisht nuk është i tillë.

Më duhet këtu pak sa edhe pse Z. Noman Baliq i cili e bëri një lëshim të komplekseve të veta të madhësisë së rreme që përfaqëson një mandat të një deputeti i cili i takon me Kornizë kushtetuese dhe kontestoj përfaqësimin e përfaqësuesit nga grupi për komunitete, mendoj se edhe aty është ndjekur një parim elementar, parimi i numrit të përfaqësuesve në Kuvend, në qoftë se 4 grupet që i kanë dhënë përfaqësuesit në delegacionin e Kosovës që e përbëjnë 4 partitë më të mëdha të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, atëherë sipas një logjike të njëjtë edhe anëtari i delegacionit që e merë mandatin nga delegacioni i Kosovës për të biseduar në Vjenë do të jetë njëri nga grupet që kanë më shumë përfaqësues në Kuvendin e Kosovës dhe që është shumë e logjikshme dhe jam shumë i dyshimtë që do të mund të ndërtojnë ndonjë koncenzus të tillë që të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve do të ishin për dikë, mendoj se koncenzuesi është i mirëseardhur, është i dëshirueshëm për të gjithë ne do të duhej të përpiqeshim të ndërtonim koncenzus, mirëpo nuk mund të bllokojmë nëse nuk e arrijmë koncenzusin dhe sigurisht që do të shkojmë përpara me zgjidhje të cilat i kemi që i trajtojmë se janë më të mirat dhe sigurisht që janë më përfaqësuesit në momentin e dhënë dhe jam i sigurt se numrin më të madh të përkrahësve në grupin për komunitet e ka pasur përfaqësuesi i cili i ka përfaqësuar këto grupe në të dyja rastet e bisedimeve sepse për ndryshe nuk do të shkonte ai do të shkonte dikush tjetër dhe kontestimet e tij që kanë ardhur nga z. Baliq dhe z. Rrahmani, mos kofsha gabim janë dy të vetmit që janë shfaqur me kontestim në publik po flas, jashtë publikut edhe mund të kenë pasur kontestime të tjera.

Një çështje që desha ta shtroj këtu para jush si breng për këtë rrjedhë të këtij procesi është çështja e një oferte speciale të cilën kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës por sigurisht e përcjellurë sot nga shefja e tij e grupit parlamentar afron për nivelin e Kosovës.

Unë zonja dhe zotëri deputet nuk e kam të qartë se cila do të duhej të ishte ajo ofertë speciale e cila do të duhet tu bëhet vetëm disa qytetarëve të Kosovës ose të jemë më i saktë vetëm disa përfaqësuesve të komunitetit Serbë në Kosovë. Serbët jetojnë në të gjitha trevat e Kosovës ku më shumë e ku më pakë, dhe problemet e tyre janë përafërsisht

të njëjta gjithkund ose problemet tona në komunikim me ta janë pak a shumë të njëjta gjithkund.

Pushteti i Kosovës nuk ia ka dalë të shtrihet në Zubin Potok, por nuk ia ka dalë të shtrihet as në Shillovë. Pse Shillova është fshat ose pse Ranilluga është fshat, pushteti i Kosovës nuk ka qasje as në Shillovë as në Ranillukë, prandaj nuk ka nevojë qasje speciale ndaj veriut të Kosovës por duhet ta ndërtojmë një qasje e cila do të ishte e pranueshme edhe për qytetarët e komunitetit Serbë të Kosovës dhe këtë s'ja kemi dalë ta bëjmë për kundër përpjekjeve tona të pandërprera por më shumë gojore se sa me punë, sepse këtë dua ta parafrazoj z. Sollana pas takimit me kryeministrin Çeku që tha se është koha që të kalojmë në punë e t'i lëmë llafet, se është fatkeqësi që qeveritë tona veçmas në fazën e fundit më shumë kanë bërë fjalë se që kanë bërë punë, janë përpjekur të shtyjnë procese përpara pa pasur një miratim nga ata me të cilin kishin të bënin me ato procese, pra përpiqeshin të bëjnë decentralizim për Graçanicën por nuk kishin miratim në Graçanicë për atë proces, dhe kështu që erdhën në një situatë në të cilën pilot-projektet u aktivizuan, u shpallën. Këtu patëm një përpjekje nga dy deputet për të bërë një lobim dikujt nga Komisioni për marrëdhënie ndërkombëtare që të jetë i pranishëm si në karakterin e një supervisorit të procesit negociatorë, sepse të gjithë këta që i kemi që atje nuk qenkan të denjë për të na përfaqësuar, kështu që u dashke të shkoj edhe dikush tjetër, unë mendoj që kjo është “no sens” në të gjithë bashkërisht kemi qar njerëz atje të cilin mendoj se e kanë pëlqimin tonë edhe e kanë përkrahjen tonë të plot, kështu që nuk ka nevojë për supervajzer të cilët do të kishin mundësi të na raportonin më mirë se këta deri më sot. Mendoj se puna e këtyre, ose raportimi i këtyre që i kemi qar deri me sot duhet të përmirësohet, por jo duke dërguar supervajzerë, kurse për fund do të kisha marr një qasje lidhur me një deklaratë të djeshme të një përfaqësuese të delegacionit Serb, në bisedimet për Kosovën, z. Rashkoviq Iviq e cila u apelon qytetarëve Serb të Kosovës t'i shkëpusin të gjitha lidhjet institucionale me institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë. Mendoj se kjo deklaratë e saj do të duhej të merrej në konsideratë nga ana e këtij Kuvendi, besoj që Qeveria e ka për borxh në anën tjetër të reagoj në mënyrën e saj, po ne si Kuvend to të duhej të kishim një qasje dhe të shprehim një keqardhje që një përfaqësuese aq e lartë e politikës në Beograd bënë kesi apeli në këtë moment kaq të rëndësishëm për të ardhmen e këtij rajoni edhe për stabilitetin ose për gjetjen e një zgjedhje të përbashkët dhe të qëndrueshme për të gjitha qytetarët e Kosovës, pra do të duhej ta shprehnim brengosjen tonë të thellë dhe njëkohësisht të bënim një kundërapel të gjithë qytetarëve të komunitetit serb që të mos dëgjojnë këso apele, këso thirrje të cilat i izolojnë nga bashkëqytetarët e tyre në Kosovë, sepse nëse përpiqemi të ndërtojmë një të ardhme të sigurt për të gjithë këtë mund ta bëjmë vetëm bashkë dhe kursesi ndaras, dhe ne qofte se ata dalin nga sistemi i institucioneve të Kosovës, atëherë nuk e di si përpiqemi të bëjmë një zgjedhje të përbashkët dhe të qëndrueshme, atëherë sigurisht se do të pasojnë ndërprerja e komunikimit, do të pasojnë zhvillimet të cilat absolutisht jam i sigurt as qytetarët e përkatësisë serbe nuk i dëshirojnë dhe në këtu si shumicë nuk i dëshirojmë, pra do të duhej tu apelojmë që përkundrazi t'i forcojnë lidhjet me institucionet e Kosovës, sepse realisht e ardhmja e tyre është në Kosovë dhe përderisa e ardhmja e tyre është në Kosovë ata duhet jo që të marrin pagat të cilat i kanë marrë deri më sot por të marrin edhe vendet e tyre edhe ulëset të tyre në Kuvendin e Kosovës, të

marrin edhe vendet e rezervuara në Qeverinë Kosovës, dhe të përpiqemi që bashkërisht ta ndërtojmë një shoqëri demokratike. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Faleminderit. Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri, le të përgatitet deputeti Ymer Muhqxheri.

DEPUTETJA BESA GAXHERRI: Faleminderit z. kryesues, kolegë deputetë. Më fal z. kryetar, të lutem s'e e mbajta në mend kryesuesin që ju zëvendësoj.

Z. zëvendëskryeministër, vërtet sot pika e vetme e rendit të ditës rrëshqiti nga diskutimi, por ishte e imponuar që në start që kjo pikë e rendit të ditës të shkojë kështu qysh shkoi. Përkundër asaj që këtu dikush nga kolegët u mundua që të ndajë fajin në një subjekt politik apo tjetrin, unë po them se nuk e kam humbur asnjëherë besimin e përfaqësimit të këtij Grupi Negociator, qoftë për aftësitë, qoftë për unitetin, por assesi nuk mund t'i arsyetoj me mënyrën e sjelljes tyre sot në Kuvendin e Kosovës. Thonë se Kuvendi është institucioni më i lartë i këtij shteti, ndërsa absolutisht ai apo deputetët e Kosovës nuk respektohen. Vërtet mund të them që është një thyerje shumë e madhe sot për këta deputetë që hymë me këtë pikë të rendit të ditës shumë të rëndësishme dhe nuk e kemi së paku një faqe, një fletë material para veti.

Ne na imponohet, flasim apo debatojmë me ato çka janë komentua në media, qoftë të shkruara, qoftë elektronike dhe së paku nuk e shohin përfaqësuesit tonë apo anëtarët e këtij grupi që ato fjalë t'i ruajnë për seancë. Së pari të jenë para këtyre deputetëve e pastaj të dalin të flasin para mediave, qofshin të shkruara apo elektronike.

Nuk mund të pajtohem as me atë, po e përsëris, që nuk na afrohet material i duhur konkret, raport ashtu qysh shkruan në rendin e ditës, por as me mos prezencën, sidomos të përfaqësuesit të Grupit të dytë, që ishin në bisedime në Vjenë- përfaqësuesit e Grupit. Nuk mund ta arsyetoj kolegun e tij z. Hoxhaj, që mundohet ta arsyetojë këtë formë. Në qoftë se duhet të jetë ai këtu, duhet të jetë edhe kryetari i Kosovës edhe kryeministri. Pajtohem që duhet dhe ka qenë shumë në rregull të jenë të gjithë këtu, por nuk mund të pajtohem, sepse Hashim Thaçi nuk është as kryetar i Kosovës as kryeministër, po është një deputet që ka besuar kësaj radhe ta kryesonte atë grup edhe ai të merr atë forcë që të mos jetë sot as prezent në Kuvend. Jo që nuk do të raportojë, por nuk do të jetë as prezent në Kuvend. Siç e tha kolegu Sabri Hamiti, duhet të kërkohet një disiplinë, por prej kujt të kërkohet tash unë nuk e di. Pra, po e them publikisht se Kuvendit të Kosovës tashmë iu kanë marrë të gjitha përgjegjësitë. Unë nuk di që duhet t'i jap përgjegjësi këtij Kuvendit, po e shoh që s'ka nevojë të jap. Kush ku duhet të jap nuk e di, por është shumë e vërtetë që duhen të disiplinohen njerëzit e institucioneve, që i ka zgjedhur ky Kuvend. Dhe duhet tani në përgjegjësi të vinë të diskutojnë për çështjet që kanë qenë. Ne jemi shumë të vetëdijshëm, se nuk është e thënë të diskutohet gjithçka apo të raportohet gjithçka, sepse çdo shtet i ka sekretet e veta, aq më shumë ne që tash jemi në proces, duke biseduar për një veçori të një shteti. Por duhet të raportohet sinqerisht ajo çka deri ku ka arritur. Nuk kërkojmë na çka do të bëni më tuje, por deri ku ka arrit edhe mos të në humb besimi në këtë grup, sepse arsyet për ndryshime dhe për frikë po

shtrohen çdo ditë. Nuk kemi raporte, nuk na afrohen material, nuk vinë personat që i autorizojmë ne apo i votojmë me raportua këtu dhe na pastaj jemi këtu ku jemi.

Unë veç këtë që e tha kolegu para meje pata ndërmend me thanë pasi që zotëri Thaçi këtu nuk është e ai ka qenë përfaqësuesi, tash që u bisedua për financa e komunave apo decentralizimit. Unë sot e dëgjova përmes mediave se Qeveria e Serbisë i thërret të gjithë qytetarët serbë të Kosovës që t'i shkëputin kontratat e punës në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, sepse nuk lejohen dy kontrata në marrëdhënien e punës, do me thanë kjo thotë shumë. Tash nuk e dimë se çka është biseduar atje, as në çfarë forme është lejuar financimi, mirëpo në bazë të lejimit të financimit të këtyre komunave ne do t'i financojmë këto institucione edhe i thirrën qytetarët, ndërsa personi që i duhet të na sqarojë sot konkretisht nuk është këtu. Kjo është papërgjegjësi totale. Këtë po e them me e ndijë opinionin me e ndijë populli ,sepse ne tashmë po e shohin. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ymer Muhaxheri, le të përgatitet Xhevat Bislimi.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI: I nderuar z. kryetar.

Kam dy sugjerime Kuvendit, e nëpërmjet tij , Komisionit Negociator si autoritet vendimtar që është zgjedh prej këtij Kuvendi. Ndërsa këto sugjerime janë periferi të kësaj teme të këtij debati. Po e shoh të arsyeshëm me i thanë kësaj radhe ,por po ju premtoj shkurt, shpejtë, kam konsideratë ndaj fundit të durimit tonë këtu.

Sugjerimi i parë është lidhur me një mjet politik si kategori që në shumtën e rasteve përdoret si parim i zgjedhjes së konflikteve mes shteteve e që është dy shtetësia, faktet historike mes konfrontimit shtetëror të Italisë dhe Austrisë Tiroli dhe lufta 100 vjeçare mes Francës dhe Gjermanisë për ato dy krahinat Lorenin dhe Azasin janë lidhur nëpërmjet kësaj kategorie. Grupi Negociator, me siguri e ka parasysh këtë instrument politik, nëse nuk e ka atëherë kishte me qenë shumë mirë, me e përdorë atë si mjet edhe në rastin tonë, sepse me dyshtetësi fare pak ndryshon pozita, roli, vendi, funksioni, misioni i pjesës së popullit serb në Kosovë. Kjo dyshtetësi nuk kishte me dëmtua kauzën tonë, përkundrazi kishte me lehtësuar dhe me modifikuar, me i zbutë të gjitha ato vrazhdësi të qëndrimeve të Qeverisë serbe ,njëkohësisht edhe pjesës serbe në Kosovë. Kishte me e ruajt atë stabilitet psikik, kishte me mundësi komunikimin e tyre shpirtëror. Për atë sugjeroj që ky parim në instanca të caktume kur trajtohen këto çështje përfundimtare tash është herët si modus të zgjedhjeve me pas parasysh edhe këtë kategori.

Çështja e dytë, si sugjerim është e lidhur me një fakt historik që shpejtë përpiqna me ju thanë. Gjatë viteve 48-të 53 në kohën e sundimit të Gjoka Pajkoviqit është bërë një ndërrim territorial mes Serbisë edhe Kosovës, ju janë bashkëngjitë Leposaviqi dhe Zubin Potoku, ndërsa u janë marrë pjesë më të begatshme- pjesa e Luginës së Preshevës.

Po e theksoj këtë fakt për shkak se në Londër më 1913, 1919 dhe në Paris,më 1920, kur janë caktuar kufijtë, kur i janë dhënë Serbisë peshqesh trojet shqiptare, kufiri ka qenë

Mitrovica, ndërsa Zubin Potoku, Leposaviqi prej 1878 i kanë takuar Serbisë. Ndërsa këto pjesë këtu, nëse këto ndërrime reciproke territoriale janë interne nuk janë sanksionime në atë shkallën ndërkombëtare për atë si rezervë e manovrimit kohën e proceseve ishte dashtë me marrë parasysh edhe të ketë mundësi sepse në seancën e fundit edhe pse Grupi i Kontaktit i ka paraparë të mos ndarjen e kufijve. E vetmja zgjedhje që ka me qenë për Kosovën jam i bindur ka me qenë prapë çështja e Mitrovicës. Dhe çështja e Mitrovicës vetëm në këtë mënyrë mundet me u paraqit dhe me fuqizuar argumentin tonë politik. Kaq kolegë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit profesor. Fjalën e ka Xhevat Bislimi, le të përgatitet prof. Mark Krasniqi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI: Faleminderit z. kryetar, z. deputetë.

Fillimisht pa hy në rendin e ditës propozoj që Kryesia ta rregullojë me këta teknikët çështjen e ndërprerjes së fjalës së deputetit. Deputeti të paralajmërohet, të paktën një minutë përpara se po i mbarojnë minutat, e jo t'i ndërpritet fjalës qysh po i ndërpritet në të gjitha seancat.

E dyta, të afishohen emrat e deputetëve që kërkojnë fjalën dhe secili të pres radhën e tij e jo kështu siç po ndodh. Nuk e dimë kush kur e ka kërkuar fjalën dhe kusht po del i pari e kush i fundit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Z. deputetë, po përcillet radha siç janë paraqitë, asnjë kapërcim nuk ka, asnjë anashkalim nuk ka.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI: Ju faleminderit, me gjithë atë çështje teknike që mund të rregullohet është më lehtë edhe për deputetë edhe për juve.

Bisedimet janë bërë temë kryesore e ditës, shqetësim i gjithë shoqërisë shqiptare dhe civile edhe në Kosovë, por edhe jashtë saj. Unë mendoj që mungesa e kryetarit të Kosovës dhe njëkohësisht të kryetarit të Grupit të bisedimeve në këtë sallë është e pashpjegueshme dhe e papranueshme ,sepse ai kryetar nuk është mbi Kuvendin, por e ka zgjedh ky Kuvend. Të paktën duhet të kishte respekt për ata që e kanë votuar për të.

Dy. Paraqitja e Lutfi Hazirit këtu në emër të Grupit për bisedime edhe raportit për bisedime të Vjenës, mund të them më së buti është mungesë totale e respektim për Kuvendin dhe kuvendarët dhe njëkohësisht edhe për qytetarët e Kosovës, sepse ky Kuvend përfaqëson, ashtu siç jemi mësuar të themi, të përsërisim ,vullnetin e qytetarëve të Kosovës.

Përpjekjet që përgjegjësia e rrjedhës së bisedimeve, e relacioneve ndërinstitucionale t'i hidhet PDK-së është për mua një përpjekje e vërtetë dëshpëruese e koalicionit qeverisës ,që të paktën pas luftës i ka fituar shumicën e votave në të gjitha zgjedhjet dhe sigurisht që deri sa ai ka dëshiruar vota dhe privilegjet që i ka gëzuar dhe vazhdon t'i gëzojë ,shpeshherë edhe në kundërshtim me ligjet në fuqi, duhet të pranojë edhe përgjegjësitë

edhe për gjendjen reale në Kosovë edhe për enklavat që i pengon z. Haziri edhe për mos shtrirjen e pushtetit të Qeverisë së Kosovës në tërë territorin nuk është përgjegjësi e PDK-së por është përgjegjësia e atyre që kanë fituar 5 parë zgjedhje, ju lutem merrni përgjegjësinë, bëhuni burra dhe pranoni atë përgjegjësi.

Kur dëgjon dhunën politike, dhunën psikologjike, që po ushtrohet nga një pjesë të faktorit ndërkombëtarë dhe nga një pjesë e politikës vendore ndaj qytetarëve të Kosovës të krijohet përshtypja se Kosova është i vetmi vend në botë që ka pakica kombëtare. Ju lutem kursejeni qytetarin tonë, kursejeni popullin tonë të lodhur të viktimizuar ndër shekuj por të lodhur edhe sot nga kjo politikë dhe nga këta politikanë të papërgjegjshëm.

Nuk ka vend që qytetari i Kosovës të flejë i qetë, kot mundohemi ta mashtrojmë këtë qytetarë dhe këtë popull tonin meretorikën çoftë qeveritare dhe çoftë deputetëve, çoftë politikave tjera dhe politikanëve tjerë ndërkombëtarë.

Këtu dikush kërkojë që të disiplinohet institucioni dhe sigurisht që u aludua në Kuvend, unë nuk ma merr mendja në qoftë se ju ka takuar të ndiqni ndonjë seancë të kuvendeve, parlamenteve tjera nuk besoj që ka Kuvend më të disiplinuar në rruzullin tokësorë. Nuk besoj që ka kuvendar më të disiplinuar në rruzullin tokësorë. Dhe me gjithë këtë disiplinim, gjithë këtë disiplinë ka zëra që rritet presioni mbi deputetët që ta kyçin gojën të rritet presioni mbi Kuvendin që ta mbyllë gojën dhe t'ia dorë trokas atyre herojëve që do të na sjellin demokracinë do të na sjellin pavarësinë siç janë mësuar të thonë me siguri deri tash kanë bërë një thes me deklarata këta politikanë në të gjitha fushatat zgjedhore të gjitha paraqitjet e tyre çofshin publike, çofshin metale duke thënë jo një herë mia herë, ne me Serbinë do të bisedojmë vetëm për kufijtë e Kosovës, kush do t'i hajë këto deklarata, kush do t'i kthejë mbrapa.

Procesin e bisedimeve me Serbinë zotërinë, kolegë të koalicionit qeverisës nuk e ka promovuar as se ka hapur partia demokratike e ka promovuar dhe e ka hapur ministri i juaj dhe kolegu i tij edhe ai ministër, pa mandatin e këtij Kuvendit duhet të thuhet botërisht, çartë, hapur pa mandatin e këtij Kuvendit, Lufti Haziri ka shkuar është takuar me ministrin e Pushtetit vendor në Vjenë dhe ka biseduar për decentralizimin ose me e thanë me atë emërtimin e saktë nocionin e saktë për ndarjen territoriale, administrative të Kosovës mbi bazat etnike, dhe pranimi i krijimit të komunave serbe është një fakt shumë i vërtetë që nuk mund ta mbulojë askush asnjë erektori asnjë terminologji sado e kamofluar që është edhe po përdoret.

Merren zotërinj të nderuar unë e kamë pas rastin edhe që jam në atë komision dhe shikojeni Rregulloren mbi policinë, ajo është një rregullore që më shumë se gjysma e saj i kushtohet rregullimit të marrëdhënieve ndëretnike e jo Rregullore mbi policinë. Atë që e kërkonte me këmngulje Millosheviqi dhe regjimi i tij të instalojë policinë lokale në Kosovë po e instalojmë ne, shikojeni Rregulloren e policisë ju lutem.

Unë e kuptoj që të ketë polici komunale bashkiake qysh ka në vende të tjera por policia nacionale të segmentohet të copëtohet me policinë lokale me kryetarë komunash, me këshillash komunash kjo është e vërtetë dëshpëruese për qytetarin tonë dhe për popullin

e Kosovës për mjerimin e këtyre politikanëve që flasin në emër të këtij populli të këtij qytetari që e kanë mashtruar dhe vazhdojnë ta mashtrojnë natën edhe ditën.

Unë mendoj, si përfundim që ky koalicion që nuk u dëshmuar dhe për këtë ka prova edhe me ndërrime që po bëhen çdo tre muaj të kryeministrave, ky koalicion që nuk u dëshmuar i zoti ta qeverisë këtë copë vend ta zgjidhë çoftë edhe një problem elementarë të jetës së qytetarit tonë nuk ka shans as nuk ka gjasë të dalë fitimtarë përballë shtetit që quhet Serbi dhe përballë delegacionit të tyre prapa të cilit qëndron një shtet e jo një Kuvend e një institucion si ky i yni. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet për fjalë Sabit Rrahmani.

DEPUTETI MARK KRASNIQI: I nderuari kryetar, i nderuari zëvendëskryeministër të nderuar deputetë.

Me Rezolutën e këtij Kuvendi është thënë se për pavarësinë nuk ka negociata, do me thënë është një gjë e kuptueshme edhe e kryeme si të themi, për ne të paktën. Mirëpo, këtu çështja e decentralizimit deshi s'deshi i po komplikohet me pavarësinë e Kosovës, sepse kërkohet nga pala serbe, nga Serbia konkretisht kërkohen kompromise, të cilat ne nuk mund t'i pranojmë në asnjë mënyrë. Për një problem mes dy palëve më duket se është zgjidhja më e mirë që të ulen ato dy palë dhe të merren vesh si duhet, në qoftë se ka mundësi, e jo të ligjohet urdhri, këshillat e një palës tjetër e cila e ka edhe interesat e veta në këtë problem.

Konkretisht, Serbia këtu nuk duhet të implikohet aspak. Serbinë nuk e ka pyetur kërkush, as Sllovenia, as Kroacia, as Maqedonia, se si të i rregullojnë ato komunat dhe çka të bëjnë me rregullimin administrativ brenda tyre. Pse, sot t'i jepet Serbisë kjo e drejtë. Serbia bile nuk ka të drejtë fare që të dëgjohet zëri i saj, sepse ajo në Kosovë nuk ka qenë gjithmonë, por kur ka qenë, ka qenë vetëm okupatore, e asgjë tjetër. Okupatori këtu ka bërë siç e dimë edhe si siç kemi vuajtur vetë, krimet e hatashme e tash të bisedohet me te se si ta rregullojmë ne shtëpinë tonë, më duket se është një përkëdhelje e tepruar nga ana e faktorit ndërkombëtar.

Ne jemi për atë që Serbia të interesohet për pakicën e vetë në Kosovë, por jemi para se gjithash, për atë që pakica serbe edhe gjitha pakicat minoritare që jetojnë në Kosovë, t'i kenë të gjitha të drejtat dhe ta dinë Kosovën si shtëpi të veten, e mos ta ndiejnë veten të lënë mbas dore ose të diskriminuar në ndonjë mënyrë tjetër. Kjo me krijimin e komunave tjera, me krijimin e bashkësive të komunave serbe, kjo vetëm e komplikon një situatë e cila nuk do të jetë e volitshme për ne e as për rajonin. Kjo vetëm sa e komplikon atë zgjedhje.

Prandaj, në qoftë se Serbisë i lejohet në këto kushte që ajo të përzihet në punët tona, pse nuk i lejohet atëherë Shqipërisë si të përzihet në punët komunale të Preshevës ose të Bujanovcit atje, ku është një pakicë e madhe e popullit shqiptarë, ose e kundërta e Bosnjës, pse nuk përzihet tash Bosnja këtu në Kosovë ku kemi mjaft boshnjakë, ose

Egjipti, ose Turqia, sepse kemi edhe Turq edhe Egjiptianë. Por Serbia ka të drejtë, e të tjerët jo, më duket kjo përkëdhelje e Serbisë. E kjo kërkesë e minoritetit serb është një fyerje edhe për minoritetet tjera që i kemi ne këtu.

Sipas një statistike dhe statistikën e sigurt nuk e kemi ne askush, në Kosovë jetojnë rreth 60 mijë boshnjakë, kurse unë nuk besojë që sot kemi 60 mijë serb në Kosovë, pse mos të bisedohet për boshnjakët ma tepër se sa për serbët,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Mbi 130 mijë serbë kemi sot në Kosovë.

DEPUTETI MARK KRASNIQI: Po sipas statistikës së vitit 1991 Kosova ka 194 mijë serb, por nuk janë as gjysma e këtyre këtu dhe nuk ma merë mendja se janë aq, prandaj thash.

Më duket se është një problem i decentralizimit edhe i nxituar pak, kjo mund të rregullohet me kushtetutën e shtetit, por ne atë kushtetutë nuk e kemi prandaj mendoj se do të ishte shumë ma e udhës e shumë më e drejtë që njëherë të shpallet pavarësia e Kosovës e t'i thuhet Serbisë se vetëm mund të interesohesh për të drejtat e pakicës sate aty edhe ne ta këqyrim punën tonë e Serbia të vetën .

E ka pas shumë të drejtë i ndjeri, presidenti Ibrahim Rugova që thoshte: para së gjithash të njihet pavarësia, e mandej t'i zgjidhim të gjitha çështjet tjera. Sepse ne sot nuk jemi të barabartë me Serbinë, ne s'kemi shtet, Serbia është shtet, ajo na konsideron si pokrajinë si thotë ajo edhe sot e kësaj dite. Prandaj, para se gjithash nevojitet pavarësia dhe me kushtetutë do të sigurohen të gjitha të drejtat e çdo qytetari, pa marrë parasysh a është Serb, a është Malazezë, a është Shqiptarë, a Boshnjak, a Turk, a Hashkali a diçka tjetër.

Unë tash gjatë këtij pushimi të vogël që e patëm, dëgjova që Rashkoviç paska thanë se prej sodit serbët e Kosovës nuk duhet të marrin asnjë rrogë prej buxhetit të Kosovës. do me thanë Serbia është e sigurt që do t'i ketë enklavat e veta. Me fjalë të tjera që do të thotë ta kenë një Serbi të vogël ose të madhe brenda Kosovës, brenda autonomisë esenciale të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit profesor. Fjalën e ka Sabit Rrahmani, le të përgatitet Xhavit Haliti.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI: Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari z. zëvendëskryeministër të nderuar deputetë.

Unë fillimisht dua të them që Grupi Negociator ka marrë votën e këtij Kuvendit dhe të këtyre deputetëve dhe është më e domosdoshme që ky grup tash ta ketë mbështetjen e këtij Kuvendi edhe të institucioneve të tjera të Kosovës. Mua mu përmend emri këtu me qenë se kam debatuar edhe javën e kaluar në lidhje me këtë çështje. Ju z. kryetarë më keni thanë përqendrohuni në rendin e ditës, falë zotit që sot është pika e rendit të ditës kjo.

Grupi Negociator i cili nuk ka asnjë përfaqësues të komuniteteve jo serbe po ashtu edhe Grupi Politik Strategjik nuk ka në kuadër të këtyre grupeve, këtyre grupeve u është formuar Grupi i Këshillit Konsultativ për Komunitete ku marrin pjesë po thuaj se gjithë deputetët nga komunitetet jo serbe por edhe kemi vetë dy serbë të cilët kanë qenë pjesë përbërëse e këtij grupi edhe në takimet e kaluara. Unë nuk kamë thanë kurgja lidhje me ministrin z. Sadik Idrizi, z. Lutfi Haziri ka qenë prezentë në takim kur i pari e kam marrë fjalën dhe e kam mbështetë që z. Sadik Idrizi e ka mbështetjen e plotë të përfaqësuesve të komuniteteve Hashkali të jetë pjesë e delegacionit të Kosovës në rundin e parë të bisedimeve në Vjenë kjo ka qenë më 18. shkurt në takimin e Këshillit konsultativ. Aty për aty them të drejtën z. Veton Surroi dhe z. Lutfi Haziri na ka mbyllë gojë edhe kjo ka qenë arsyeja se ka qenë dashtë të japim mbështetje cili do që të shkojë përfaqësues të komuniteteve jo serbe. Që të dy kanë thanë që herëve të tjera ky grup në kuadër të komuniteteve jo serbe do të ketë mënyrë rotative që secili prej jush apo një pjesë prej jush do të ketë mundësinë të jetë pjesë e delegacionit. Nuk kam qenë kundër z. Sadik Idrizi me qenë se nuk është prezentë këtu edhe herën e dytë kur është përcaktuar nga Grupi Negociator të merr pjesë në bisedime në Vjenë unë personalisht e kamë thirr në telefon dhe prapë i kam dhënë mbështetje.

Unë kam qenë vetëm kundër një vendimi pse është shkel ai vendim pse nuk është thjeshtë nuk është respektuar vendimi që është marrë në Këshillin konsultativ. Këtu u përmend fjala pozitive opozitive po është politizuar Grupi Negociator edhe grupi politik strategjik nuk kemi nevojë me ja mbyll sytë askujt, thjeshtë këtu luajnë rolë Lidhja Demokratike e Kosovës edhe Partia Demokratike e Kosovës si dy subjekte më të mëdha politike do ta them haptas, kurse komunitetet jo serbe të cilat gjinden në pozitive duhet me thanë haptas që më privilegjume ne jemi më të shkelur në këtë rast, thjeshtë opozita pjestarët e komuniteteve jo serbe të cilët janë në opozitë Hshkalitë, Gorantë edhe Romët janë të shkelur me të dyja këmbët, do me thanë haptas por nëse ka nevojë me hesht për shkak të proceseve të cilën po kalon Kosova ne heshtim nuk është problem, na mundemi me hesht, është në interes të gjithë qytetarëve të Kosovës që me blu ma butë, atëherë na bluajmë më but hajde po thojmë kështu me fjalë të popullit siç thotë populli.

Nëse doni mu bindë z. kryetar ju dhe gjithë deputetët që me të vërtetë pak jemi të anashkaluam një rast konkret.

Ditën e premte dhe ditën e shtunë në Ferizaj është plagosur një pjesëtar i komunitetit Hashkali, brenda këtyre dy dite në fshatin Hallash komunës së Lipjanit u gju një bombë te një familje e komunitetit Hashkali, as Kuvendi, as Presidenca, as Kabineti i kryeministrit nuk ka reaguar as që e kanë dënuar këtë akt. Po të kishte ndodh te serbët, unë jam i sigurt që i kishit përkundë, thjeshtë haptazi me thanë këtë, pse jemi të privilegjum, është dashtë që dikush me ditë që ky Kuvend ky institucion është përgjegjës për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Partia Demokratike e Hashkalive është formuar më 19 dhjetor të vitit 1999, edhe prej atëherë ne i kemi dhënë mbështetje institucioneve të shqiptarëve në përgjithësi. Sot z. kryetar e kam lexuar një deklaratë tujën në Kosovën sot që e keni dhënë në lidhje me datën e bombardimeve të NATO-së kur ke pasur telefonin me z. Nekibe Kelmendin kur

ka treguar që bashkëshortin e saj dhe dy fëmijët e saj i kanë marrë regjimi Serb edhe pas 7 vite ne i shprehim ngushëllime se është për ngushëllime . Është rrënjëthënëse edhe aty duhet me kuptuar se me të vërtetë shqiptarët e meritojnë pavarësinë edhe duhet me ju dhanë përkrahjen për këtë aspekt , por z. kryetar ju vetë jeni kanë të shtypur nuk dua me thanë se na jemi të shtypur totalishtë por jemi të integrumë shumë pak, nuk dëgjohet zëri jonë, thjeshtë nuk dëgjohet, kemi dëshirë dhe kemi nevojë edhe na me qenë pjesë e këtyre proceseve, dëshirojmë edhe ne me dhanë kontributin tonë me një faqe zyrtare të RTS-ës të Serbisë thotë se delegacioni i Kosovës e ka paguar z. Sadik Idrizi që të jetë në favor të delegacionit shqiptarë, nuk thuhet në delegacionin e Kosovës por thuhet në delegacionin shqiptarë në favor të tyre, le të bëhet një mënyrë rotative një herë të na shkon një Turqeli, një herë një Boshnjak, një Hashkali, një Romë le ta shohin ata që me të vërtetë Kosova dinë me integruar pakicat kombëtare. Nëse jemi për me ndërtua një shtet mbi bazat demokratike edhe me i respektuar të gjitha të drejtat e pakicave kombëtare nuk po dom me kanë pjesë e Grupit Negociator, pjesë e grupit politik strategjik edhe pse gjithë këta përfaqësues të komiteteve jo serbe nuk duhet me mshefë këtë me të gjitha organet ndërkombëtare që kemi në takim edhe me z. Matia Atisari kur kemi pas takime edhe me Kaj Aiden mos mendoni që ata mendojnë mirë pse pjesëtarët e komuniteteve jo serbe nuk janë të kyçur në institucionin kryesor, Grupin Negociator apo Grupin Politik Strategjik po, pavarësisht prej asaj ajo kohë ka kaluar, jemi në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve të përfshimi më shumë grupe punuese, përfshimi më shumë bisedime të delegacionit që është në Vjenë, doja mi treguar dikujt që me të vërtetë dimë me e udhëheqë edhe dimë me i respektuar edhe të tjerët. Unë prej këtu po ju sigurojë që Komuniteti Hashkali edhe këtu e ka votuar Rezolutën për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran edhe pse atë ditë kemi pasur ditë zien, kur janë djegur 5 pjesëtarë të komuniteti Hashkali në Fushë Kosovë. Por tu ditë rëndësinë e asaj Rezolute unë kam marrë pjesë këtu edhe dua me ju siguruar të gjithëve si deputetëve si gjithë shqiptarëve të Kosovës e komuniteti Hashkali me këmbëngulje për Kosovës shtet të pavarur dhe sovranë. Po, ju kisha lutë së paku ndërmjet gishtave me na këqyr pak. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Faleminderit. Fjalën e ka Xhavit Haliti, le të përgatitet deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI XHAVIT HALITI: Faleminderit z. kryetar. Unë nuk e kisha ndërmend që të diskutojë sepse mendova që t'i përbëhemi asaj që kemi marrë vendim me gjithë atë vullneti i deputetëve është që të diskutohet dhe ne po vazhdojmë.

Shqetësimet janë të shumanshme gjithë deputetëve dhe për veti i kuptoj, por për mua është shqetësuese së pari frika e jonë, frika e udhëheqësve të institucioneve të Kosovës e ministrave, e Qeverisë, e deputetëve dhe gjitha strukturave politike dhe partiake të Kosovës që nuk flasin në parlamentin e Kosovës ashtu siç flasin zyrat e veçanta, zyrat e huaja, dreka dhe në darka bashkë me përfaqësuesit e zyrave të huaja dhe bashkë me përfaqësuesit e Bashkësisë Ndërkombëtare të cilët kemi po thujse 7 vjet që janë këtu, dhe po na lusin që të merremi me veten tonë të merremi me Kosovën dhe të merremi me problemin tonë, dhe problemi jonë nuk e di qysh duhet me na përkthye ndryshe. Është një kohë tani publikisht po kërkohet që vërtetë të debatohet në parlament për problemet dhe unë konsideroj se në qoftë se ne dje në atë ish Jugosllavinë e famshme të cilën ka

nostalgjia akoma ndoshta, ishim pakicë, në Kosovën e vogël kemi edhe disa pakica por kemi edhe një pakicë për të cilën që është e drejta po na kërkohet marrja e përgjegjësive, dhe përgjegjësitë për atë pakicë na takojnë neve, kur them neve së pari Qeverisë së Kosovës e cila duhet të jetë decidive se çka po i afron asaj pakice veçanërisht për dy çështje: sigurinë, ndihmën financiare nga buxheti i Kosovës dhe problemin e kishave të cilin e kanë problem të tyre, dhe ne s'mund t'ua mohojmë.

Nuk po dua të futemi në çështjet e historisë së kombit as të luftërave tona por kush është shkaktar dhe pse jemi ulë këtu sot dhe pse po flasim këtu janë disa faktorë dhe nderta është Lufta Çlirimtare e Kosovës dhe në veçanti angazhimi i gjithë njerëzve për të luftuar për jetën dhe për Kosovën. Dhe në veçanti Bashkësia Ndërkombëtare, realisht ne kemi një deklaram publik të hapur të Bashkësisë Ndërkombëtare që Kosova duhet të jetë e pavarur dhe unë nuk di pse po u dashka tash me u marrë a thua do të na njohin a s'do të na njohin, a do të kemi Kosovë të pavarur me kushte apo pa kushte, Kosova duhet me qenë e pavarur e kanë thanë ata që mujnë me vendosë dhe anëtarë të Këshillit të Sigurimit, sepse unë jam i bindur që asnjëri nga këto grupet që kanë qenë në Vjenë nuk i kanë ata lapsat që kanë me nënshkruar atë punë, këto janë grupe teknike për problemet të cilat kanë shkuar me bisedua dhe njërin e ka kryesuar një herë zëvendëskryeministri Lutfi Haziri dhe tjetrin e ka kryesuar kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës dhe anëtar i Ekipit të Unitetit z. Hashim Thaçi.

Për mu shqetësuese gjithë ajo zhurmë kush kujt ia ka prekë dorën, nuk është mirë me hi në ato gjëra ne ka shumë këtu që kanë jetuar bashkë ija kanë prekë dorën atij e herë atij për mua është guxim i secilit politikan të Kosovës sot që është i gatshëm që të ulet në një tavolinë që të takohet dhe të pinë kafe me secilin politikan, le të vijë ai dashtë nga Beogradi dashtë nga cili do vend tjetër, me të cilin ka për çka të bisedohet dhe ka probleme që të diskutohet. Unë nuk e konsideroj tradhti te asnjë ministri të asnjë deputeti të asnjë politikani të Kosovës.

Sot nuk është Kosova në pazar dhe nuk është një thes me flori as nuk është një thes me drithë as me pasul të cilin mundet me shitë as njëri e as tjetri politikan. Dhe kjo nuk i lejohet dhe s'do t'i lejohet kërkujtë. Prandaj të jemi më racional për faktin se unë e di nga gazetatat nga bisedat që i kam pas me këta që kanë marrë pjesë në bisedime, që kanë qenë dy tri çështje kontestuese këto bisedime në Vjenë, dhe për veten time e kamë pritë që të zhvillohet debat a duhet me u financua si duhet me ardhë ato pare, që në një mënyrë ose tjetrën është diskutuar në Vjenë që Beogradi t'i financojë komunat serbe në Kosovë. Cili do të jetë mënyra e një farë asociimit të komunave e drejtë një asociacion të komunave serbe në Kosovë dhe cilat do të ishin kompetencat e atyre komunave, a duhet me qenë a s'duhet me qenë a është në interesin e Kosovës a do t'i ndihmonte më së pari ata për të qenë pjesë e integrame në Kosovë ai farë lloji asociimi.

Mbi të gjitha me qenë se kemi formuar Ministrinë e Brendshme duhet të ishte e udhës që z. ministër i Brendshëm para se ta merre detyrën të na referonte një program ose një plan i cili përmes këtij parlamenti do t'i garantonte Bashkësisë Ndërkombëtare dhe bashkësisë serbe në Kosovë cili është plani i kësaj Ministrie për ta ndërtuar sigurimin ose sigurinë e qytetarëve të cilët po e konsiderojnë veten të rrezikuar, cilat përgjegjësi do t'i merr kjo

Ministri dhe nuk kemi pse të frikësojmë se ne ato përgjegjësi duhet t'i marrim. Cila është përgjegjësia e kësaj Ministrie dhe e policisë së Kosovës për t'i ruajtur dhe për t'i garantuar kishat Serbe të cilat duhet t'i garantojnë ne dhe jo dikush tjetër nga jashtë.

Prandaj, mendoj që këto janë çështje me të cilat ne është dashtë sot të merremi, mendoj që të paktën në bazë të informatave të mia dhe për këtë mund të na sqarojë ndoshta edhe një herë z. kryetar i Kuvendit dhe z. zëvendëskryeministër dhe ministër i Pushtetit Lokal që Grupi i Unitetit ka marrë një vendim që po të dyja takimet të raportojë Lutfi Haziri, unë kështu jam i informuar. Dhe ndoshta do të ishte e rrugës që të sqarohet kjo çështje a është e vërtetë apo unë kam keqkuptime ose s'jam i informuar drejtë nga ata që është dashtë me u informua.

Prandaj, të gjitha këto ne nuk i diskutuam sot për të cilat mendoj që duhet ky parlament t'i diskutoj. Çështjen e pavarësisë, çështjen e luftave prej Lidhjes së Prizrenit e këndeje besoj që 90% e jona e dimë sepse në çoftë se nuk e kemi studiuar historinë të paktën e kemi pas mjaftë gazeta, trakte, gazeta ilegale, nëpër familje i kemi trajtuar këto probleme shumë dhe e dimë gjithë rolin historik të gjithëve dhe e kemi njohur më duket edhe në këtë parlament rolin historik të tyre. Prandaj, unë po të mos lëshuar veten në kundërshtim i cili mund të keq kuptohet, kisha kërkuar nga z. kryetar i Kuvendit në këtë rast edhe z. zëvendëskryeministër të na sqarojë a është vendim që Lutfi Haziri të raportoj për bisedimet në Vjenë i delegacionit për negociata. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit. Është e vërtetë se kemi planifikuar që sot të raportoj edhe Lutfi Haziri edhe Hashim Thaçi. Me gjithë atë me kërkesën e Hashim Thaçit, është tërheqë, dhe Grupi Negociator është pajtuar që të raportojë për dy takimet z. Lutfi Haziri, bile bile edhe tash kur ishim në takim te Grupi Negociator që ishim më herët sot z. Thaçi kërkoi që ta sqaronte me dëshirën e tij është tërhequr sot që të mos vijë para deputetëve.

Fjalën e ka Lutfi Haziri . Replikë kërkon deputeti Fadil Geci.

DEPUTETI FADIL GECI: Faleminderit. Me qenë se deputeti, anëtarë i Kryesisë Xhavit Haliti, shkurazi kaloi edhe kah unë, unë desha vetëm t'i them mirë që po e merr në mbrojtje, por jo që ja ka prekë dorën Xhavit t'i mirë e din por edhe e ka kap lidh për qafe. Edhe për këtë nëse mendon se është krejt në rregull dhe është në interes të partisë edhe të Kosovës, edhe kjo është mendimi yt, dhe në rregull të jetë ashtu.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit. Fjalën e ka prof. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI: Faleminderit z. kryetar. Gjatë debatit në veçanti të anëtarëve nga grupi unë parlamentar ka pas përpjekje që të jepen propozime për zgjedhjet qëndrueshme të çështjes së Kosovës. Me këtë rast në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës i cili grup e ka për detyrë dhe objektiv ta zbatojë politikën e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe programin e saj zgjedhor ju ri konfirmoj se Lidhja Demokratike e Kosovës nëpërmjet grupit të vetë parlamentarë Kuvendin e

Kosovës e mbështetë qëndrimin e Grupit të Kontaktit për mos ndryshim të kufijve të Kosovës.

Prandaj, z. kryetar diskutimet edhe sugjerimet individuale nga radhët e grupit tonë, i lutem që të merren si qëndrime individuale. Ndërsa qëndrimi politik i LDK-së dhe i Grupit Parlamentar është pacenueshmëria e kufijve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Faleminderit profesor. Replikë kërkon deputeti Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI: z. kryetar faleminderit unë nuk do të replikoj por mendojë që është mjeshtëri e deputeti këtu që të mos ia përmend emrin kërkujt. Dhe unë s'ia përmendi emrin kërkujt, dhe ju si kryetar s'keni të drejtë t'ia epni fjalën për replikë njeriut që s'ju ka përmend emri nga unë. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit. dhe i fundit paraqitet zëvendëskryeministri dhe ministri i Pushtetit Lokal z. Lutfi Haziri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI LUTFI HAZIRI: Faleminderit z. kryetar, kryesi e punës, Kryesi e Kuvendit, deputetë, nuk do të ju marrë shumë kohë, dëshirojë ta përmbyll diskutimin tim pa dashtë me kualifikua, pa dashur me nxit diskutime tjera, përveç asaj që unë falënderoj dhe në adresimin tim të fjalës unë kamë kërkuar që të dëgjoj me vëmendje angazhimet tuaja si deputet për të parë sepse procesi i definimit të statusit final ka filluar dhe si i tillë terminologjia mund të jetë e ndryshme në përdorim të fjalëve, por realiteti ka ndodhur dhe jemi në mes të vllgut të realizimit të kësaj agjende të punës që është përcaktuar. Statusin e Kosovës për të cilin është punuar shumë nga Këshillit i Sigurimit ka ardhur pas rekomandimit të ambasadorit Kai Aide dhe tmerrësisht jam i frikësuar, nëse dikush mendon me e mohuar rrolin e subjektit të vetë politik që ka punuar shumë, që ky status të hapet si i tillë, të definohet dhe mendoj që pas sqarimeve që i dha profesor Gashi për disa çështje që desha të diskutoj dhe Xhavit Haliti për pjesën më të madhe të diskutimeve mendoj se është e tepërt të folët me gjuhën e mililitatizmit dhe të drejtimit të gishtit ndaj patriotëve dhe etiketave që dikush donë me i promovuar në tipin provencional, prej nga vjen duke menduar që shërbëtor çajash dhe ka tregtar të cilët mund të manipulojnë me formula të tilla që janë të tejkaluara, respekti deri në gjuhëzim, por disiplinimin unë e kuptoj vazhdimisht dhe prej orës 10,00 jam këtu i disiplinuar për të paraqitur raportin tim para Parlamentit të Kosovës, por jo para tekeve të individëve, por para Parlamentit dhe si i tillë ju kisha lutur që ta kuptoni që unë jam këtu të punoj dhe të jem para Parlamenti të Kosovës për të cilin deri në fund do të jem i disiplinuar, i përgjegjshëm dhe me të cilin do të punoj, sepse më ka mandatar dhe mund të ma merr mandatin, por në çdo situatë është organi më i lartë për të cilin unë sillem sipas përgjegjësive që i kam. Pjesa tjetër e angazhimeve në të cilën unë kamë besuar se do të ketë diskutim ka të bëjë me temat konkrete, të cilat unë i kamë përmbledhur këtu, nuk kamë përmbledhur detaje për të cilat është i njoftuar delegacioni i Kosovës. Janë të njoftuara partitë politike, është i njoftuar grupi politik. Reflektimi i delegacionit për takimin e Vjenës ka përfaqësim adekuat këtu, secili prej juve e dini dhe keni përfaqësues,

ose liderin e partisë politike ose liderin e institucionit ose ekspert në nivel ekspertësh ose përfaqësim politik në grupin politik dhe kjo formulë reflektuese në këtë mekanizëm e kanë informuar njëri tjetrin brenda strukturës për të ditur realisht ku janë problemet dhe ku janë defektet, absolutisht raporti përmbledh qëllimet kryesore të angazhimeve dhe ka qenë raport e jo tog fjalësh ose fjalish, por i është ikur frymës folkloriste dhe i është ikur frymës e cila në vete nuk mbërthen asgjë tjetër përveç angazhimit tonë të përbashkët në këtë kontest.

Takimi i ardhshëm do të mbahet me 3 prill dhe Delegacionin do ta mandaton prapë ekipi i njëjtë, nuk dihet saktë se kush mund të jetë përfaqësues, por supozohet se janë njerëzit me mandat të njëjtë dhe e drejta e juaj është që të kërkonit që për takimet tjera të raportohet. Unë personalisht kamë qenë në favor të raportimit nga dy vetë, por delegacioni i Kosovës pardje, kryetari i Kosovës i cili e udhëheq delegacionin më ka kërkuar që unë të raportoj në emër të delegacionit dhe si i tillë unë jam sjell i disiplinuar për të ardhur para këtij institucioni për të treguar se megjithatë sillemi si shtet, nuk sillemi si bajraktar. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju faleminderit z. zëvendëskryeministër. Kolegë të nderuar, dëgjuam raportin e Grupit Negociator dhe diskutimet e deputetëve rreth këtij raporti. Ne presim dhe kërkojmë që edhe në të ardhmen të kemi raporte të këtilla dhe të diskutojmë.

Ju faleminderit të gjithëve për mirëkuptim.